



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
**KOMISIONI I PAVARUR I KUALIFIKIMIT**

**Nr. 219 Akti**

**Nr. 376 Vendimi**  
**Tiranë, më 26.4.2021**

**V E N D I M**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, i përbërë nga:

<b>Etleda Çiftja</b>	Kryesuese
<b>Pamela Qirko</b>	Relatore
<b>Roland Ilia</b>	Anëtar

asistuar nga sekretare gjyqësore, znj. Ertugena Sokoli, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar znj. Marie Tuma, në datat 25.3.2021, ora 14:00, dhe 22.4.2021, ora 10:00, në Pallatin e Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0 (*underground*), Tiranë, mori në shqyrtim në seancën dëgjimore publike çështjen që i përket:

**SUBJEKTI I RIVLERËSIMIT:** **Znj. Enkelejda Metaliaj**, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë.

**OBJEKTI:** **Rivlerësimi kalimtar i subjektit të rivlerësimit.**

**BAZA LIGJORE:** **Neni 179/b dhe nenet A, Ç, D, DH dhe E të Aneksit të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë**, miratuar me ligjin nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, të ndryshuar;

**Ligji nr. 84/2016**, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”;

**Ligji nr. 44/2015**, “Kodi i Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë”;

**Ligji nr. 49/2015**, “Për organizimin dhe funksionimin e gjykatave administrative dhe gjykimin e mosmarrëveshjeve administrative”.

**TRUPI GJYKUES I KOMISIONIT TË PAVARUR TË KUALIFIKIMIT,**

pasi dëgjoi arsyetimin ligjor dhe rekomandimin e relatores së çështjes, znj. Pamela Qirko, vlerësoi shpjegimet e subjektit të rivlerësimit dhe analizoi provat shkresore të paraqitura në vijim të rezultateve të hetimit dhe në seancë dëgjimore, si dhe shqyrtoi dhe analizoi çështjen në tërësi,

## V Ë R E N:

### I. RRETHANAT E ÇËSHTJES – SEANCAT DËGJIMORE

1. Komisioni i Pavarur i Kualifikimit është institucioni që kryen procesin e rivlerësimit kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve, bazuar në paragrafin 5 të nenit 179/b të ligjit nr. 76/2016, datë 22.7.2016, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8417, datë 21.10.1998, “Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë”, e ndryshuar, dhe në pikën 5 të nenit 3, si dhe në pikën 1 të nenit 5 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

2. Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën Administrative të Apelit Tiranë, është subjekt që i nënshtrohet rivlerësimit *ex officio*, në bazë të pikës 3 të nenit 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë.

3. Bazuar në pikën 2 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016 dhe në rregulloren “Për procedurat e zhvillimit të shortit në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit”, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit (në vijim “Komisioni”), në datën 15.11.2018 zhvilloi procedurat e shpërndarjes me short të çështjeve në trupat gjykuese, short nga i cili rezultoi se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj, do t'i nënshtrohej procesit të rivlerësimit nga trupi gjykues nr. 3, i përbërë nga komisionerët Firdes Shuli, Roland Ilija dhe Etleda Çiftja. Relator i çështjes u zgjodh me short komisionere Firdes Shuli. Anëtar zëvendësues sipas shortit u përzgjedh komisionere Pamela Qirko.

4. Në mbledhjen e trupit gjykues të datës 26.11.2018 u caktua me mirëkuptim kryesuese, komisionere Etleda Çiftja, dhe u deklarua mospasja e konfliktit të interesit nga anëtarët e trupit gjykues, si dhe u vendos fillimi i hetimit administrativ, me qëllim kryerjen e procedurave të rivlerësimit për subjektin.

5. Referuar pikës 1 të nenit 4 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” për subjektin nisi procesi i rivlerësimit dhe hetimi i thelluar administrativ.

6. Në vijim, komisionere Firdes Shuli ka paraqitur kërkesën për dorëheqje nga shqyrtimi i kësaj çështjeje, për shkak të ekzistencës së konfliktit në dukje të interesit me subjektin e rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj, kërkesë e shqyrtuar dhe e pranuar nga një trup tjetër gjykues<sup>1</sup>. Si rrjedhojë, pjesë e trupit gjykues, në cilësinë e relatores, u caktua anëtarja zëvendësuese, znj. Pamela Qirko, e cila deklaroi mospasjen e konfliktit të interesit.

7. Procesi i vlerësimit të pasurisë për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun IV “Vlerësimi i pasurisë”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 30 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimi deklarimin dhe kontrollin e pasurive, të ligjshmërisë së burimit të krijimit të tyre, të përmbushjes së detyrimeve financiare, përfshirë interesat privatë për subjektin e rivlerësimit dhe për personat e lidhur me të.

8. Procesi i vlerësimit të kontrollit të figurës, në përputhje me kreun V “Kontrolli i figurës”, të ligjit nr. 84/2016, dhe veçanërisht në nenin 34 të këtij ligji, ka për objekt verifikimin e deklarimeve të subjektit të rivlerësimit dhe të dhënave të tjera, me qëllim identifikimin nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të përcaktuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

9. Procesi i vlerësimit të aftësive profesionale për subjektin e rivlerësimit, në përputhje me kreun VI “Vlerësimi i aftësive profesionale”, të ligjit nr. 84/2016 dhe veçanërisht në

---

<sup>1</sup> Vendim i datës 6.3.2019, i trupit gjykues i përbërë nga komisionerët Xhensila Pine, Lulzim Hamitaj dhe Olsi Komici.

nenin 40 të këtij ligji, ka për objekt vlerësimin e veprimtarisë etike dhe profesionale të subjektit të rivlerësimit, në përputhje me ligjin nr. 84/2016 dhe me legjislacionin që rregullon statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve.

**10.** Bazuar në nenet 33, 39 dhe 43 të ligjit nr. 84/2016 “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit janë administruar raportet e hartuara nga institucionet: Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave (ILDKPKI); Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar (DSIK); dhe Këshilli i Lartë Gjyqësor (KLGJ).

**11.** Në përputhje me nenin 33 të ligjit nr. 84/2016, Inspektorati i Lartë i Deklarimit dhe Kontrollit të Pasurive dhe Konfliktit të Interesave dërgoi raportin<sup>2</sup> e hollësishëm dhe të arsyetuar pas procedurës së kontrollit për vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit. Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera nga ILDKPKI-ja për secilën pasuri dhe të ardhur të deklaruar nga subjekti i rivlerësimit, është konstatuar se:

- *deklarimi nuk është i saktë në përputhje me ligjin;*
- *nuk ka burime financiare të ligjshme për të justifikuar pasuritë;*
- *ka kryer fshehje të pasurisë;*
- *ka kryer deklarim të rremë;*
- *subjekti nuk gjendet në situatën e konfliktit të interesit.*

**12.** Drejtoria e Sigurimit të Informacionit të Klasifikuar ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit me anë të verifikimit të deklarimeve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikohet nëse subjekti ka/ka pasur kontakte të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe në ligjin nr. 84/2016. Për këtë qëllim, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka dërguar raportin<sup>3</sup> për subjektin e rivlerësimit, në përfundim të të cilit ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit.

**13.** Këshilli i Lartë Gjyqësor ka kryer vlerësimin e aftësive profesionale, duke rishikuar dokumentet ligjore të përpiluara nga subjekti i rivlerësimit gjatë periudhës objekt i rivlerësimit, sipas shtojcës 4 të ligjit nr. 84/2016, si dhe të pesë dokumenteve të tjera ligjore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe ka dërguar një raport<sup>4</sup> të hollësishëm dhe të arsyetuar për subjektin e rivlerësimit.

**14.** Në vijim, nga relatori i çështjes janë ndjekur procedurat ligjore të përcaktuara në pikën 5 të nenit 14 të ligjit nr. 84/2016, duke kryer një hetim të plotë dhe të gjithanshëm mbi të tria kriteret: vlerësimin e pasurisë, kontrollin e figurës dhe vlerësimin e aftësive profesionale.

**15.** Trupi gjykues, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, pasi u njoh me rezultatet e hetimit dhe me provat e grumbulluara për kriterin e vlerësimit të pasurisë, të kontrollit të figurës dhe të vlerësimit të aftësive profesionale, në datën 5.2.2021, vendosi: (i) përfundimin e hetimit kryesisht për këto tri kriteret për subjektin e rivlerësimit; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit, mbështetur në pikën 5 të nenit Ç të Aneksit të Kushtetutës dhe në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016.

<sup>2</sup> Akti i përfundimit të kontrollit me nr. \*\*\* prot., datë 3.7.2018.

<sup>3</sup> Raporti mbi kontrollin e figurës me nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017.

<sup>4</sup> Raporti për analizimin e aftësive profesionale me nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2019.

**16.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 12.2.2021, u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet e hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përfaqësuesit të saj me prokurë<sup>5</sup>, avokatit K.S., u njoh me aktet e dosjes në datën 4.3.2021, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe të provave të reja në datat 15.3.2021 dhe 16.3.2021.

**17.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë përmes postës elektronike, në datën 19.3.2021.

**18.** Seanca dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 25.3.2021, ora 14:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

**19.** Në seancën dëgjimore të datës 25.3.2021, subjekti i rivlerësimit nuk ishte prezent, por u përfaqësua me prokurë<sup>6</sup> nga avokati K. S.<sup>7</sup>, i cili mori të gjithë kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet në lidhje me procesin e rivlerësimit, dhe në përfundim kërkoi konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj.

**20.** Gjatë zhvillimit të seancës dëgjimore të datës 25.3.2021, nga shtetasja E.N., e pranishme në seancë, u ngritën pretendime lidhur me një vendim gjyqësor të marrë nga subjekti i rivlerësimit, në cilësinë e anëtares së trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë (u depozitua prej saj kopje e vendimit gjyqësor). Gjithashtu, kjo shtetase, në datën 25.3.2021, depozitoi në Komision në rrugë elektronike pretendimet e saj me shkrim lidhur me çështjen objekt denoncimi.

**21.** Për shkak të ardhjes së këtij denoncimi të ri dhe pas analizimit paraprak, me qëllimin e kryerjes së një hetimi sa më të plotë dhe të gjithanshëm në shqyrtimin e tij, me vendimin e ndërmjetëm nr. 4, datë 31.3.2021, trupi gjykues vendosi riçeljen e hetimit administrativ, vendim për të cilin subjekti është njoftuar nëpërmjet postës elektronike.

**22.** Në vijim, rezultoi se në datën 1.4.2021 është depozituar në Komision, në rrugë elektronike, një tjetër denoncim, nga shtetasi A.P.

**23.** Pas shqyrtimit të këtyre dy denoncimeve, dhe pasi u njoh me rezultatet shtesë të hetimit dhe me provat e administruara, në datën 14.4.2021, trupi gjykues vendosi: (i) mbylljen e hetimit administrativ – përfundimin e hetimit shtesë; (ii) njoftimin e subjektit të rivlerësimit për t’u njohur me materialet e dosjes; si dhe (iii) kalimin e barrës së provës subjektit për të paraqitur shpjegime të tjera për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

**24.** Subjekti i rivlerësimit, në datën 14.4.2021, u njoftua mbi të drejtën për të paraqitur pretendime/shpjegime shtesë apo të kërkonte marrjen e provave të reja lidhur me rezultatet shtesë të hetimit kryesisht, të zhvilluar nga Komisioni. Subjekti i rivlerësimit, nëpërmjet përfaqësuesit të saj me prokurë, avokatit K.S., u njoh me aktet e dosjes në datën 15.4.2021, si dhe ushtroi të drejtën e paraqitjes së parashtrimeve dhe të provave të reja në datat 18.4.2021 dhe 19.4.2021.

<sup>5</sup> Prokurë e posaçme, me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 3.3.2021, redaktuar nga noteri publik, znj. E.T.

<sup>6</sup> E njëjta prokurë e posaçme e paraqitur nga avokati K. S., në momentin e njohjes me aktet e dosjes.

<sup>7</sup> Anëtar i Dhomës Avokatisë Tiranë, me nr. licence \*\*\*, NIPT \*\*\*\*\*.

**25.** Pas shqyrtimit të shpjegimeve dhe provave të vëna në dispozicion nga subjekti, trupi gjykues vendosi të ftojë subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore. Subjekti i rivlerësimit u ftua në seancën dëgjimore me njoftimin e bërë me *e-mail*, në datën 20.4.2021.

**26.** Seanca e dytë dëgjimore për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj, u zhvillua në përputhje me kërkesat e nenit 55 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në datën 22.4.2021, ora 10:00, në ambientet e Pallatit të Koncerteve (ish-Pallati i Kongreseve), salla B, kati 0, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, znj. Marie Tuma.

**27.** Subjekti i rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj (prezent në këtë seancë), dhe përfaqësuesi i saj ligjor, morën kohën e kërkuar për të shprehur dhe parashtruar shpjegimet e tyre lidhur me rezultatet shtesë të hetimit. Gjithashtu, gjatë kësaj seance subjekti i rivlerësimit iu përgjigj pyetjeve të tjera të bëra nga anëtarët e trupit gjykues lidhur me procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj. Në përfundim të shpjegimeve dhe parashtrimeve, subjekti i rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj, kërkoi nga Komisioni konfirmimin në detyrë.

## **II. QËNDRIMI I SUBJEKTIT TË RIVLERËSIMIT**

**28.** Znj. Enkelejda Metaliaj ka qenë bashkëpunuese në procesin e rivlerësimit të kryer ndaj saj, duke u përgjigjur, kur i është kërkuar, sipas nenit 48 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, gjatë gjithë procedurës së hetimit administrativ.

**28.1.** Subjekti i rivlerësimit ka sjellë prova dhe shpjegime kur janë nevojitur, ka qenë korrekte dhe e gatshme për bashkëpunim gjatë të gjitha fazave të hetimit, si dhe gjatë zhvillimit të seancave dëgjimore.

## **III. PROCESI I RIVLERËSIMIT/HETIMI I KRYER NGA KOMISIONI**

**29.** Procesi i rivlerësimit, që kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, është një proces kushtetues, që mbështetet në nenin 179/b të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në Aneksin e Kushtetutës, si dhe në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”. Ky proces kryhet me qëllim që të garantohet funksionimi i shtetit të së drejtës, pavarësia e sistemit të drejtësisë, me synim rikthimin e besimit të publikut tek institucionet e këtij sistemi.

**29.1.** Parashikimet e ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” kanë përcaktuar qartë të gjitha rregullat e posaçme për kryerjen e rivlerësimit mbi bazën e parimeve të barazisë përpara ligjit, të kushtetutshmërisë e ligjshmërisë, të proporcionalitetit dhe të parimeve të tjera që garantojnë të drejtën e subjekteve të rivlerësimit për një proces të rregullt ligjor.

**29.2.** Sipas kreut IV të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ILDKPKI-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e pasurisë së subjektit të rivlerësimit dhe për të marrë vendim në lidhje me vlerësimin pasuror.

**29.3.** Sipas kreut V të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, DSIK-ja është organi kompetent shtetëror i ngarkuar me ligj për të bërë vlerësimin e figurës dhe për të marrë vendim në lidhje me kontrollin e figurës.

**29.4.** Ndërsa, sipas kreut VI të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikohen burimet për rivlerësimin e aftësive profesionale dhe procedura që duhet të ndiqet nga organet ndihmëse.

**29.5.** Por, referuar vendimit nr. 2/2017<sup>8</sup>, të Gjykatës Kushtetuese dhe kreut VII të ligjit nr. 84/2016 rezulton se Komisioni, në kryerjen e funksionit të tij kushtetues, realizon një proces të mirëfilltë kontrolli dhe rivlerësimi, që nuk bazohet dhe as është i detyruar nga përfundimet e paraqitura nga organet e tjera ndihmëse.

**30.** Bazuar në nenet 45, 49 dhe 50 të ligjit nr. 84/2016, Komisioni kreu hetimin dhe vlerësimin e të gjitha fakteve dhe rrethanave të nevojshme për procedurën e rivlerësimit, duke marrë në analizë: (a) provat e dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI me deklaratën e pasurisë për rivlerësimin kalimtar, “Vetting”; (b) raportin e dorëzuar në Komision nga ILDKPKI-ja; (c) deklaratën e rivlerësimit kalimtar, “Vetting” të dorëzuar nga subjekti në ILDKPKI; (ç) deklaratat periodike të dorëzuara ndër vite dhe provat shkresore të administruara nga ILDKPKI-ja, të cilat gjenden në dosjen e këtij subjekti, dërguar në Komision; (d) provat shkresore/dokumentet të administruara nga organet publike dhe private, në përputhje me nenet 49 dhe 50, të ligjit nr. 84/2016; (dh) raportin e kontrollit të figurës të dorëzuar në Komision nga DSIK-ja; (e) raportin e analizimit të aftësive profesionale të dorëzuar në Komision nga KLGJ-ja; (ë) denoncimet e publikut; dhe (f) shpjegimet me shkrim dhe provat e paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, të depozituara në protokollin e Komisionit apo nëpërmjet postës elektronike, si dhe ato gjatë seancës dëgjimore për të provuar të kundërtën e rezultateve të hetimit.

## **A. VLERËSIMI I PASURISË**

**31.** Pas marrjes së raportit të hollësishëm dhe të arsyetuar të kontrollit të plotë të deklaratës së pasurisë së subjektit nga ILDKPKI-ja, u procedua me hetimin administrativ për vlerësimin e pasurisë. Hetimi i kryer nga Komisioni është përqendruar në vërtetësinë e deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit dhe personat e lidhur me të, si dhe në verifikimin e ligjshmërisë së burimeve të krijimit të këtyre pasurive.

**31.1.** Përtej raportit të dërguar nga ILDKPKI-ja dhe në përputhje me pikën 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, nisi shqyrtimi i deklaratës së rivlerësimit kalimtar “Vetting”, të paraqitur më parë në ILDKPKI, duke e krahasuar me dokumentet e tjera të marra gjatë hetimit administrativ dhe duke përgatitur për këtë qëllim një relacion që pasqyron procesin e kryerjes së vlerësimit të pasurisë së subjektit të rivlerësimit.

**31.2.** Në deklaratën “Vetting” (shtojca 2), të dorëzuar në ILDKPKI, në datën 25.1.2017, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se zotëron këto pasuri:

**32.** Pasuria e llojit “apartament”, me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*” (sot rruga “\*\*\*\*”) \*\*\*, Tiranë, me vlerë 30,720 dollarë, përfituar me kontratën<sup>9</sup> e shitblerjes së datës 20.9.2011.

---

<sup>8</sup>“41. Për rrjedhojë, gjykata vlerëson se pretendimi se organet ekzistuese zëvendësojnë organet e reja të rivlerësimit është i pabazuar. Sipas pikës 5, të nenit 179/b, të Kushtetutës rivlerësimi kryhet nga Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, kurse sipas nenit 4/2 të ligjit: ‘Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit janë institucionet që vendosin për vlerësimin përfundimtar të subjekteve të rivlerësimit’. Pavarësisht formulimit të kësaj dispozite, ajo nuk mund të lexohet në mënyrë të shkëputur, por në harmoni me dispozitat e tjera ligjore që përcaktojnë në mënyrë të detajuar kompetencat e organeve të përfshira në proces, si dhe kompetencat që kryen KPK-ja gjatë këtij procesi. Në nenin 5/1 të ligjit parashikohet se: ‘Procesi i rivlerësimit të subjekteve të rivlerësimit kryhet nga Komisioni, Kolegji i Posaçëm i Apelit, Komisionerët Publikë, në bashkëpunim me vëzhguesit ndërkombëtarë’. Po ashtu, siç u përmend edhe më sipër, bazuar në dispozitat e kreut VII të ligjit nr. 84/2016, rezulton se në kryerjen e funksionit të tyre kushtetues, organet e rivlerësimit kryejnë një proces të mirëfilltë kontrolli dhe vlerësimi dhe nuk bazohen dhe as janë të detyruara nga përfundimet e paraqitura atyre nga organet e tjera ndihmëse.”

<sup>9</sup> Kontrata e shitjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.9.2011.

**33. Pasuria e llojit “apartament”,** me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>, ndodhur në rrugën “\*\*\*\*” (sot rruga “\*\*\*\*”) \*\*\*, Tiranë, me vlerë 24,320 dollarë, përfituar me kontratën<sup>10</sup> e shitblerjes së datës 20.9.2011.

**33.1.** Subjekti ka deklaruar se këto dy apartamente ndodhen në të njëjtin kat të objektit/pallatit, pasi janë të bashkuara.

**33.2.** Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se: (i) apartamenti me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup> është prenotuar me kontratën<sup>11</sup> e sipërmarrjes së datës 4.2.2002, për çmimin 28,800 dollarë. Si burim krijimi ka deklaruar: (a) të ardhurat e siguruara nga paga e bashkëshortit si gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (b) honorare të përfituara te fondacioni “K\*\*\*”; dhe (c) kursime familjare të shprehura si pjesëtim vullnetar të një banese 2-katëshe në M\*\*\*, si pjesë takuese. Ndërsa, për (ii) apartamentin me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup> ka deklaruar se është prenotuar me kontratën<sup>12</sup> e sipërmarrjes së datës 23.2.2010, për çmimin 40,000 dollarë. Si burim krijimi ka deklaruar të ardhurat e siguruara nga huaja e marrë vëllait të bashkëshortit, z. S.M., nëpërmjet kontratës<sup>13</sup> së datës 23.2.2010, në shumën 35,000 euro. Ky apartament ka qenë i prenotuar me kontratën e sipërmarrjes në datën 25.9.2002 nga shtetasja P.Xh., me çmim 30,400 dollarë. Kjo kontratë është anuluar me dokumentin anulim kontrate të datës 22.2.2010 (për pamundësi likuidimi), kontratë që i ka hapur rrugë kontratës së sipërmarrjes së datës 23.2.2010.

**33.3.** Këto apartamente janë regjistruar në hipotekë dhe në datën 22.9.2011 dhe janë nxjerrë certifikatat e pronësisë në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit. Këto dy pasuri janë rivlerësuar: (i) apartamenti me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup> në vlerën 11,232,000 lekë; dhe (ii) apartamenti me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup> në vlerën 8,892,000 lekë. Shpenzimet e regjistrimit dhe të rivlerësimit janë kryer në shumën 120,000 lekë, me burim të ardhurat e siguruara nga kursimet nga pagat.

**33.4.** Subjekti ka shpjeguar se ndryshimi i çmimeve nga kontratat e sipërmarrjes me kontratat e shitblerjes ka ardhur si pasojë e kursit të këmbimit të dollarit, për kohën e ndryshme të kontratës së sipërmarrjes me atë të shitblerjes.

#### **Deklarimi i këtyre pasurive në vite**

**33.5.** Referuar deklaratës fillestare të pasurisë (në deklarin e bërë veçmas) konstatohet se personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit) ka deklaruar banesën 2+1, me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>, me vlerë 3,000,000 lekë, pasuri kjo e deklaruar 100% në emrin e tij. Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar të ardhurat nga pjesëtimi vullnetar, pjesa takuese e një banese 2-katëshe me 6 dhoma dhe oborr, e ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, M\*\*\*. Gjithashtu, ka deklaruar se kjo pasuri është porositur me kontratën e sipërmarrjes së datës 1.2.2002, me palë: sipërmarrës firma “\*\*\*\*” dhe porositës A.M.

**33.5.1.** Referuar deklaratës periodike vjetore (në vijim “DPV”) të vitit 2010, të dorëzuar në ILDKPKI, subjekti ka deklaruar prenotimin e pasurisë së llojit **“apartament banimi 1+1”, me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>**, te firma “\*\*\*\*” sh.p.k., me vlerë **40,000 dollarë**, me kontratë sipërmarrjeje datë 23.2.2010, paguar me paratë e marrë hua vëllait të bashkëshortit, me kontratën e huas së datës 23.2.2010. Në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” ka deklaruar huan e marrë nga vëllai i bashkëshortit në datën 23.2.2010, në shumën 35,000 euro.

<sup>10</sup> Kontrata e shitjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 20.9.2011.

<sup>11</sup> Kontrata e sipërmarrjes, konfirmuar me dokumentin noterial vërtetim nënshkrimi nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 4.2.2002.

<sup>12</sup> Kontrata e sipërmarrjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.2.2010.

<sup>13</sup> Kontrata e huas me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.2.2010.

## Hetimi i kryer nga Komisioni për këto pasuri

**34.** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti në ILDKPKI (pjesë e dokumentacionit që shoqëron deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”, aneksi nr. \*\*\*) konstatohet se:

**34.1.** Me kontratën e sipërmarrjes të datës 4.2.2002, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka porositur nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. pasurinë e llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>, për çmimin 28,800 dollarë. Referuar kësaj kontrate, plani i pagesave përcaktohet si vijon: (i) shuma 12,000 dollarë do të paguhej *cash* me lidhjen e kontratës; (ii) shuma 6,000 dollarë brenda qershorit të vitit 2002; dhe (iii) pjesa tjetër me përfundimin e punimeve.

**34.2.** Meqenëse në deklaratën fillestare të pasurisë bashkëshorti i subjektit nuk ka deklaruar detyrime financiare të mbetura ndaj shoqërisë, rrjedhimisht rezulton se deri më 31.12.2003 është likuiduar çmimi i plotë për këtë pasuri. Gjithashtu, konstatohet se në deklaratën fillestare të pasurisë dhe në vijim ky apartament deklarohet si adresë banimi nga subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti i saj.

**34.3.** Me kontratën e sipërmarrjes së datës 23.2.2010, bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A.M., ka porositur nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e llojit “apartament banimi” me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>, për vlerën 40,000 dollarë. Në këtë kontratë përcaktohet se shuma 40,000 dollarë është paguar e plotë. Referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti për këtë pasuri konstatohet se kjo ka qenë e prenotuar më parë nga shtetasja P.Xh., me kontratën e sipërmarrjes së datës 25.9.2002, për vlerën 30,400 dollarë. Në datën 22.2.2010, mes shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e sipërmarrësit, dhe shtetasës P.Xh.Gj., është nënshkruar dokumenti “anulim kontrate”, nëpërmjet të cilit palët kanë rënë dakord që të anulohet kontrata e sipërmarrjes së lidhur mes tyre për apartamentin me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>.

**34.4.** Rezulton se në datën 20.9.2011 mes shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e shitësit, dhe z. A.M. (bashkëshorti i subjektit), në cilësinë e blerësit, është nënshkruar kontrata e shitblerjes për dy pasuritë e sipërcituara, sipas së cilës përcaktohet se: (i) çmimi i apartamentit me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup> është 24,320 dollarë; dhe (ii) çmimi i apartamentit me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup> është 30,720 dollarë.

**34.5.** ZVRPP-ja Tiranë<sup>14</sup> konfirmon se në emër të bashkëshortit të subjektit, z. A.M., janë të regjistruara pasuritë si vijon: (i) pasuria nr. \*\*\*, volum \*\*\*, faqe \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, e llojit “apartament”, me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>; dhe (ii) pasuria nr. \*\*\*\*\*, volum \*\*\*, faqe \*\*\*, zona kadastrale \*\*\*, e llojit “apartament”, me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>. Nga verifikimi i dokumentacionit të dërguar nga Zyra e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme Tiranë konfirmohet se këto dy pasuri janë regjistruar në referim të kontratës së shitjes së datës 20.9.2011, të lidhur mes shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe bashkëshortit të subjektit, z. A.M. Nga analiza e informacionit të administruar në dosje rezulton se këto dy pasuri ndodhen në të njëjtin kat të të njëjtit objekt të ndërtuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

**34.6.** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje lidhur me këto dy apartamente, konfirmohet se në datën 29.9.2011 ato janë regjistruar në zyrën hipotekore në emër të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit dhe se, po në të njëjtën datë, janë nxjerrë certifikatat e pronësisë për këto pasuri. Gjithashtu, konfirmohet se këto dy pasuri janë rivlerësuar, e konkretisht apartamenti me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup> në vlerën 11,232,000 lekë dhe apartamenti me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup> në vlerën 8,892,000 lekë.

<sup>14</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 13.3.2019.



**34.7.** Sa më sipër, rezulton se ka mospërputhje mes çmimeve të përcaktuara në kontratat e sipërmarrjes me çmimet e përcaktuara në kontratën e shitblerjes për këto dy pasuri.

**34.8.** Gjatë hetimit administrativ, por edhe me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi shpjegime subjektit për mospërputhjet e konstatuara.

**34.9.** Subjekti ka pranuar mospërputhjet mes çmimeve të përcaktuara në kontratat e sipërmarrjes me kontratën e shitblerjes, por, përpos sa ka deklaruar në deklaratën “Vetting”, në referim të informacionit të marrë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>15</sup> për këtë qëllim, ndër të tjera, ka parashtruar se:

i) në lidhje me pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>, këto ndryshime në çmim janë pasojë e kursit të këmbimit të dollarit, për kohën e ndryshme të kontratës të sipërmarrjes me atë të shitblerjes;

ii) ndërsa, në lidhje me pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>, ndryshimi i çmimit ka ardhur si pasojë e anulimit të kontratës së sipërmarrjes nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me znj. P.Xh. (Gj.) dhe se pas anulimit të kontratës kësaj shtetaseje i është kthyer nga shoqëria vlera 16,000 USD, e parapaguar prej saj.

### **Vlerësimi përfundimtar i Komisionit**

**35.** Rezulton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting” lidhur me këto pasuri, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar kontratën e shitblerjes dhe çmimet e përcaktuara në të, por gjithashtu ka deklaruar edhe dy kontratat e sipërmarrjes dhe çmimet përkatëse të pasqyruara në to.

**35.1.** Në deklaratën fillestare të pasurisë, subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar pjesë takuese mbi apartamentin me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup> dhe, si rrjedhojë, nuk ka deklaruar të dhëna lidhur me këtë pasuri. Por, rezulton se kjo pasuri dhe të dhënat e saj janë deklaruar nga bashkëshorti i subjektit në deklaratën fillestare të pasurisë të bërë veçmas, në cilësinë e subjektit deklarues, si pasuri 100% në emër të tij.

**35.2.** Ndërsa, në DPV/2010 subjekti ka deklaruar prenotimin e pasurisë së llojit “apartament banimi”, me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>, te firma “\*\*\*\*” sh.p.k., me vlerë 40,000 dollarë, me kontratë sipërmarrjeje të datës 23.2.2010.

**35.3.** Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit në të gjitha deklaratimet<sup>16</sup> ka konfirmuar se ka paguar shumën 40,000 USD për blerjen e këtij apartamenti, e cila është më e lartë nga ajo e përcaktuar në kontratën e shitblerjes.

**35.4.** Si rrjedhim, Komisioni çmon se nuk ka pasur përpjekje nga subjekti për fshehjen e vlerës reale të blerjes së kësaj pasurie, por në të kundërt, subjekti ka deklaruar në vazhdimësi se vlera e blerjes së kësaj pasurie është ajo e përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes së vitit 2010, madje duke bërë edhe sqarimet përkatëse në deklarinimin e bërë mbi këtë pasuri, në deklaratën e rivlerësimit kalimtar “Vetting”.

**35.5.** Për më tepër, vlen të pasqyrohet fakti se kontratat për porositjen e këtyre pasurive dhe kontrata përfundimtare e shitblerjes janë nënshkruar vetëm nga bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit. Në këtë këndvështrim, rezulton se është personi i lidhur i cili nuk ka treguar kujdesin e duhur për të verifikuar përputhjen e çmimeve të përcaktuara në kontratat e sipërmarrjes, me ato të përcaktuara në kontratën e shitblerjes së këtyre pasurive.

<sup>15</sup> Ka depozituar si provë shkresën datë 20.4.2020, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., pjesë e dokumentacionit provues të dërguar në mbështetje të përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, protokolluar në Komision, fleta e inventarit me nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2020.

<sup>16</sup> (i) Deklarimet e bëra në ILDKPKI; (ii) deklaratimet e bëra gjatë hetimit administrativ në përgjigje të pyetësorëve të dërguar nga Komisioni; (iii) shpjegimet e dhëna me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit.

**35.6.** Sa më sipër, trupi gjykues arrin në konkluzionin se mospërputhjet e gjetura në përcaktimin e çmimeve të ndryshme në kontratat e sipërmarrjes me atë të shitblerjes së këtyre pasurive janë pa pasoja konkrete dhe, si të tilla, ato nuk kanë prodhuar efekte rënduese gjatë procesit të vlerësimit përfundimtar.

### **Analiza e kohës/periudhës dhe mënyrës së pagesës për çmimin e blerjes së këtyre pasurive**

**36.** Lidhur me kohën dhe mënyrën e kryerjes së pagesave për blerjen e këtyre dy pasurive, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar<sup>17</sup> se: (i) në lidhje me pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup> ...*mënyra e pagesës është bërë cash dhe finalizuar e gjitha në datën 11.11.2002 nga bashkëshorti. Ajo dhe bashkëshorti i saj në atë kohë ishin në periudhë njohjeje, dhe se ajo si subjekt rivlerësimi nuk ka asnjë kontribut për blerjen e kësaj pasurie. Me bashkëshortin e saj ka lidhur martesë ligjore në datën 15.11.2002, ku ka filluar edhe bashkëjetesa e pandarë deri më sot;* (ii) ndërsa, për apartamentin me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup> ...*pagesa e kësaj pasurie është bërë cash drejtpërdrejt shoqërisë në momentin e nënshkrimit të kontratës së sipërmarrjes 23.2.2010.*

**36.1.** Në mbështetje të këtyre deklarimeve, subjekti i rivlerësimit ka depozituar si provë shkresën<sup>18</sup> e datës 20.4.2020, të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me anë të së cilës kjo shoqëri ka konfirmuar se pagesat për apartamentin me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup> janë bërë në tri këste, si vijon: (i) kësti i parë në shumën 12,000 USD është paguar në datën 4.2.2002; (ii) kësti i dytë në shumën 8,800 USD është paguar në datën 24.6.2002; dhe (iii) kësti i tretë në shumën 8,000 USD është paguar në datën 11.11.2002. Ndërsa, për apartamentin me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup> është paguar vlera e plotë për shumën 40,000 USD në datë 23.2.2010. Bashkëlidhur, ka depozituar mandatpagesat përkatëse për konfirmimin e pagesave të kryera.

**36.2.** Komisioni i kërkoi<sup>19</sup> nga shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., konfirmimin e periudhës dhe mënyrën e likuidimit të çmimit të përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes së datës 4.2.2002, të lidhur me z. A.M. Shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.<sup>20</sup> konfirmoi mënyrën dhe planin e pagesave, sikurse ishte pasqyruar në shkresën e mëparshme të depozituar nga subjekti, pasqyruar si më sipër.

**36.3.** Pas kërkesës së bërë nga Komisioni<sup>21</sup>, Drejtoria e Përgjithshme e Gjendjes Civile<sup>22</sup> vendosi në dispozicion certifikatën e martesës për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj, nga ku rezulton se ka lidhur martesë me z. A.M. në datën 15.11.2002.

**36.4.** Sa më sipër rezulton se çmimi i blerjes së apartamentit prej 96 m<sup>2</sup> (blerë prej personit të lidhur nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.) është likuiduar para lidhjes së martesës mes tij dhe subjektit të rivlerësimit.

### **Analiza e burimit të të ardhurave për blerjen/krijimin e këtyre dy apartamenteve Për apartamentin me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>**

**37.** Siç u pasqyrua më sipër, në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie: (i) të ardhurat e siguruara nga paga e bashkëshortit si

<sup>17</sup> Përgjigjja e pyetjes nr.1 të pyetësorit nr. 2.

<sup>18</sup> E cila mban vulën e shoqërisë dhe është nënshkruar nga përfaqësuesi ligjor i saj, pjesë e dokumentacionit provues të dërguar në mbështetje të përgjigjeve të pyetësorit nr. 2, protokolluar në Komision, fleta e inventarit me nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2020.

<sup>19</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 9.12.2020.

<sup>20</sup> Shkresa e shoqërisë datë 21.12.2020, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 21.12.2020.

<sup>21</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2020.

<sup>22</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.10.2020.

gjyqtar në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë; (ii) honorare të marra te fondacioni “K\*\*\*\*”; si dhe (iii) kursimet familjare të shprehura si pjesëtim vullnetar të një pjese të banesës 2-katëshe në M\*\*\*\* (si pjesë takuese). Ndërsa, në deklaratën fillestare të pasurisë, bashkëshorti i subjektit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat e përfituara nga pjesëtimi vullnetar, pjesa takuese e një banese 2-katëshe me 6 dhoma dhe oborr, e ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, M\*\*\*\*.

**37.1.** Sa më sipër, rezulton se ka mospërputhje mes deklarimeve të bëra në deklaratën fillestare të pasurisë dhe deklaratës “Vetting”, lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie.

**37.2.** E pyetur lidhur me burimin e të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për blerjen e kësaj pasurie, në përgjigje të pyetësorit nr. 2 të dërguar nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se: “...lidhur me deklarin në deklaratën e vitit 2004 për pjesëtimin vullnetar ju bëj me dije se kjo është një traditë e hershme shqiptare, se pasi largohet një pjesëtar i familjes nga trangu i saj e gjithë familja kontribuon për ta ndihmuar atë dhe pas kësaj ndihme i larguari nuk përfiton dhe duhet të heqë dorë vullnetarisht nga pasuria e mbetur në familjen nga e cila është ndarë.”

**37.2.1.** Në vijim të deklaramit, subjekti ka shpjeguar se: “...**kësti i parë** në shumën 12,000 USD është paguar në datë 4.2.2002 cash në arkën e shoqërisë dhe se si burim i krijimit të kësaj shume ka shërbyer një dhuratë prej 12,000 USD në vitin 1996 nga Amerika nga z. M.E. (M.), i afërm i babait të bashkëshortit. Kjo dhuratë e mbledhur nga të afërmit e babait të bashkëshortit është sjellë si ndihmë për mundësinë e kryerjes së një operacioni, pasi babai i bashkëshortit vuante nga një sëmundje e rëndë e mushkërive, ku si rezultat i saj ndërroi jetë më 22.5.1996; ... - **kësti i dytë** në shumën 8,800 USD është paguar në datën 24.6.2002, në cash në arkën e shoqërisë, sipas mandatit të arkëtimit nr. \*\*\*, datë 24.6.2002. Si burim krijimi të kësaj shume kanë shërbyer të ardhurat e siguruara nga kursimet nga pagat dhe kursime të tjera familjare si të ardhura të siguruara nga paga e bashkëshortit si gjyqtar në Gjykatën e Shkallës së Parë Tiranë për një periudhë nga 1996 deri në fund të majit 1999, në shumën 742,301 lekë, sipas vërtetimit datë 20.10.2016 dhe diferenca është nga kursimet familjare ndër vite; ...- **kësti i tretë** në shumën prej 8,000 USD është paguar në datën 11.11.2002, në cash në arkën e shoqërisë sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 11.11.2002. Si burim krijimi të kësaj shume kanë shërbyer të ardhurat e siguruara në formë honoraresh të përfituara nga bashkëshorti për periudhën 2000 – dhjetor 2002, të deklaruara në vlerën 10,800 USD, nga puna si avokat te Fondacioni K\*\*\*\*\*, pranë Fakultetit të Drejtësisë Tiranë.”

**37.2.2.** Nëpërmjet deklaratës<sup>23</sup> së datës 15.6.2020, shtetasit M. dhe M.E. deklarojnë se në prill të vitit 1996 i kanë dhënë djalit të xhaxhait Z.M. shumën prej 15,000 USD, për t'i mundësuar një ndërhyrje kirurgjikale, pasi vuante nga një sëmundje e rëndë. Këtë shumë që ia kanë dhënë, e kanë grumbulluar nga të gjithë pjesëtarët e familjes së tyre, që banojnë në Amerikë prej vitit 1968.

**37.2.3.** Lidhur me shlyerjen e detyrimeve tatimore për të ardhurat e pretenduara të përfituara në formë honoraresh nga personi i lidhur, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se: “...sipas statutit të fondacionit “K\*\*\*\*”, pranë Fakultetit të Drejtësisë Tiranë, ky fondacion i ngritur kryesisht mbi donacione të Ambasadës së SHBA-së në Tiranë, shërbente për t'u dhënë ndihmë juridike falas të burgosurve të ndryshëm, çka do të thotë se bashkëshorti për shërbimet e kryera për llogari të fondacionit ka marrë

<sup>23</sup> Deklaratë e nënshkruar në USA, e shoqëruar me vulë apostille, e përkthyer dhe e njësuar me origjinalin, dërguar nga subjekti me provat e depozituara që shoqërojnë shkresën, fletë inventari, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2009.

*honoraret e deklaruar dhe nuk ka pasur detyrim për të paguar detyrimet tatimore, pasi nuk ka funksionuar si person fizik me nr. NIPT-i të veçantë”.*

**37.3.** Për këto të ardhura të pretenduara si të përfituara në formë honorarësh nga puna e tij si avokat në fondacionin “K\*\*\*\*”, personi i lidhur ka depozituar: (i) vërtetimin e datës 15.1.2003, i cili mban vulën e fondacionit dhe është nënshkruar nga kryetari i fondacionit; (ii) deklaratë noteriale<sup>24</sup> e datës 24.10.2016, e drejtuesit të fondacionit, z.A.Sh.; (iii) akthemelimin e fondacionit të datës 1.9.1999, shoqëruar me vërtetimin noterial<sup>25</sup> të datës 9.9.2007; (iv) statutin e fondacionit, shoqëruar me vërtetimin noterial<sup>26</sup> të datës 9.9.2007; dhe (v) vendimin<sup>27</sup> datë 13.9.1999, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë për regjistrimin e këtij fondacioni si person juridik (të gjitha këto dokumente të ndodhura në aneksin nr. 4/6 në dosjen e ILDKPKI-së).

**37.4.** Nga analiza e dokumentacionit të administruar për këtë apartament banimi dhe vlerësimin të tyre në harmoni me deklaratet e bëra në deklaratën fillestare të pasurisë, si dhe shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimin nuk ka kontribut në krijimin e kësaj pasurie.

**37.5.** Si rrjedhim, në kushtet kur rezulton e provuar se kjo pasuri është krijuar nga personi i lidhur para lidhjes së martesës me subjektin e rivlerësimin (paguar plotësisht çmimi) deklaruar 100% në emrin e tij, si dhe duke marrë në konsideratë faktin se personi i lidhur është subjekt i ligjit nr. 84/2016, për të cilin po kryhet/do të kryhet një proces i pavarur/i veçuar rivlerësimi (nga një tjetër trup gjykues), ky trup gjykues vlerësoi të mos thellohet në analizimin e mundësisë financiare për blerjen/krijimin e kësaj pasurie, pasi rezultati i mundshëm nuk mund të ndikojë në procesin e rivlerësimin të subjektit, znj. Enkelejda Metaliaj (Softa).

#### **Për apartamentin me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>**

**38.** Siç u vu në dukje edhe më sipër, subjekti i rivlerësimin ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat e siguruar nga huaja e marrë vëllait të bashkëshortit, z. S.M.

**38.1.** Lidhur me këtë marrëdhënie, subjekti i rivlerësimin ka depozituar kontratën<sup>28</sup> e huas së datës 23.2.2010. Referuar kësaj kontrate, z. S.M. i jep hua personit të lidhur, z. A.M., shumën 35,000 euro, e cila është shlyer menjëherë dhe huamarrësi e ka marrë në dorëzim shumën jashtë zyrës noteriale. Sipas përcaktimeve të bëra në kontratë, huaja jepet pa interes, pa afat të përcaktuar, por sipas mundësive financiare të huamarrësit.

**38.2.** Komisioni vlerëson se, referuar pikës 14 të nenit 3, si dhe pikës 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, z. S.M. bën pjesë në rrethin e personave të tjerë të lidhur, të cilët kanë detyrimin për të justifikuar ligjshmërinë e burimit të krijimit të pasurisë, në këtë rast bazuar në parimin e proporcionalitetit të provojë ligjshmërinë e burimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës 35,000 euro dhënë hua bashkëshortit të subjektit në datën 23.2.2010.

**38.3.** Subjekti i rivlerësimin, me qëllim justifikimin e ligjshmërisë së burimeve financiare të huadhënësit, me dorëzimin e deklaratës “Vetting”, krahas kontratës së huas ka depozituar dokumentacionin fotokopje, si vijon: (i) certifikatë regjistrimi në QKR të subjektit tregtar “S.M.”, person fizik, me datë regjistrimi 29.1.2008; (ii) dokument (certifikatë regjistrimi), lëshuar nga Bashkia M\*\*\*\*, Sektori i Tatim-Taksave, ku pasqyrohen të dhënat e regjistrimit të këtij subjekti dhe lloji i aktivitetit “prodhim

<sup>24</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 24.10.2016.

<sup>25</sup> Dokumenti noterial, vërtetim nr. \*\*\* kol., nr. \*\*\* rep., datë 9.9.1997.

<sup>26</sup> Dokumenti noterial, vërtetim nr. \*\*\* kol., nr. \*\*\* rep., datë 9.9.1997.

<sup>27</sup> Vendimi nr. \*\*\* , datë 13.9.1999, i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë.

<sup>28</sup> Kontrata e huas nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 23.2.2010.

mobilje, zdrukthëtari”; (iii) vërtetim<sup>29</sup> i Drejtorisë së Planifikimit të të Ardhurave, Bashkia Kurbin, ku pasqyrohet se subjekti “S.M.”, person fizik, ka paguar detyrimin për aktivitetin “prodhim përpunim druri” (Njësia M\*\*\*) për vitin buxhetor 2015 – 2016; si edhe (iv) vërtetim<sup>30</sup> nga Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, sipas të cilit vërtetohet se tatimpaguesi “S.M.”, me objekt veprimtarie “fabrikimi i artikujve të tjerë me dru, artikuj kuzhine, measure, peshtafe etj.,” rezulton se për periudhën deri në datën 3.11.2015 nuk ka asnjë detyrim tatimor në tatimin mbi fitimin, kontribute të sigurimeve shoqërore, shëndetësore, tatim mbi të ardhurat personale apo lloje të tjera detyrimesh.

**38.4.** DRT-ja Lezhë<sup>31</sup> informon se tatimpaguesi “S.M.” është regjistruar që prej datës 29.1.2008 si biznes i vogël, pranë Agjencisë Tatimore Laç, me aktivitet “punime druri, dyer, dritare, art, dekor”, dhe duke qenë se ky tatimpagues është biznes i vogël, nuk ka pasur detyrim për të deklaruar të ardhurat deri në vitin 2013.

**38.4.1.** Pas kërkesës së bërë nga Komisioni, DRT-ja Lezhë<sup>32</sup> konfirmon regjistrimin në organin tatimor të tatimpaguesit “S.M.” në datën 29.1.2008 me aktivitet “prodhimi i produkteve të tjera prej druri; prodhim i artikujve prej xunkthi, shporte etj.”, por nuk ka pasqyruar të dhëna lidhur me të ardhurat/qarkullimin e realizuar dhe fitimin neto për vitet 2008 dhe 2009 të këtij tatimpaguesi, duke referuar se bazuar në legjislacionin<sup>33</sup> në fuqi për kohën taksa vendore mbi biznesin e vogël administrohej nga zyrat e taksave të njësive të qeverisjes vendore. Rezulton se nëpërmjet kësaj shkrese, në mënyrë indirekte, DRT-ja Lezhë informon se nuk disponon të dhëna për këtë tatimpagues për periudhën 2008 – 2013.

**38.4.2.** Komisioni kërkoi sërish nga DRT-ja Lezhë<sup>34</sup> konfirmimin e dhënë lidhur me të ardhurat/qarkullimin, fitimin dhe pagesën e detyrimeve tatimore nga tatimpaguesi “S.M.”, person fizik. DRT-ja Lezhë<sup>35</sup>, pasi referon legjislacionin fiskal për biznesin e vogël rezulton se, për tatimpaguesin “S.M.” për vitet 2008 – 2009 referon qarkullimin deri në 2,000,000 lekë.

**38.5.** ISSH-ja, Drejtoria Rajonale Lezhë<sup>36</sup>, në lidhje me të ardhurat financiare të z. S.M. informon se ky shtetas rezulton i punësuar si person fizik nga data 1.2.2008 e në vazhdim. Për vitin 2008, për muajt shkurt – qershor, paga mbi të cilën është derdhur kontributi është 16,000 lekë, ndërsa për muajt korrik – dhjetor është 14,830 lekë. Për vitin 2009, për muajt janar – prill paga mbi të cilën është derdhur kontributi është 14,830 lekë, ndërsa për muajt maj – dhjetor 2009 është 16,120 lekë. Edhe për muajt janar – shkurt 2010, paga mbi të cilën është derdhur kontributi është 16,120 lekë.

**38.6.** Komisioni i kërkoi subjektit të rivlerësimit të deklarojë burimin e krijimit të të ardhurave të z. S.M. (vëllai i bashkëshortit), të cilat kanë shërbyer për krijimin e shumës 35,000 euro, dhënë hua në datën 23.2.2010 në favor të bashkëshortit të saj, si dhe të depozitojë dokumentacion justifikues ligjor për të provuar ligjshmërinë e këtyre të ardhurave.

<sup>29</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 21.10.2016.

<sup>30</sup> Vërtetim nr. \*\*\* prot., datë 5.11.2015.

<sup>31</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2017, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së (aneksi nr. \*\*\* ), protokolluar në ILDKPKI me nr. \*\*\* prot., datë 12.7.2017.

<sup>32</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2020, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 28.4.2020.

<sup>33</sup> Ligji nr. 9632, datë 30.6.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe udhëzimi nr. 655/1, datë 6.2.2007, “Për përcaktimin e uniformitetit të standardeve procedurale dhe të raportimit të sistemit të taksës vendore” (pika 1).

<sup>34</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2020.

<sup>35</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2020.

<sup>36</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2020.

**38.6.1.** Lidhur me burimin e të ardhurave të personit tjetër të lidhur, z. S.M., subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, deklaroi<sup>37</sup> se *kunati, vëllai i bashkëshortit, shtetasi S.M., ka një aktivitet privat zdrukthëtar në qytetin e M\*\*\*. Është subjekt fizik dhe tatimpagues i rregullt, është beqar dhe bashkëjeton me nënën e bashkëshortit.*

Për të provuar deklaramet e saj lidhur me ligjshmërinë e burimit të krijimit të shumës së dhënë hua nga shtetasi S. M., subjekti i rivlerësimit, me përgjigjet e pyetësorit nr. 2<sup>38</sup>, si dhe me shkresat<sup>39</sup> e depozituara në datën 19.5.2020 në Komision, ndër të tjera, ka dërguar dokumentacionin provues (prova të reja) si vijon:

- i. fletë e printuar nga sistemi tatimor “informacion i përgjithshëm mbi tatimpaguesin”, ku pasqyrohet data e regjistrimit të subjektit “S.M.”, person fizik (datë 29.1.2008), lloji i aktivitetit “punime druri, dyer dritare, art, dekor” dhe xhiroja e parashikuar 4,500,000 lekë;
- ii. vërtetim, datë 25.10.2016, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, Bashkia Kurbin, me anë të të cilit vërtetohet se subjekti fizik “S.M.” nuk ka detyrime të paguara ndaj Bashkisë Kurbin;
- iii. vërtetim, datë 7.5.2020, lëshuar nga Drejtoria e Planifikimit të të Ardhurave Vendore, Bashkia Kurbin, nëpërmjet të cilit vërtetohet se subjekti “S.M.”, person fizik, ka paguar taksat dhe tarifatat vendore, si vijon: për vitin 2008 në shumën 90,000 lekë; për vitin 2009 në shumën 85,000 lekë; për vitin 2010 në shumën 90,800 lekë dhe se llogaritja e taksës së biznesit është bërë sipas deklaratës parashikuese të qarkullimit vjetor prej 4,000,000 deri 6,000,000 lekë, sipas ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006.

**38.6.1.1.** Komisioni vëren se, në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, në referim të nenit 11 dhe aneksit nr. 5 të këtij ligji, si dhe bazuar në informacionin e dërguar nga Bashkia Kurbin, për nga lloji i aktivitetit dhe kategoria/zona ku është ushtruar aktiviteti, tatimpaguesi “S.M.”, person fizik, për vitet 2008 dhe 2009 ka paguar taksa vendore për biznesin e vogël që i korrespondon nivelit të qarkullimit deri në 6,000,000 lekë. Referuar pikës 3 të nenit 10 të këtij ligji, çdo subjekt i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet, gjatë vitit fiskal, një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 8,000,000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël.

**38.6.1.2.** Por, bazuar në nenin 12 të ligjit nr. 9844, datë 17.12.2007, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë, 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të cilët realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8,000,000 lekë dhe jo më pak se 2,000,000 lekë, janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale. Në nenin 12/1 të këtij ligji përcaktohet se shkalla tatimore e aplikueshme mbi të ardhurat e tatueshme të bizneseve të vogla, subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, është 10%.

**38.6.1.3.** Drejtoria Rajonale Tatimore Lezhë, e cila ka në administrim subjektet tregtare, të cilat ushtrojnë aktivitet në Bashkinë e Kurbinit, nuk ka dhënë informacion lidhur mbi të ardhurat e realizuara nga ky subjekt tregtar për periudhën 2008 – 2009, dhe as për pagesën e detyrimeve tatimore.

<sup>37</sup> Përgjigjja e pyetjes nr. 3, të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni.

<sup>38</sup> Përgjigjet e dërguara në Komision në rrugë elektronike me *e-mail*-in e datës 10.5.2020.

<sup>39</sup> Prova mbështetëse për deklaramet e dhëna në pyetësorin nr. 2, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2020.

iii. Disa fatura të thjeshta tatimore (model A4), të cilat pasqyrojnë shitje të kryera (prodhim - shitje mobilie dhe shërbime për punim druri) nga subjekti “S.M.”, me NIPT \*\*\*, për periudhën 2008 – 2009, të dhënat përmbledhëse të të cilave pasqyrohen në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 1.**

Nr.	Nr. i faturës	Datë	Blerësi	Shuma në euro	Shuma në lekë
1	101	9.6.2008	V***	0	53,100
2	102	25.6.2008	V*** B***	4,979	
3	103	10.10.2008	Universiteti “****”	0	1,202,000
4	104	20.11.2008	E. D.	0	1,428,000
5	105	27.12.2008	P. C., Fier	13,080	
6	107	27.2.2009	Sh***	0	65,000
7	110	27.5.2009	Vreshtaria “****”	0	323,850
8	112	11.8.2009	Universiteti “****”	4,100	
9	113	24.8.2009	Universiteti “****”, Fier	550	
10	114	2.11.2009	Vreshtaria “****”	0	25,500
	<b>Totali</b>			<b>22,709</b>	<b>3,097,450</b>

iv. Kontratë shërbimi datë 5.9.2008, lidhur ndërmjet shtetasit S.M. - si individ (furnizues i shërbimit) dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., (porositësi).

**38.6.1.4.** Referuar kësaj kontrate, furnizuesi merr përsipër të kryejë për porositësin shërbimin e klasifikuar në punimin e drurit që ka të bëjë me gdhendjen, art-dekorin, lyerjen në cilësinë e kërkuar nga porositësi për objektet: amfiteatri i universitetit “\*\*\*\*”, dyert e “\*\*\*\*”, Tiranë, për degën Fier, bibliotekën e universitetit “\*\*\*\*”, etj., sipas nevojave të porositësit, me çmimet e përcaktuara nga furnizuesi. Në nenin 2 të kësaj kontratë, me titull “Çmimi”, përcaktohet se çmimi i shërbimit, objekt i kësaj kontrate, do të jetë në vlerën totale 60,000 euro, shërbim që do të ofrohet për një periudhë 2-vjeçare.

**38.6.1.5.** Ndërsa në nenin 4 të kësaj kontrate me titull “Mënyra e pagesës” përcaktohet se porositësi bie dakord të paguajë furnizuesin në përputhje me çmimin e kontratës, si vijon: (i) pagesa do kryhet *cash*; (ii) monedha e pagesës do të jetë në euro; dhe (iii) në lidhje me këtë pagesë me vlerë totale 60,000 euro, porositësi ka detyrimin të paguajë tatimin në burim sipas parashikimeve ligjore të legjislacionit “Për tatimet”.

**38.6.1.6.** Subjekti i ka bashkëlidhur kësaj kontrate 7 mandatpagesa të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për periudhën 2009 – 2010, me të dhënat përmbledhëse të pasqyruara në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 2.**

Nr.	Nr. mandati	Datë	Shuma në euro	Përshkrimi
1	1044	7.9.2009	20,000	<i>Punime druri amfiteatri</i>
2	1327	24.10.2009	10,000	<i>Pag. e pjesshme dyer të bibliotekës</i>
3	1584	8.12.2009	10,000	<i>Pun. druri salla e konferencave</i>

4	588	30.5.2009	2,000	<i>Likuidim i pjesshëm dyer, TV</i>
5	940	11.8.2009	2,100	<i>Punime te rezidenca</i>
6	986	24.8.2009	550	<i>Lyerje dhe stukim fasade, Fier</i>
7	102	20.1.2010	5,000	<i>Punimet e drurit</i>
	<b>Totali</b>		<b>49,650</b>	

**38.6.1.7.** E pyetur nga Komisioni lidhur me shumën neto të përfituar nga personi tjetër i lidhur, z. S. M. , nga kontrata e shërbimit datë 5.9.2008, kohën e kryerjes së pagesës së fundit të çmimit të shërbimit, si dhe pagesën e tatimit në burim mbi këto të ardhura, subjekti i rivlerësimit deklaroi se<sup>40</sup> ... *pas sqarimeve me kunatin e saj, ai i konfirmoi se vlera neto e përfituar nga shërbimi i kryer është në shumën 60,000 euro, sipas mandatpagesave të kryera nga universiteti “\*\*\*”. Pra, vlera neto e përfituar nga kryerja e këtij shërbimi referuar kontratës është 60,000 euro. Tatimi mbi të ardhurat do të paguhej nga porositësi sipas kushteve të kësaj kontrate. Pagesa e fundit është mbyllur me datën 5.8.2010, fakt i provuar me mandatpagesën e kësaj date.*

**38.6.1.8.** Subjekti ka bashkëlidhur 2 mandatpagesa: (i) mandatpagesën nr. \*\*\*, të datës 29.1.2010, për shumën 10,000 euro, me përshkrimin “pagesë punime druri te biblioteka”; si dhe (ii) mandati nr. \*\*\*, datë 5.8.2010, për shumën 5,000 euro, me të njëjtin përshkrim.

**38.6.1.9.** Pra, duket se para datës së dhënies së huas subjekti pretendon se personi tjetër i lidhur, z. S.M., ka përfituar në total nga marrëdhënia kontraktuale me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., shumën neto prej 59,650 euro.

**38.6.1.10.** Rezulton se subjekti i rivlerësimit ka kërkuar informacion nga Drejtoria e Përgjithshme e Tatimeve<sup>41</sup> në lidhje me derdhjet e tatimit në burim të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. – për të ardhurat e përfituara nga personi tjetër i lidhur – bazuar në kontratën e shërbimit të lidhur mes tij dhe kësaj shoqërie, por duket se nuk ka disponuar informacionin e kërkuar.

**38.6.1.11.** Me qëllim kryerjen e një hetimi sa më të plotë dhe të gjithanshëm, Komisioni i kërkoi<sup>42</sup> Drejtorisë së Përgjithshme të Tatimeve të informojë nëse në referim të kontratës së sipërcituar shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, ka mbajtur në burim, deklaruar dhe paguar detyrimin tatimor për të ardhurat e realizuara nga personi tjetër i lidhur.

**38.6.1.12.** Në përgjigje të kërkesës së mësipërme, DRT-ja Tiranë<sup>43</sup> informon se nga të dhënat që disponojnë shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. nuk ka kryer pagesa në lidhje me tatimin në burim (tatim mbi qiranë) për vitet 2009 – 2010.

**38.6.1.13.** Në vijim, Komisioni iu drejtua<sup>44</sup> DRT-së Tiranë, duke i kërkuar të konfirmojë nëse subjekti “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, përgjatë viteve 2009 – 2010 ka mbajtur në

<sup>40</sup> Përgjigjja e pyetjes nr. 1, të pyetësorit nr. 3.

<sup>41</sup> Me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 21.5.2020, DPT-ja i kërkon subjekti t’i vejë në dispozicion NIPTI-n e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. Ndërsa, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 16.7.2020, DPT-ja njofton subjektin e rivlerësimit se kërkesa i është dërguar për kompetencë DRT-së Tiranë (NIPT-i i identifikuar).

<sup>42</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2020.

<sup>43</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 12.11.2020.

<sup>44</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 9.12.2020.



burim, deklaruar dhe paguar detyrime tatimore mbi të ardhura të realizuara nga individë – të cilët i kanë ofruar shërbime.

**38.6.1.14.** Në përgjigje të kërkesës së përsëritur – të sipërcituar, sërish DRT-ja Tiranë<sup>45</sup> informon se subjekti “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, nuk ka kryer pagesa për tatimin në burim nga qiratë për periudhën 2009 – 2010, duke mos dhënë informacion për pagesa të mundshme të tatimit të mbajtur në burim për të ardhura të realizuara nga individë të cilët i kanë ofruar shërbime kësaj shoqërie.

**38.6.1.15.** Lidhur me të ardhurat dhe fitimet e realizuara nga aktiviteti tregtar i personit tjetër të lidhur bashkëlidhur përgjigjeve të pyetësorit nr. 3 – subjekti i rivlerësimit ka depozituar deklaratën e shtetasit S.M.<sup>46</sup>, sipas të cilës ai ka deklaruar se fitimi për vitin 2008 është 2,782,139 lekë dhe për vitin 2009 është 574,341 lekë. Në mbështetje të deklaramit të shtetasit S.M. janë paraqitur pasqyra analitike të të ardhurave dhe shpenzimeve për subjektin “S.M.” person fizik, për vitet 2008 – 2009<sup>47</sup>. Duket se fitimi neto i pretenduar nga subjekti/personi tjetër i lidhur për aktivitetin tregtar të kryer nga tatimpaguesi “S.M.”, person fizik, për vitet 2008 – 2009, është 56.5% e qarkullimit.

**38.6.1.16.** E pyetur nga Komisioni nëse z. S.M. ka investuar në pasuri të paluajtshme dhe/apo të luajtshme për periudhën 2008 – 2010, subjekti i rivlerësimit deklaroi se<sup>48</sup> *...sipas informacionit të marrë nga kunati i saj, z. S.M. nuk ka kryer asnjë investim në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme.*

**38.6.1.17.** Nga hetimi i kryer<sup>49</sup> Komisioni nuk identifikoi investime të kryera në pasuri të luajtshme apo të paluajtshme nga personi tjetër i lidhur, z. S.M., për periudhën 2008 – 2010.

**38.6.1.18.** Në analizë të të dhënave të mësipërme, duket se fitimi neto i vetëdeklaruar nga personi tjetër i lidhur nga ushtrimi i aktivitetit tregtar për vitet 2008 – 2009 nuk mbështetet në dokumentacion justifikues ligjor dhe nuk dokumentohet pagesa e detyrimeve tatimore për qarkullimin e kryer nga ky tatimpagues për fashën mbi 2,000,000 lekë për periudhën 2008 – 2009, si dhe deklarimi, mbajtja në burim, dhe pagesa e tatimit mbi të ardhurat personale nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në referim të kontratës së shërbimit të sipërcituar.

**38.6.1.19.** Bazuar në nenin 52 të ligjit nr. 84/2016, subjektit iu kalua barra e provës për të dhënë argumentet/shpjegimet përfundimtare dhe të depozitojë prova të reja të mundshme, për të provuar ligjshmërinë e burimeve financiare të personit tjetër të lidhur, të cilat kanë shërbyer për dhënien e huas në shumën 35,000 euro, në shkurt të vitit 2010.

### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**39.** Në prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit lidhur me të ardhurat e përfituara nga aktiviteti tregtar i tatimpaguesit “S.M.”, person fizik, subjekti i rivlerësimit ka argumentuar se ky tatimpagues është regjistruar në organet tatimore prej datës 29.1.2008, me NIPT \*\*\*, ka zhvilluar aktivitet me objekt “punime druri, dyer, dritare, art, dekor” dhe sipas informacionit të marrë nga Drejtoria e Taksave Vendore (Bashkia Kurbin), për vitet 2008 – 2009, ka deklaruar fashën e qarkullimit nga

<sup>45</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 5.1.2021.

<sup>46</sup> Deklaratë e datës 16.7.2020.

<sup>47</sup> Provat e depozituara nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 3, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 28.7.2020.

<sup>48</sup> Përgjigje e pyetjes nr. 2, b), e pyetësorit nr. 3.

<sup>49</sup> (i) Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2020 dhe përgjigjet e ardhura nga DPSHTRR-ja – administruar në dosje; (ii) shkresa nr. \*\*\* prot., datë 14.4.2020, drejtuar bankave të nivelit të dytë që operojnë në Republikën e Shqipërisë dhe përgjigjet e ardhura nga bankat – administruar në dosje; (iii) shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.9.2020, drejtuar ASHK-së dhe përgjigjet e drejtorive/zyrave vendore të ASHK-së – administruar në dosje.

4,000,000 – 6,000,000 lekë, për të cilën ka paguar edhe taksën vendore të biznesit të vogël, në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 30.10.20006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar.

**39.1.** Në vijim, referon ndryshimet ligjore të bëra në fund të vitit 2007<sup>50</sup>, sipas të cilave subjektet e taksës vendore mbi biznesin e vogël – të cilët realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8,000,000 lekë dhe jo më pak se 2,000,000, janë subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale dhe detyrohen të deklarojnë të ardhurat dhe shpenzimet, si dhe të paguajnë tatimin mbi të ardhurat personale në masën 10% mbi fitimin.

**39.2.** Sipas të dhënave të deklaruara – në referim faturave të paraqitura, personi fizik “S.M.”, në vitin 2008 ka realizuar qarkullim në shumën prej 4,879,759 lekësh dhe fitim në shumën prej 2,782,139 lekësh.

**39.3.** Pikërisht mbi këto të dhëna subjektit i lindte detyrimi për të deklaruar dhe paguar tatimin mbi të ardhurat personale mbi fitimin e realizuar, e cila shkon në 10% të fitimit prej 2,782,139 lekësh, shumë e cila është e barabartë me 278,213 lekë. Pra, subjekti pretendon se vlera neto e të ardhurave të përfituara për këtë vit që duhet të marrë në konsideratë, pas zbritjes së detyrimit, është 2,503,926 lekë.

**39.4.** Ndërkohë, meqenëse sipas të dhënave të vetëdeklaruara për vitin 2009 personi fizik “S.M.” ka pasur një qarkullim prej 1,025,568 lekësh, duke realizuar një fitim prej 574,341 lekësh, subjekti sqaron se nuk i lindte detyrimi për të llogaritur dhe paguar tatimin mbi të ardhurat personale, për shkak se qarkullimi i tij vjetor ishte nën 2,000,000 lekë.

**39.5.** Pra, si përfundim, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se fitimi neto nga aktiviteti tregtar i personit fizik “S.M.” për vitin 2008 - 2009, ka qenë në shumën 3,078,266 lekë, duke parashtruar se këto të ardhura janë reale por edhe të ligjshme, mbi bazën e dokumenteve të paraqitura.

**39.6.** Lidhur me të ardhurat e shtetasit S.M., të realizuara si individ nga marrëdhënia kontraktuale me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k., subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se:

- i. së pari, sipas ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, kreu “Tatimi mbi të ardhurat personale”, në nenin 8 (e ardhura e tatueshme në germen “g”), përfshihen të gjitha të ardhurat e tjera të realizuara nga individë rezidentë, për rastet kur përfituesi nuk është i regjistruar në organet tatimore;
- ii. së dyti, sipas nenit 33 të këtij ligji, të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë janë të detyruar të mbajnë tatimin në burim nga shuma e pagesave bruto në lidhje me shërbimet që marrin nga individë rezidentë. Në këtë rast detyrimi për mbajtjen e tatimit në burim mbi të ardhurat i takon agjentit të mbajtjes së tatimit në burim, që në rastin konkret është një shoqëri;
- iii. së treti, në ligjin nr. 9920 datë 19.5.2008, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, në nenin 117 janë përcaktuar dënimet me gjobë për agjentët e mbajtjes së tatimit në burim kur ata ose nuk mbajnë tatimin në burim ose edhe kur e mbajnë tatimin në burim por nuk e paguajnë. Pra, edhe dënimet me gjobë të cilat shkojnë deri edhe në 100% të detyrimit, parashikohen kundrejt agjentit të mbajtjes së tatimit në burim dhe jo ndaj individit rezident, i cili nuk ka as detyrim për ta deklaruar dhe as detyrim për ta paguar;
- iv. në vijim, subjekti argumenton se në këtë rast ndodhemi përpara një kontrate shërbimi të lidhur midis S.M. (individ rezident) dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. (agjenti i mbajtjes së tatimit në burim). Pra, jemi në rastin e aplikimit të nenit 33

<sup>50</sup> Ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë, 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar.

të ligjit nr. 8438 “Për tatimin mbi të ardhurat”, ku z. S.M. është paguar për shërbimin e kryer, ndërsa detyrimin për mbajtjen, deklarimin dhe pagesën e tatimit e ka pasur shoqëria, kjo në përputhje edhe me parashikimet e bëra në kontratë.

- v. si përfundim, subjekti argumenton se të ardhurat e realizuara nga personi tjetër i lidhur për vitet 2008 - 2010, si individ dhe si subjekt tregtar, personi fizik, janë totalisht të justifikuar dhe të ligjshme dhe shuma totale e krijuar, lehtësisht rezulton se është mbi vlerën prej 35,000 euro, të dhënë hua në favor të bashkëshortit të saj në datën 23.2.2010.
- vi. gjithashtu, në prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit subjekti i rivlerësimit ka referuar të dhëna lidhur me kreditime në vlera të konsiderueshme në llogaritë bankare të personit tjetër të lidhur, për periudhën gusht 2006 – shkurt 2010 (periudhë para dhënies së huas).

### **Arsyetimi ligjor dhe analiza e provave në lidhje me faktet dhe ligjin e zbatueshëm**

#### **Lidhur me të ardhurat nga aktiviteti tregtar i personit tjetër të lidhur**

**40.** Referuar legjisllacionit fiskal në fuqi për kohën, në bazë pikës 3 të nenit 10 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, çdo subjekt i cili kryen një biznes, me anë të të cilit realizohet gjatë vitit fiskal një e ardhur bruto vjetore (qarkullim) më e vogël ose e barabartë me 8,000,000 (tetë milionë) lekë, i nënshtrohet detyrimit të pagesës së taksës vendore mbi biznesin e vogël.

**40.1.** Sikurse është pasqyruar edhe më sipër, rezulton se në përputhje me ligjin nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, dhe konkretisht në referim të nenit 11 dhe Aneksit nr. 5 të këtij ligji, si dhe bazuar në informacionin e dërguar nga Bashkia Kurbin, për nga lloji i aktivitetit dhe kategoria/zona ku ka ushtruar aktivitet, tatimpaguesi “S.M.” person fizik, për vitet 2008 - 2009 ka paguar taksën vendore për biznesin e vogël që i korrespondon nivelit të qarkullimit deri në 6,000,000 lekë.

**40.2.** Komisioni vëren se, pavarësisht se subjekti tregtar “S.M.”, person fizik, për vitet 2008 - 2009 ka paguar taksat vendore për një qarkullim deri në 6,000,000 lekë, gjatë hetimit administrativ dhe me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar qarkullimin e realizuar nga ky tatimpagues bazuar në dokumentacion provues, fatura të thjeshta tatimore – Model A4 (fatura të njohura nga administrata tatimore), dhe konkretisht për vitin 2008 qarkullim në shumën 4,879,759 lekë dhe për vitin 2009 qarkullim në shumën 1,025,568 lekë.

**40.3.** Por, bazuar në nenin 12 të ligjit nr. 9844, datë 17.12.2007, “Për disa ndryshime në ligjin nr. 8438, datë, 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, personat fizikë dhe juridikë, subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, sipas kuptimit të nenit 10 të ligjit nr. 9632, datë 30.10.2006, “Për sistemin e taksave vendore”, të cilët realizojnë një qarkullim vjetor jo më shumë se 8,000,000 lekë dhe jo më pak se 2,000,000 lekë, janë subjekte të tatimit mbi të ardhurat personale.

**40.4.** Në nenin 12/1 të ligjit të sipërcituar, përcaktohet se shkalla tatimore e aplikueshme mbi të ardhurat e tatueshme të bizneseve të vogla, subjekt i tatimit mbi të ardhurat personale, është 10%. Ndërsa në nenin 12/2 “Shpenzimet e njohura” përcaktohet se për efekt të përcaktimit të së ardhurës së tatueshme, subjekteve të taksës vendore të biznesit të vogël do t’u njihen si shpenzime nga të ardhurat, gjithsej të gjitha shpenzimet e kryera ose të lindura gjatë periudhës tatimore, që janë tërësisht të lidhura me qëllimin e biznesit.

**40.5.** Gjithashtu, me ndryshimet e bëra në ligjin nr. 8438, datë, 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, me ligjin nr. 9844, datë 17.12.2007 – të referuar si më sipër, në fund të

nenit 8 “E ardhura e tatueshme”, është shtuar germa “gj”, në referim të së cilës klasifikohen si të ardhura të tatueshme, të ardhurat e realizuara gjatë periudhës tatimore nga ato subjekte të taksës vendore mbi biznesin e vogël, që kanë një qarkullim më të madh se 2,000,000 lekë deri në 8,000,000 lekë në vit, të cilat llogariten si diferencë ndërmjet të ardhurave, gjithsej me shpenzimet e njohura, të specifikuara në nenin 12/2 të këtij ligji.

**40.6.** Sa më sipër, Komisioni vlerëson se subjekti tregtar “S.M.” për periudhën tatimore - viti 2008, vit gjatë të cilit pretendohet se ka realizuar një qarkullim mbi 2,000,000 lekë, ka pasur detyrimin për të dorëzuar në drejtorinë rajonale tatimore përkatëse deklaratën e të ardhurave për biznesin e vogël (TABV) dhe gjithashtu bazuar në pasqyrën e të ardhurave dhe shpenzimeve ka pasur detyrim të paguante tatimin mbi të ardhurat (në rastin se do dilte me pagesë, pra, nëse të ardhurat do ishin më të larta se shpenzimet e njohura). Theksojmë këtu se sistemi tatimor në Republikën e Shqipërisë bazohet në vetëdeklarimin e subjekteve tregtare.

**40.7.** Komisioni vëren se subjekti ka pranuar se për vitin 2008 tatimpaguesi “S.M.”, person fizik, nuk ka depozituar deklaratën TABV, me pretendimin e mungesës së njohurive për shkak të ndryshimit të legjislacionit. Ndërsa, për vitin 2009 subjekti argumenton se për shkak se qarkullimi ka qenë më i vogël se 2,000,000 lekë, ky tatimpagues nuk ka pasur detyrimin për të depozituar deklaratën e TABV.

**40.8.** Bazuar në legjislacionin tatimor në fuqi për kohën, në mungesë të depozitimit të deklaratës së të ardhurave për biznesin e vogël (TABV), Komisioni arrin në konkluzionin se për vitin 2008, subjekti tregtar “S.M.”, person fizik, ka paguar detyrimet përkatëse vetëm sa i takon qarkullimit deri në fashën 2,000,000 lekë. Gjithashtu, në konsideratë të faktit se për vitin 2009 ka pretenduar një qarkullim nën 2,000,000 lekë (bazuar në faturat e thjeshta tatimore – qarkullim për këtë vit pretendohet në vlerën prej 1,025,568 lekësh), Komisioni vlerëson se ky tatimpagues ka paguar detyrimet përkatëse, për sa i takon qarkullimit të pretenduar.

**40.9.** Pra, ky trup gjykues çmon se qarkullimi i realizuar nga subjekti tregtar “S.M.”, person fizik, për vitet 2008 - 2009, do të njihet në shumën 3,025,568 lekë.

**40.10.** Lidhur me normën e fitimit mbi qarkullimin e realizuar, subjekti, gjatë hetimit administrativ, si dhe në prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, ka pretenduar se fitimi neto i tatimpaguesit “S.M.”, person fizik, për vitet 2008 - 2009, ka qenë rreth 56,5 % e qarkullimit.

**40.11.** Në kushtet kur duket se aktiviteti tregtar i këtij tatimpaguesi përfshin edhe shërbimin krahas përpunimit të materialeve drusore dhe rishitjes së tyre, si dhe në mungesë të të dhënave të pakundërshtueshme mbi shpenzime të tjera të mundshme – krahas atyre të vetëdeklaruar, Komisioni vlerësoi të pranojë pretendimin e subjektit, duke aplikuar si normë fitimi 56,5 % të qarkullimit të njohur dhe për të cilin janë paguar detyrimet përkatëse.

**40.12.** Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se në kuptim të pikës 3 të nenit D të Aneksit të Kushtetutës, si e ardhur e ligjshme neto nga ushtrimi aktivitetit tregtar i subjektit “S.M.”, person fizik, për vitet 2008 - 2009, do të njihet shuma prej 1,709,445 lekësh.

#### **Lidhur me të ardhurat e personit tjetër të lidhur, të realizuara si individ**

**41.** Siç u vu në dukje më sipër, subjekti i rivlerësimit ka pretenduar se personi tjetër i lidhur, z. S.M.– krahas të ardhurave të përfituara nga aktiviteti tregtar i regjistruar për periudhën maj 2009 – janar 2010 (para dhënies së huas), ka përfituar të ardhura si individ në vlerën 59,650 euro, për shërbime të kryera në favor të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k.

**41.1.** Subjekti i rivlerësimit ka depozituar kontratën e shërbimit të datës 5.9.2008, lidhur mes z. S.M.– si individ, në cilësinë e furnizuesit të shërbimit, dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., në cilësinë e porositësit, si dhe disa mandatpagesa që lidhen me këtë kontratë. Gjithashtu, me dërgimin e prapësimeve subjekti ka depozituar disa fotografi – për të cilat sqaron se kanë të bëjnë me imazhe për punë të kryera nga z. S.M., në ambiente të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**41.2.** Në vlerësim të shpjegimeve të dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, si dhe të provave dhe *indicieve* të depozituara në mbështetje të tyre, trupi gjykues krijoi bindjen se kjo marrëdhënie kontraktuale është reale dhe se, si rrjedhim, arrin në përfundimin se z. S.M. ka përfutur të ardhura nga shërbimi i kryer në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.

**41.3.** Në këtë kuptim, Komisioni vlerëson se bazuar në nenin 246 të Kodit të Procedurës Civile, kontrata e shërbimit e datës 5.9.2008, lidhur mes z. S.M. dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., merr fuqi provuese për efekt të këtij procesi – për sa kohë që gjen mbështetje dhe harmonizohet me të dhënat dhe informacionet e grumbulluara nga Komisioni në kuadër të hetimit administrativ të kryer.

**41.4.** Komisioni vëren se në përputhje me objektin e kontratës, furnizuesi (z. S.M.) ka marrë përsipër të kryejë për porositësin (shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.) shërbimin e klasifikuar në punimin e drurit, që ka të bëjë me gdhendjen, art-dekorin, lyerjen, në cilësinë e kërkuar nga porositësi për objekte në pronësi/përdorim të tij, sipas nevojave, për një periudhë 2-vjeçare, me çmim të përcaktuar të shërbimit në vlerën totale 60,000 euro<sup>51</sup>.

**41.5.** Referuar kontratës, por edhe nga verifikimi i mandatpagesave, duket se personi tjetër i lidhur ka kryer kryesisht shërbim mbi materialet e porositësit, dhe jo ripërpunim apo furnizim mallrash të blera më parë prej tij.

**41.6.** Komisioni vëren se në këtë kontratë përcaktohet se porositësi bie dakord të paguajë furnizuesin në përputhje me çmimin e kontratës, si vijon: (i) pagesa do të kryhet *cash*; (ii) monedha e pagesës do jetë në euro; dhe (iii) në lidhje me këtë pagesë me vlerë totale 60,000 euro, porositësi ka detyrimin të paguajë tatimin në burim, sipas parashikimeve ligjore të legjislacionit “Për tatimet”<sup>52</sup>.

**41.7.** Lidhur me pagesën e detyrimeve tatimore në funksion të kësaj kontrate shërbimi, Komisioni vëren se ligji nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, është ligji bazë mbi të cilën rregullohen marrëdhëniet që lindin në fushën e tatimit mbi të ardhurat në tri kategori kryesore: (i) tatimi mbi të ardhurat personale; (ii) tatimi mbi fitimin; dhe (iii) tatimi i mbajtur në burim i të ardhurave. Detyrimi tatimor lind kur personi realizon të ardhura, kur bëhet pronar i një pasurie apo kryen pagesa, të cilat janë objekt i tatimit, sipas legjislacionit në fuqi.

**41.8.** Në nenin 4 të këtij ligji, “Burimi i të ardhurave”, janë përcaktuar llojet e të ardhurave të realizuara nga një burim në Republikën e Shqipërisë, por pa u kufizuar vetëm në to, dhe një nga kategoritë janë të ardhurat e parashikuara në germen “b”, *të ardhurat nga veprimtari kulturore apo sportive, si dhe nga veprimtari të tjera, personale në Republikën e Shqipërisë.*

**41.9.** Fusha e veprimit të tatimit mbi të ardhurat për kategoritë e të ardhurave personale shtrihet mbi të ardhurat e individëve (neni 6), të cilët janë rezidentë, në kuptim të Kodit Civil, dhe në kuptim të nenit 7 të ligjit të sipërcituar, i nënshtrohen detyrimit për tatimin

<sup>51</sup> Referohu nenit 1 dhe nenit 2, të kontratës së shërbimit të datës 5.9.2008.

<sup>52</sup> Referohu nenit 4 të kontratës.

mbi të ardhurat personale gjatë periudhës tatimore për të gjitha burimet e të ardhurave, sipas parashikimeve të këtij kreu.

**41.10.** Për sa më sipër, si dhe bazuar në germën “g” të pikës 1 të nenit 8 të ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Komisioni vlerëson se të ardhurat e përfituara nga z. S.M. në funksion të kontratës së shërbimit të sipërcituar, janë të ardhura të tatueshme<sup>53</sup>.

**41.11.** Por, nga ana tjetër, Komisioni vëren se në referim të germës “e” të pikës 1 të nenit 33 të këtij ligji, “Mbjajtja në burim e tatimit mbi të ardhurat” (dispozita në fuqi në kohën e nënshkrimit dhe zbatimit të kontratës së shërbimit<sup>54</sup>), të gjithë personat rezidentë në Republikën e Shqipërisë, organet e qeverisjes qendrore dhe vendore, organizatat jofitimprurëse dhe çdo subjekt tjetër, të njohur nga legjislacioni në fuqi, **janë të detyruar të mbajnë në burim në masën 10% nga shuma bruto e pagesave, edhe mbi pagesat për ndërtim, instalim, montim, ose për punë mbikëqyrëse, që lidhen me to.**

**41.12.** Ndërsa, në pikën 5.1 të udhëzimit të Ministrisë të Financave, nr. 5, datë 30.1.2006, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, përcaktohet se në zbatim të nenit 33 të ligjit, të gjithë personat, përfshirë personat juridikë, ortakëritë, personat fizikë tregtarë rezidentë tatimorë në Shqipëri, organet e qeverisjes qendrore apo vendore, organizatat jofitimprurëse, dhe çdo ent apo person juridik i krijuar si i tillë në Shqipëri, **që bën pagesë të çdonjërës nga llojet e pagesave që listohen në nenin 33, është i detyruar të mbajë tatim në burim dhe ta derdhë atë në organin tatimor përkatës jo më vonë se data 20 e muajit që pason muajin në të cilin është kryer pagesa.**

**41.13.** Në këtë këndvështrim, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se, në këtë rast detyrimi për mbajtjen e tatimit në burim mbi të ardhurat i takon agjentit të mbajtjes së tatimit në burim, që në rastin konkret është shoqëria “\*\*\*” sh.p.k.

**41.14.** Referuar germës “c” të nenit 5 të ligjit nr. 9920, 19.5.2009, “Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, “Agjent i mbajtjes së tatimit në burim” është personi të cilit, sipas legjislacionit tatimor, i kërkohet të llogarisë, të mbajë tatimin në burim për një tatimpagues, të raportojë dhe t’i transferojë këto tatime në Buxhetin e Shtetit.

**41.15.** Në nenin 7 të këtij ligji janë përcaktuar të drejtat dhe detyrimet e agjentit të mbajtjes së tatimit në burim, ku ndër të tjera, parashikohet se agjenti i mbajtjes së tatimit ka detyrë të llogarisë saktësisht dhe të mbajë në burim tatimin për një tatimpagues, si dhe të paguajë tatimin në burim në Buxhetin e Shtetit, në datën e përcaktuar në ligj. Ndërsa, në nenin 117 përcaktohen dënimet/penalitetet për agjentët e e mbajtjes së tatimit në burim, në rast të mospëmbushjes së këtyre detyrimeve ligjore.

**41.16.** Nga vlerësimi në harmoni i dispozitave të referuara si më sipër, në kushtet kur rezultoi e provuar se z. S.M. e ka lidhur kontratën e shërbimit si individ, Komisioni arrin përfundimin se mbajtja, deklarimi dhe pagesa e tatimit në burim ka qenë detyrim i shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., e cila në këtë rast luan rolin e agjentit të mbajtjes së tatimit në burim.

**41.17.** Lidhur me mbajtjen dhe pagesën e tatimit në burim nga shoqëria “\*\*\*” sh.p.k., Komisioni vëren se subjekti i rivlerësimit ka bërë përpjekje për të siguruar informacion nga Drejtoria e Tatimeve, por duket se në kuptim të nenit 24 të ligjit nr. 9920, datë 19.5.2008, Për procedurat tatimore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nuk është

<sup>53</sup> Shtuar germa “g” në nenin 8 të ligjit nr. 8438/1998, me ndryshimet e bëra me ligjin nr. 9161, datë 18.12.2003, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (neni 2 i këtij ligji).

<sup>54</sup> Sipas ndryshimeve të bëra me ligjin nr. 9326, datë 6.12.2004, “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 8438, datë 28.12.1998, “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar (neni 16 i këtij ligji).

legjitimuar për të disponuar këtë informacion. Gjithashtu, me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit subjekti ka depozituar kopje të ekstraktit të Regjistrimit Tregtar për të Dhënat Subjektit “shoqëri me përgjegjësi të kufizuar”, “\*\*\*\*” sh.p.k., me NIPT \*\*\*, nga ku rezulton se ky subjekt është me status “pezulluar”.

**41.18.** Megjithëse më sipër u arrit në konkluzionin se mbajtja, deklarimi dhe pagesa e tatimit në burim – në këtë rast ka qenë detyrim i shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., vlen të theksohet fakti se edhe Komisioni bëri përpjekje për të disponuar të dhëna nga Drejtoria Rajonale Tatimore Tiranë lidhur me pagesa të mundshme detyrimesh tatimore të kryera nga kjo shoqëri – mbi të ardhura të realizuara nga individë të cilët i kanë ofruar shërbime, por gjithsesi nuk mundi të sigurojë informacionin e kërkuar, qoftë edhe negativ.

**41.19.** Si konkluzion, bazuar në analizën ligjore të kryer si më sipër, trupi gjykues vlerëson se të ardhurat e përfituara nga personi tjetër i lidhur, z. S.M., si rezultat i shërbimit të kryer në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., janë të ardhura të ligjshme dhe, si të tilla, do të vlerësohen si të ardhura të mundshme të cilat kanë shërbyer për dhënien e huas në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

**41.20.** Komisioni çmon se *indicie* e rëndësishme e situatës financiare të personit tjetër të lidhur janë edhe kreditimet e evidentuara në llogaritë e tij bankare në “R\*\*\* Bank”, para dhe pas regjistrimit si tatimpagues. Rezulton se, krahas depozitimeve *cash* të bërë në mënyrë të vazhdueshme prej tij, për periudhën para regjistrimit si tatimpagues, evidentohen edhe 2 kreditime në vlera të konsiderueshme të bëra nga subjekti “\*\*\*\*” me të dhënat si vijon: (i) në datë 22.10.2007, kredituar në llogarinë në lekë të z. S.M., shuma prej 800,000 lekësh, me urdhërues vreshtari “\*\*\*\*”, me përshkrimin “\*\*\*\*” punime në kantierin M\*\*\*, V\*\*\* B\*\*\*”; dhe (ii) në datën 21.12.2007, kredituar në llogarinë në lekë të z. S.M., shuma prej 876,730 lekësh, me urdhërues “V\*\*\* B\*\*\*”, me përshkrimin “V\*\*\* B\*\*\* fat. \*\*\*, datë 15.12.2007, konventuar me kurs 120.1, transferta u krye nga V\*\*\* B\*\*\*”.

**41.21.** Gjithashtu, rezulton se llogarinë në euro të personit tjetër të lidhur në “R\*\*\* Bank”, në datën 7.4.2008 është depozituar nga shtetasi E.B. shuma 18,000 euro, me përshkrimin “E.B. derdh në llogari për punime druri”.

**41.22.** Fakti i bashkëpunimit me këtë shoqëri konfirmohet edhe nëpërmjet faturave tatimore të lëshura nga subjekti tregtar “S.M.”, person fizik, gjatë viteve 2008 - 2009<sup>55</sup>.

**41.23.** Rezulton se fatura nr. \*\*\*, datë 25.6.2008, është likuiduar nga subjekti “V\*\*\* B\*\*\*” në llogarinë bankare në euro të personit tjetër të lidhur, në “R\*\*\* Bank”, nëpërmjet transefertës së datës 11.9.2008, në vlerën 4,980 euro, me përshkrimin “V\*\*\* B\*\*\*, lik. fat. nr. \*\*\*, datë 25.7.2008, V\*\*\* B\*\*\*”.

**41.24.** Në dritën e këtyre fakteve të reja, duket se personi tjetër i lidhur, si individ, mund të ketë përfituar të ardhura të tjera nga shërbime të kryera në favor të shoqërisë “V\*\*\* B\*\*\*”, krahas atyre të evidentuara në faturat e thjeshta tatimore. Sjellim në vëmendje se, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, e pyetur lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka referuar se si burim i të ardhurave të huadhënësit (z. S.M.) janë kontrata porosie a shërbimi të realizuara me klientë të ndryshëm, duke referuar edhe subjektin tregtar “V\*\*\* B\*\*\*”.

**41.25.** Në vështrim të përgjithshëm, Komisioni evidenton faktin se marrëdhënia juridike e huadhënies është e plotë nga pikëpamja formale, konkretizuar me kontratë noteriale huaje – veprim juridik i dyanshëm, ku evidentohen qartësisht të drejtat dhe detyrimet e palëve, në kushtet e një marrëdhënie të lidhur mes dy familjarëve të afërt (2 vëllezërve

---

<sup>55</sup> Referohu të dhënave të pasqyruara në tabelën nr. 1, pjesë e këtij vendimi.

Metaliaj). Kjo hua është deklaruar si detyrim financiar në deklaratën periodike vjetore të vitit 2010. Në vijim, për vitet 2012, 2013, 2014 dhe 2016 janë deklaruar vlera të shlyera në total për shumën 22,000 euro dhe duket se detyrimi i mbetur në momentin e dorëzimit të deklaratës “Vetting” është 13,000 euro – dhe në këtë vlerë rezulton të jetë deklaruar nga subjekti.

**41.26.** Gjithashtu, nga hetimi i kryer nuk u evidentuan investime të kryera nga z. S.M. përgjatë periudhës së referuar nga subjekti – si periudhë gjatë të cilës janë realizuar të ardhurat e personit tjetër të lidhur<sup>56</sup>, të cilat kanë shërbyer si burim për dhënien e huas. Vlen të theksohet se, rezultoi e provuar se z. S.M. ka qenë me status “beqar” në kohën e dhënies së huas.

**41.27.** Bazuar në analizën e kryer lidhur me ligjshmërinë e burimit të të ardhurave të huadhënësit, vlerësohet se provat e depozituara arrijnë nivelin e provueshmërisë dhe janë të harmonizuara me shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ dhe me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit dhe, si rrjedhojë, ky trup gjykues krijoi bindjen se personi tjetër i lidhur, z. S.M., ka pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme, për të mundësuar plotësisht shumën e dhënë hua në favor të bashkëshortit të subjektit të rivlerësimit.

**41.28.** Sa më sipër, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme – të mjaftueshme, të cilat kanë mundësuar plotësisht pagesën e çmimit për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit me sipërfaqe 76 m<sup>2</sup>.

**42. Pasuria e llojit “apartament”, me sipërfaqe 96.5 m<sup>2</sup>,** ndodhur në Durrës, përfituar me kontratën<sup>57</sup> e sipërmarrjes së datës 13.4.2007, për çmimin 48,250 euro.

**42.1.** Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 58 m<sup>2</sup>, në vlerën 3,500,000 lekë – në bazë të kontratës<sup>58</sup> së shitjes datë 6.10.2007. Për këtë apartament, të ardhurat nga shitja e të cilit kanë shërbyer për prenotimin e pasurisë objekt vlerësimi, subjekti ka deklaruar se është blerë më parë bazuar në kontratën e datës 12.12.2001, në vlerën 1,000,000 lekë – vlerë kjo e siguruar nga pagat e punësuar në një firmë privatë italiane, ndihmësgjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Tiranë, si dhe kursimet familjare ndër vite. Gjithashtu, subjekti ka sqaruar se firma (shoqëria “\*\*\*\*”) që ka ndërtuar këtë apartament është e motrës së saj, znj. D.B.

**42.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite:** referuar DPV/2007 subjekti ka deklaruar prenotimin e apartamentit me sipërfaqe 96 m<sup>2</sup>, me vlerë 48,250 euro – paguar shuma 9,000 euro – me burim “pakësimin e gjendjes *cash*” deklaruar më parë në shumën 700,000 lekë dhe kursimet për vitin 2007 në vlerën 500,000 lekë. Në rubrikën “detyrime financiare ndaj personave juridikë dhe fizikë” të DPV/2007, subjekti ka deklaruar detyrimin 39,250 euro (detyrimi i shlyer 9,000 euro) ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për prenotimin e apartamentit në \*\*\*, Durrës.

**42.2.1.** Ndërsa, referuar DPV/2008 - 2010 subjekti ka deklaruar shlyerjet/detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., të pasqyruara si vijon: (i) për vitin 2008 shuma e shlyer 30,000 euro, detyrimi i mbetur 9,250 euro; (ii) për vitin 2009 shuma e shlyer

---

<sup>56</sup> Evidentohet gjendje në llogarinë bankare në euro të personit tjetër të lidhur, në shumën 7,639 euro në momentin e dhënies së huas, por nga ana tjetër transaksionet e kryera në këtë llogari kanë qenë të shumta, dhe gjendja e kësaj llogarie përgjatë vitit 2007 ka qenë në vlerë të konsiderueshme, disa herë më e lartë se gjendja e evidentuar në datën e dhënies së huas.

<sup>57</sup> Kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 13.4.2007.

<sup>58</sup> Kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.10.2007.



5,000 euro, detyrimi i mbetur 4,250 euro; dhe (iii) për vitin 2010 shuma e shlyer 4,250 euro, shlyer tërësisht detyrimi.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këto pasuri**

**43.** Referuar kontratës së sipërmarrjes së datës 13.4.2007, konstatohet se personi i lidhur (bashkëshorti i subjektit) ka prenotuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., pasurinë e llojit “apartament” me sipërfaqe 96.5 m<sup>2</sup>, të ndodhur në objektin e ndërtuar nga kjo shoqëri në lagjen nr. \*\*\*, Durrës.

**43.1.** Në nenin 3 të kësaj kontrate, me titull “Mënyra e pagesës” është përcaktuar plani i pagesave nga porositësi për llogari të sipërmarrësit për blerjen e kësaj pasurie me tri këste, si vijon: (i) në datën e nënshkrimit të kësaj kontrate porositësi do të paguajë këstin e parë në shumën 9,000 euro (datë 13.4.2007); (ii) këstin e dytë porositësi do ta paguajë në datën 30.12.2007, në shumën 30,000 euro; dhe (iii) para nënshkrimit të dokumenteve të kalimit të pronësisë së ambientit nga sipërmarrësi te porositësi, ky i fundit do të paguajë këstin e tretë dhe të fundit në shumën 9,250 euro.

**43.2.** Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë periudhën, vlerën dhe mënyrën e kryerjes së pagesave në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe të rendisë në mënyrë kronologjike të gjitha pagesat e kryera.

**43.3.** Lidhur me pagesat e kryera për prenotimin e kësaj pasurie, subjekti i rivlerësimit deklaroi se:

- **kësti i parë**, në shumën 9,000 euro, është paguar në datën 17.12.2007, cash në arkën e shoqërisë – sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 17.12.2007;

- **kësti i dytë**, në shumën 30,000 euro, është paguar në datën 30.6.2008, cash në arkën e shoqërisë – sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 30.6.2008;

- **kësti i tretë**, në shumën 5,000 euro, është paguar në datën 28.12.2009, cash në arkën e shoqërisë – sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 28.12.2009;

- **kësti i katërt**, në shumën 4,250 euro, është paguar në datën 20.12.2010, cash në arkën e shoqërisë – sipas mandatarkëtimit nr. \*\*\*, datë 20.12.2010.

**43.4.** Gjithashtu, krahas mandatpagesave subjekti ka depozituar si provë shkresën<sup>59</sup> e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., e cila konfirmon pagesat e kësteve sipas deklarimit të bërë.

**43.5.** Komisioni vëren se ka mospërputhje mes planit të pagesave të parashikuara në kontratën e sipërmarrjes me deklaratimet e bëra nga subjekti në DPV-të vjetore dhe deklaratimet e bëra gjatë procesit të hetimit administrativ të kryer, për shlyerjet e kësteve në favor të shoqërisë ndërtuese.

**43.6.** Ndërsa, në lidhje me kohën e marrjes në dorëzim të këtij apartamenti, subjekti i rivlerësimit, në përgjigje të pyetësorit nr. 2, ka deklaruar se<sup>60</sup> ...nuk mund të thotë saktësisht nëse është marrë apo jo në dorëzim ky apartament pasi nga firma “V\*\*\*\*” sh.p.k., ende nuk janë përfunduar punimet e kompleksit dhe nuk janë lidhur kontratat e banorëve në OSHEE apo në UK sh.a., Durrës.

**43.7.** Shoqëria “V\*\*\*\*” sh.p.k., me shkresën e datës 21.4.2020, informon se kontratat për furnizim me energji elektrike dhe ujë të pijshëm janë lidhur pjesërisht për shtetasin A.M., i cili ka lidhur vetëm kontratën me UK., sh.a., Durrës në datën 30.8.2018. Ndërsa, në lidhje me OSHEE-në është kompania e cila po bën veprimet për ndërlidhjen e kontratës, duke qenë se objekti nuk është marrë në dorëzim.

<sup>59</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 21.4.2020, depozituar si provë nga subjekti administruar me listën e inventarit për dokumentacionin justifikues ligjor në lidhje me përgjigjen e pyetjeve për apartamentin e blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2020.

<sup>60</sup> Përgjigjja e pyetjes nr. 7, c), të pyetësorit nr. 2.

**43.8.** Subjekti ka depozituar si provë kontratën nr. \*\*\*\*\*, datë 30.8.2018, lidhur mes shoqërisë UK., sh.a., Durrës, dhe bashkëshortit të saj.

**43.9.** UK-ja Durrës<sup>61</sup> sh.a. ka konfirmuar se në emër të z. A.M. figuron kontrata nr. \*\*\*\*\*, me adresë: Lagjja nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*”, \*\*\*, Durrës. Bashkëlidhur ka dërguar kontratën e lidhur nga z. A.M. dhe UK Durrës, si dhe kontratën e sipërmarrjes të lidhur nga z. M. me shoqërinë “\*\*\*” sh.p.k.

#### **Analiza e burimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për blerjen/krijimin e kësaj pasurie**

**44.** Rezulton se në deklaratën e rivlerësimit kalimtar subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar plotësisht burimin e krijimit të kësaj pasurie, por në analizë të deklaratave periodike vjetore të depozituara nga subjekti i rivlerësimit ndër vite në ILDKPKI duket se si burim krijimi të kësaj pasurie – krahas të ardhurave të përfituara nga shitja e apartamentit në vitin 2007 në Durrës – kanë shërbyer edhe të ardhurat e kursyera nga pagat e saj dhe të bashkëshortit ndër vite.

**44.1.** Lidhur me burimin e krijimit të të ardhurave, të cilat kanë shërbyer për kryerjen e pagesave në favor të shoqërisë ndërtuese, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se<sup>62</sup>:

- i. *për këstin e parë, në shumën 9,000 euro, si burim ka shërbyer pakësimi i gjendjes cash të deklaruar më parë, fakt ky i deklaruar në deklaratën e dorëzuar në datën 31.1.2008, gjithashtu është deklaruar detyrimi ndaj firmës “\*\*\*” sh.p.k., shuma prej 39,250 euro;*
- ii. *për këstin e dytë, në shumën 30,000 euro, si burim janë deklaruar të ardhurat e përfituara nga shitja në datën 6.10.2007, e apartamentit 1+1, me sipërfaqe 58 m<sup>2</sup>, ndodhur në Lagjen nr. \*\*\*, \*\*\*, Durrës, në shumën 3,500,000 lekë, shumë kjo e deklaruar si gjendje cash në banesë – e konvertuar në shumën 30,000 euro. Në deklaratën e dorëzuar në datën 2.2.2009 ka deklaruar se i ka shlyer firmës “\*\*\*” sh.p.k. shumën 30,000 euro, shumë e siguruar nga shitja e apartamentit 1+1, e deklaruar më parë si gjendje cash, si dhe ka deklaruar detyrimin e mbetur ndaj firmës ndërtuese në shumën 9,250 euro;*
- iii. *për këstin e tretë, në shumën 5,000 euro, si burim janë deklaruar të ardhurat nga pagat – prandaj në deklaratën e dorëzuar në datën 28.2.2010 është deklaruar shuma e shlyer ndaj shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., në vlerën 5,000 euro dhe detyrimi i mbetur ndaj shoqërisë në shumën 4,250 euro;*
- iv. *për pjesën e mbetur të këstit të tretë, në shumën 4,250 euro, si burim janë deklaruar të ardhurat nga pagat – duke u dokumentuar shlyerja me deklaratën e dorëzuar në datën 28.2.2011. Me pagimin e kësaj shume është shlyer plotësisht shoqëria ndërtuese, megjithëse nuk janë pajisur me certifikatë pronësie, pasi pasuria nuk është regjistruar në ZVRPP-në Durrës.*

#### **Analiza ligjore/financiare e burimit të krijimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për pagesën e këstit të parë për blerjen e kësaj pasurie**

**45.** Siç u pasqyrua më sipër, në DPV/2007 subjekti ka deklaruar si burim pagese të këstit të parë pakësimin e gjendjes cash të deklaruar më parë në shumën 700,000 lekë dhe kursimet për vitin 2007 në vlerën 500,000 lekë, ndërsa në përgjigje të pyetësorit të dërguar nga Komisioni ka deklaruar pakësimin e gjendjes cash të deklaruar më parë.

**45.1.** Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të depozituara nga subjekti ndër vite në ILDKPKI konstatohet se, subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur në vazhdimësi

<sup>61</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 23.4.2020.

<sup>62</sup> Përgjigjja e pyetjes nr. 7, b), të pyetësorit nr. 2.

kanë deklaruar shtesa/pakësime – kursime gjendje likuiditetesh *cash* deri në fund të vitit 2006, si vijon: (i) në DPV/2004 subjekti ka deklaruar gjendje *cash* në banesë shumë 300,000 lekë; (ii) në DPV/2005 subjekti dhe personi i lidhur, bashkëshorti (të dy subjekte deklarues) kanë deklaruar gjendje *cash* në shumë 700,000 lekë, me pjesë takuese nga 50% secili; dhe (iii) në DPV/2006 subjekti ka deklaruar shtesë gjendje *cash* në shumë 500,000 lekë.

**45.2.** Sa më sipër, nga analiza e vetëdeklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit në ILDKPKI, rezulton se në fund vitit 2006 subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur, bashkëshorti i saj, kanë pasur në formë kursimesh gjendjen e likuiditeteve *cash* në shumë 1,200,000 lekë.

**45.3.** Nga analiza financiare e kryer<sup>63</sup> nga Komisioni rezulton se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë pasur të ardhura të mjaftueshme nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht krijimin e këtyre kursimeve në formë likuiditetesh *cash*.

**45.4.** Lidhur me momentin e pagesës së kështit të parë, Komisioni vlerësoi se është kryer në datën 13.4.2007 – sipas përcaktimeve të bëra në kontratën e sipërmarrjes – megjithëse subjekti pretendon se pagesa e kështit të parë është kryer në datën 17.12.2007.

**45.5.** Sa më sipër, bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje në kuadër të hetimit administrativ si edhe në deklarimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu analizën e treguesve financiarë me qëllim verifikimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit dhe personave të lidhur me të – për kryerjen në datën 13.4.2007 të pagesës së kështit të parë për blerjen e apartamentit objekt vlerësimi, të pasqyruar në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 4.**

<b>Analiza financiare, periudha 1.1.2007 - 13.4.2007</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit për subjektin e rivlerësimit sipas “R*** Bank” për periudhën	234,554
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit të bashkëshortit sipas I*** Bank për periudhën	369,155
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>603,709</b>
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI, e mesatarizuar për periudhën	138,938
<b>Total shpenzime</b>	<b>138,938</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> , deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	700,000
Ndryshim mj. monetare banke, dokumentuar gj. fillim - gj. Fund periudhe	29,767
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>1,194,538</b>
Apartament me sip. 96,5 m <sup>2</sup> , porositur te shoqëria “***” sh.p.k., në datën 13.4.2007, me çmim 48,250 euro	5,875,885
Detyrime, shuma 39,250 euro	4,779,865
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>1,096,020</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>98,518</b>

**45.6.** Bazuar në analizën e mësipërme, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit, në datën 13.4.2007, ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kryer në favor të shoqërisë “\*\*\*” sh.p.k., në shumë 9,000 euro – si

<sup>63</sup> Analiza financiare – Aneks 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

likuidim i këstit të parë për prenotimin e apartamentit në objektin e ndërtuar nga kjo shoqëri në Lagjen nr. \*\*\*, Durrës.

### **Analiza ligjore/financiare e burimit të krijimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për pagesën e këstit të dytë për blerjen e kësaj pasurie**

**46.** Siç u vu në dukje më sipër, referuar deklaratimeve të subjektit – si burim krijimi për pagesën e këstit të dytë për blerjen e pasurisë objekt vlerësimi kanë shërbyer të ardhurat nga shitja e apartamentit me sipërfaqe 58 m<sup>2</sup>, në \*\*\*, Durrës.

**46.1.** Konstatohet se, referuar deklaratës fillestare të pasurisë subjekti i rivlerësimit ka deklaruar pasurinë e llojit “banesë 1+1”, me sipërfaqe 58 m<sup>2</sup>, me vlerë 1,000,000 lekë, të ndodhur në Lagjen nr. \*\*\*, \*\*\*, Durrës, 100% në emër të tij – me burim krijimi kursimet nga të ardhurat personale.

**46.2.** Në deklaratën “Vetting” subjekti ka deklaruar se kjo pasuri (apartamenti me sipërfaqe 58 m<sup>2</sup>, Durrës) është blerë në datën 12.12.2001, për vlerën 1,000,000 lekë. Por, referuar dokumentacionit të depozituar nga subjekti, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së<sup>64</sup>, konstatohet se bazuar në kontratën<sup>65</sup> e shitblerjes së datës 12.12.2001, subjekti i rivlerësimit e ka blerë këtë pasuri nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., për çmimin 100,000 lekë.

**46.3.** Lidhur me këtë mospërputhje të çmimit të deklaruar të blerjes së kësaj pasurie dhe atij të parashikuar në kontratë, subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se<sup>66</sup> *...e vërteta e kësaj kontrate është se e ka blerë në vlerën 1,000,000 lekë dhe këtë fakt e ka konstatuar (vlerën e kontratës 100,000 lekë) vetëm pasi Komisioni i ka kërkuar detajime... Në të kundërt nuk do ishte pasqyruar në deklaratën “Vetting”. Nëse do bëhej fjalë për fshehje do t'i leverdiste vlera e shënuar në kontratë, por në të vërtetë vlera 1,000,000 lekë është vlera reale e paguar në lidhje me këtë apartament... Shitësit e këtij apartamenti janë njerëzit e afërt (motra dhe bashkëshorti i saj) të cilët edhe mund t'ia kishin dhuruar këtë apartament.*

**46.4.** Në vijim, subjekti ka shpjeguar se *... apartamenti 1+1, me sipërfaqe 58 m<sup>2</sup>, sipas kontratës së sipërmarrjes të nënshkruar prej saj personalisht dhe administratorit të firmës “\*\*\*\*” (A.B., kunati i saj) në datën 25.3.2000 është në vlerën 1,000,000 lekë, me pagesë me këste gjatë kohës së ndërtimit të pallatit. Pas përfundimit të ndërtimit të pallatit dhe miratimit të dokumentit ligjor për shitjen e pasurive të pallatit 6-katësh, ka nënshkruar kontratën e shitblerjes për kalimin e pronësisë... Pra, kontrata e blerjes në vitin 2001 duhet të ishte sipas vlerës së arkëtimit në shumën 1 milion lekë të reja nga porositi Enkelejda Sofka, bazuar në kontratën e sipërmarrjes.*

**46.5.** Subjekti ka depozituar si provë të re kontratën e sipërmarrjes<sup>67</sup> të datës 25.3.2000, të lidhur mes saj dhe shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për prenotimin e pasurisë së llojit “apartament”, me sipërfaqe 58 m<sup>2</sup>, për çmimin 1,000,000 lekë. Ndërsa, plani i pagesave në këtë kontratë përcaktohet si vijon: (i) me lidhjen e kontratës, kësti i parë prej 40% të vlerës; (ii) me përfundimin e katit të tretë të karabinasë, kësti i dytë prej 30% të vlerës; dhe (iii) me përfundimin komplet të karabinasë, kësti i fundit prej 30% të vlerës.

**46.6.** Nisur nga fakti se kontrata e sipërmarrjes paraqitet në formën e shkresës së thjeshtë – paraqitur për herë të parë nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, por edhe në mungesë të evidencave të sakta lidhur me përfundimin e katit të tretë karabina,

<sup>64</sup> Aneks \*\*\* – pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

<sup>65</sup> Me kontratën e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 12.2.2001.

<sup>66</sup> Përgjigjja e pyetjes nr. 8, pyetësi nr. 2.

<sup>67</sup> Dërguar me përgjigjet e pyetësorit nr. 2, dërguar në Komisioni me e-mail-in e datës 10.5.2020, si dhe depozituar me dokumentin/listën e inventarit për dokumentacionin justifikues ligjor në lidhje me përgjigjen e pyetësorit nr. 2, pika 8, për apartamentin me sipërfaqe 58 m<sup>2</sup>, blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 19.5.2020.

përfundimin e plotë të objektit karabina parashikuar në kontratën e sipërmarrjes si momente të pagimit të kësteve nga subjekti i rivlerësimit, si dhe në referim të kontratës noteriale të shitblerjes të datës 12.12.2001 (provë e pakundërshtueshme), sipas së cilës çmimi për blerjen e kësaj pasurie është likuiduar plotësisht nga blerësi jashtë zyrës noteriale – çmimi i parashikuar në kontratë në shumën 100,000 lekë – vetëdeklaruar nga subjekti i rivlerësimit në shumën prej 1,000,000 lekësh, me pretendimin se ka qenë lapsus shënimi i vlerës 100,000 lekë – Komisioni vlerësoi të kryejë analizën financiare me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie, duke analizuar të ardhurat dhe shpenzimet deri në datën 12.12.2001.

**46.7.** Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe deklaratimet e subjektit të rivlerësimit, Komisioni kreu analizën financiare – me rezervë – me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për blerjen e kësaj pasurie në dhjetor të vitit 2001, të paraqitur në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 5.**

<b>Analiza financiare, të ardhura/shpenzime me rezervë për periudhën 4.1995 – 31.12.2001</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat neto nga paga dhe shpërblime, për periudhën, vërtetuar	1,611,535
<b>Total të ardhura/të hyra financiare (1)</b>	<b>1,611,535</b>
Shpenzime minimale për konsum, sipas INSTAT, ILDKPKI – për periudhën	486,864
Pagesë për blerjen e ap. me sip.58 m <sup>2</sup> , në ***, Durrës, deri në datën 12.12.2001	1,000,000
<b>Total shpenzime (2)</b>	<b>1,486,864</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>124,671</b>

**46.8.** Kjo analizë (të ardhura/shpenzime) është me rezervë, pasi nuk janë përfshirë të ardhura dhe shpenzime të periudhave të mëparshme. Subjekti i rivlerësimit ka depozituar dokumentacion për të provuar marrëdhëniet e punësimit që nga viti 1989, por në pamundësi të përcaktimit të saktë të vlerës së të ardhurave të përfituara dhe shpenzimeve për periudhën 1989 – 1994, këto nuk u pasqyruan në tabelë.

Bazuar në analizën e mësipërme, Komisioni arrin në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e çmimit prej 1,000,000 lekësh (të deklaruar) për blerjen e pasurisë së llojit “apartment banimi”, me sipërfaqe 58 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen nr. \*\*\*, \*\*\*, Durrës.

**46.9.** Nga verifikimi i dokumentacionit të depozituar nga subjekti<sup>68</sup> lidhur me këtë pasuri dhe dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Durrës<sup>69</sup>, konfirmohet se në datën 6.10.2007 subjekti i rivlerësimit i ka shitur<sup>70</sup> shtetas N.D. pasurinë e llojit “apartment banimi”, me sipërfaqe 58 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Lagjen nr. \*\*\*, \*\*\*, Durrës, për çmimin 3,500,000 lekë. Ndërsa, në DPV/2007 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar shitjen e kësaj pasurie për çmimin 30,000 euro.

Lidhur me mospërputhjen e konstatuar në deklaratimin e çmimit të shitjes të bërë në DPV/2007 (vlera 30,000 euro) me çmimin e shitjes së parashikuar në kontratë (vlera 3,500,000 lekë) subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se<sup>71</sup> *...vlera e shitjes është në shumën 3,500,000 lekë, thuajse e afërt me vlerën 30,000 euro të deklaruar – referuar kursit të këmbimit të periudhës në të cilën është kryer shitja.*

<sup>68</sup> Aneks \*\*\* – pjesë e dosjes së ILDKPKI-së.

<sup>69</sup> Shkresa kthim përgjigje për ILDKPKI-në, me nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2018 – aneks nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>70</sup> Kontrata e shitjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.10.2007.

<sup>71</sup> Përgjigjet e pyetësorit nr. 2.

**46.10.** Gjithashtu, konstatohet se në DPV/2007 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar gjendjen *cash* në banesë në shumën prej 30,000 euro – me burim krijimi shitjen e apartamentit në \*\*\*, Durrës. Në referim të deklarimeve të bëra nga subjekti në përgjigje të pyetësorit nr. 2, shuma e përfituar nga shitja e apartamentit në \*\*\*, Durrës në vitin 2007 prej 3,500,000 lekësh është konvertuar në monedhën euro, në shumën rreth 30,000 euro.

**46.11.** Referuar kursit mesatar të këmbimit valutor<sup>72</sup> për periudhën tetor – dhjetor 2007, shuma prej 3,500,000 lekësh konvertohet në shumën rreth 28,700 euro. Në konsideratë të faktit se subjekti ka deklaruar shumën 30,000 euro *cash* në banesë, si dhe në referim të analizës financiare të vitit 2007<sup>73</sup>, e cila paraqitet me balancë pozitive fondesh dhe mundëson krijimin e vlerës shtesë për plotësimin e shumës prej 30,000 euro – duket se subjekti në fund të vitit 2007 ka disponuar shumën *cash* shumën 30,000 euro, me burim kryesor të ardhurat nga shitja e apartamentit në tetor të vitit 2007.

**46.12.** Siç u evidentua më sipër, në kontratën e sipërmarrjes për prenotimin e pasurisë objekt vlerësimi (nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.) përcaktohej se këstin e dytë porositësi do ta paguante në datën 30.12.2007, në shumën 30,000 euro. Por, në DPV/2007 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se shuma e shlyer ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., gjatë këtij viti është në vlerën 9,000 euro dhe detyrimi i mbetur në vlerën 39,250 euro.

**46.13.** Gjatë hetimit administrativ, subjekti deklaroi se pagesa e këstit të dytë për prenotimin e kësaj pasurie është kryer në datën 30.6.2008, duke depozituar si dokumentacion provues mbështetës: (i) shkresën konfirmuese nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.; dhe (ii) mandatpagesën që mban datën 30.6.2008.

**46.14.** Në analizë të të dhënave të mësipërme – faktit se: (i) subjekti e ka disponuar shumën prej 3,500,000 lekësh para datës së përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes për pagesën e këstit të dytë; (ii) në DPV/2007<sup>74</sup> ka deklaruar se këtë shumë e ka disponuar *cash* në fund të vitit, si dhe ka deklaruar detyrimin e mbetur ndaj shoqërisë në shumën 39,250 euro; (iii) kjo shumë e disponuar *cash* nuk ka pasur destinacion tjetër/nuk është investuar, por ka shërbyer si burim për pagesën e këstit të dytë – si dhe në vlerësim të provave të depozituara dhe deklarimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit gjatë procesit të hetimit administrativ, duket se pagesa e këstit të dytë është kryer në datën 30.6.2008, dhe si e tillë do të pasqyrohet në analizën financiare të kryer nga Komisioni.

**46.15.** Analiza e kryer nga Komisioni, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për kryerjen e pagesës së këstit të dytë për prenotimin e pasurisë në \*\*\*, Durrës – nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k, paraqitet në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 6.**

<b>Analiza financiare, periudha 1.1.2008 - 30.6.2008</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit për subjektin e rivlerësimit, mesatarizim për periudhën ref. vërtetimit nga institucioni	409,357
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit bashkëshorti sipas I*** Bank - për periudhën	489,145
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>898,502</b>
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI - për periudhën	273,240

<sup>72</sup> Kursi këmbimit i marrë nga faqja zyrtare e Bankës së Shqipërisë.

<sup>73</sup> Analiza financiare – aneksi nr. 1, bashkëlidhur këtij vendimi.

<sup>74</sup> Referuar pikës 5 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016, deklarimet e interesave private dhe pasurore, të paraqitura më parë tek ILDKPKI-ja mund të përdoren si provë nga Komisioni dhe Kolegji i Posaçëm i Apelit.

Shpenzime për automjetin “Volkswagen Passat” - të deklaruara në pyetësoin nr. 2	300,000
Shpenzime udhëtimi – të deklaruara në pyetësoin nr. 1	61,900
<b>Total shpenzime</b>	<b>635,140</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> deklaruar, gj. fillim - gj. fund periudhe në lekë	500,000
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> , deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe në euro	3,653,400
Ndryshim mj. monetare bankë, dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe në lekë	124,040
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>4,540,802</b>
Pagesë e kështit të dytë në vlerën 30,000 euro te shoqëria “****” sh.p.k.	3,653,400
Pagesë blerje automjet “Volkswagen Passat”, datë 6.2.2008	500,000
Detyrime	0
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>4,153,400</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>387,402</b>

**46.16.** Sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kështit të dytë, në shumën 30,000 euro, për prenotimin e apartamentit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

**Analiza ligjore/financiare e burimit të krijimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për pagesën e kështit të tretë dhe të katërt për blerjen e kësaj pasurie**

**47.** Në referim të kontratës së sipërmarrjes, kësti i fundit (kësti i tretë) në shumën 9,250 euro do të paguhej nga porositësi (subjekti i rivlerësimit) para nënshkrimit të dokumenteve të kalimit të pronësisë.

**47.1.** Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të depozituara nga subjekti ndër vite në ILDKPKI, konstatohet se: (i) në DPV/2009 subjekti ka deklaruar shumën e shlyer ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. prej 5,000 euro – detyrimi i mbetur 4,250 euro; dhe (ii) në DPV/2010 shumën e shlyer ndaj shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. prej 4,250 euro me burim kursimet nga pagat – shlyer plotësisht detyrimi.

**47.2.** Gjatë procesit të hetimit administrativ, subjekti deklaroi se shuma 5,000 euro është paguar në datë 28.12.2009 dhe shuma prej 4,250 euro është paguar në datë 20.12.2010 – me burim krijimi të ardhurat e kursyera nga pagat, duke depozituar si dokumentacion provues mbështetës: (i) shkresën konfirmuese nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.; si dhe (ii) 2 mandatpagesa të datës 28.12.2009 dhe të datës 20.12.2010.

**47.3.** Gjithashtu, nga hetimi i kryer rezultoi se gjatë vitit 2009 me kontratën<sup>75</sup> e datës 30.4.2009, subjekti i rivlerësimit dhe motra e saj, kanë blerë në shumën prej 2,550,742 lekë, pjesën takuese të prindërve dhe vëllait (3/5 pjesë të saj) mbi pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 86.04 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, Durrës, pasuri e blerë më parë (në datën 29.12.21993) prej familjes Sofka (pjesë e së cilës ka qenë edhe subjekti i rivlerësimit) nga Ndërmarrja Komonale Banesa për shumën prej 18,155 lekësh, në bazë të ligjit të privatizimit.

**47.4.** Komisioni konstaton se kjo pasuri, pjesa takuese dhe të drejtat reale mbi të nuk janë deklaruar nga subjekti i rivlerësimit në deklaratën fillestare të pasurisë dhe në deklaratat vijuese të dorëzuara nga subjekti në ILDKPKI.

**47.5.** Por, vërehet se në DPV/2009 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se apartamenti me sipërfaqe 86.04 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Lagjen nr. \*\*\*\*, Durrës, i është dhuruar nga prindërit dhe vëllai, dy motrave, në raport me 50% secila (subjektit E. Metaliaj dhe motrës D.B.) – dhe se ky dhurim është bërë në formë kontrate.

<sup>75</sup> Kontrata e shitblerjes me nr. \*\*\*\* rep., nr. \*\*\*\* kol., datë 30.4.2009.

**47.6.** Në vijim, lidhur me këtë marrëdhënie, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se<sup>76</sup> *...vërtetë kontrata e lartpërmendur ka fjalën shitje, por në të vërtetë midis tyre – familjarët e saj, nuk kanë shitur dhe blerë asgjë me vlerë monetare me njëri-tjetrin. Të gjitha këto veprime juridike janë bërë për t’u evidentuar shlyerja e kredisë së vëllait E.S. nga ana e motrës D.B. (për këtë fakt referohu vlerës së kontratës që përkon me shlyerjen e huas), për shkak të marrëdhënieve kontraktore që ajo ka pasur së bashku me të.*

**47.7.** Gjithsesi, bazuar në kontratën e shitblerjes së kësaj pasurie të datës 30.4.2009, Komisioni kreu analizën financiare, me qëllim evidentimin e mundësisë financiare të subjektit të rivlerësimit për kryerjen e pagesave për likuidimin e ½ të çmimit për blerjen e pjesës takuese që zotëronin familjarët e saj mbi këtë pasuri, nga ku duket se subjekti i rivlerësimit nuk ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht vlerën e paguar për blerjen e kësaj pasurie.

**47.8.** Gjithashtu, konstatohet se referuar vërtetimit nr. \*\*\* prot., datë 24.4.2009, nga N\*\*\* Bank – pjesë e dosjes së ILDKPKI<sup>77</sup> - z. E.S. (vëllai i subjektit) dhe Enkelejda Sofka (subjekti i rivlerësimit) janë financuar nga N\*\*\* Bank në datën 17.2.2005, me kredi në shumën 26,000 euro, e cila është mbyllur plotësisht më 21.4.2009.

**47.9.** Komisioni konstatoi se subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar kredinë e marrë në vitin 2005 (si bashkëkredimarrëse), qëllimin – destinacionin e saj, si edhe shlyerjet e saj ndër vite dhe burimin e të ardhurave të cilat kanë shërbyer për shlyerjen e kësaj kredie.

**47.10.** E pyetur nga Komisioni lidhur me këtë fakt, subjekti i rivlerësimit deklaroi se<sup>78</sup> *[...] Kredia në N\*\*\* Bank është finalizuar më anë të kontratës së kredisë nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.2.2005, duke u vendosur si kolateral apartamenti i banimit me sipërfaqe 86.4 m<sup>2</sup>, i ndodhur në zonën kadastrale nr. \*\*\*, me adresë: Lagjja nr. \*\*\*, rruga “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, shk. \*\*\*, ap. \*\*\*, Durrës, i cili në atë kohë ka qenë në bashkëpronësi të shtetasve A., L., E., D., dhe Enkelejda Sofka. Kredia është marrë vëllai i ndjerë, z. E.S., në vlerën 26,000 euro, pasi në datën 31.12.2004 kishte porositur pranë shoqërisë së ndërtimit “\*\*\*\*”, Durrës, një apartament banimi me sipërfaqe 160 m<sup>2</sup> [...].*

**47.11.** Në mbështetje të deklarimeve të saj, subjekti ka depozituar si dokumentacion provues pranë Komisionit: (i) kontratën e sipërmarrjes<sup>79</sup> të datës 31.12.2004; si dhe (ii) deklaratën noteriale të datës 22.4.2009<sup>80</sup>.

**47.12.** Rezulton se nëpërmjet deklaratës noteriale të sipërcituar përfaqësuesit e Bankës Kombëtare të Greqisë – dega Durrës (N\*\*\*\*) kanë kërkuar çregjistrimin e bllokimit të bërë mbi pasurinë e llojit apartament me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup> – në pronësi të familjes Sofka, pasuri e vendosur si kolateral për marrjen e kredisë pranë kësaj banke.

**47.13.** A\*\*\* Bank<sup>81</sup> (shoqëria përthithëse e N\*\*\* Bank) konfirmon se subjekti i rivlerësimit paraqitet në cilësinë e bashkëkredimarrësit me vëllain e saj, z. E.S., dhe se në referim të kontratës së kredisë<sup>82</sup> të datës 15.2.2005, kanë marrë kredinë në shumën 26,000 euro.

**47.14.** Gjithashtu, referuar dokumentacionit, pjesë e dosjes së ILDKPKI-së (aneks nr. 38) konstatohet se në datën 8.2.2008, në llogarinë në euro në “A\*\*\* Bank”, subjektit të rivlerësimit i është transferuar shuma 25,000 euro – me përshkrimin “znj. D.B. – kaluar

<sup>76</sup> Përgjigjet e pyetjes nr. 9, të pyetësorit nr. 2, të dërguar nga Komisioni.

<sup>77</sup> Aneks nr. \*\* në dosjen e ILDKPKI-së.

<sup>78</sup> Përgjigje e pyetjes nr. 6, të pyetësorit nr. 2.

<sup>79</sup> Kontrata e sipërmarrjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.12.2004.

<sup>80</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 22.4.2009.

<sup>81</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 6.10.2020.

<sup>82</sup> Kontratë kredie nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 15.2.2005.



tek znj. E.S.” dhe se në datën 12.2.2008 subjekti e debitoi këtë shumë (nëpërmjet transfertës bankare), me përshkrimin “kalim nga E.S. te D.B.”.

**47.15.** E pyetur nga Komisioni lidhur me këtë transaksion – qëllimin e kësaj transferte, burimin e krijimit të shumës prej 25,000 euro dhe destinacionin final të saj – subjekti i rivlerësimit, ndër të tjera, ka deklaruar se<sup>83</sup> *duke qenë së ajo ka qenë në cilësinë e dorëzanësit në kredinë e marrë nga i vëllai – ky veprim 3-ditor nga ana e motrës së saj D.B. tek ajo është bërë me qëllimin e vetëm të evidentimit të shlyerjes së kësaj shume për llogari të N\*\*\* Bank. Destinacioni i vetëm i kësaj shumë ka qenë shlyerja e kredisë së vëllait të ndjerë, E.S.*

**47.16.** Por, siç u evidentua më sipër, rezulton se subjekti i rivlerësimit shfaqet në cilësinë e bashkëkredimarrësit me vëllain e saj për kredinë e marrë në N\*\*\* Bank në vitin 2005, në shumën 26,000 euro.

**47.17.** Për sa më sipër, Komisioni i kaloi barrën e provës subjektivit të rivlerësimit për të dhënë argumentet/shpjegimet përfundimtare, si dhe të depozitojë prova të reja të mundshme për çështjet si vijon:

1. lidhur me pamundësinë financiare për të kryer në datën 30.4.2009 pagesën e ½ të çmimit për blerjen e pjesës takuese që zotëronin familjarët e saj mbi pasurinë e llojit “apartament”, me sipërfaqe 86.04 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Durrës;
2. lidhur me mosdeklarimin e kredisë së marrë në N\*\*\* Bank në vitin 2005 (e përthithur nga “A\*\*\* Bank”), destinacionin e saj dhe burimet që kanë shërbyer për shlyerjen e saj;
3. lidhur me transaksionet e kryera në “A\*\*\* Bank” gjatë vitit 2008, të evidentuara si më sipër.

#### **Qëndrimi i subjektivit të rivlerësimit pas dërgimit të rezultateve të hetimit**

**48.** Me dërgimin e prapësimeve – por edhe në shpjegimet e dhëna gjatë seancës dëgjimore të datës 22.4.2021 – subjekti ka parashtruar se nuk ka kryer pagesë për blerjen e apartamentit në vitin 2009, duke referuar edhe DPV/2009, ku ka deklaruar për herë të parë këtë pasuri si vijon: *“Dhuruar nga prindërit dhe vëllai dy motrave në raport 50% secila, Enkelejda Metaliaj dhe D.B. (dhurimi është bërë në formë kontrate)”*.

**48.1.** Në vijim, subjekti ka shpjeguar se edhe pse kontrata citonte veprim shitjeje, por në të vërtetë ajo dhe familjarët e saj nuk kanë shitur dhe blerë asgjë me vlerë monetare me njëri-tjetrin në familjen e tyre, pasi të gjitha këto veprime juridike janë bërë për t’u evidentuar shlyerja e kredisë së vëllait E. S., nga ana e së motrës D.B.

**48.2.** Subjekti ka pretenduar se kjo shumë nuk është paguar prej saj ndaj palëve shitëse A., L. dhe E.S., sipas kontratës së shitjes me nr. \*\*\* rep. nr. \*\*\* kol., me datë 30.4.2009, në çmimin 2,550,742 lekë, por është paguar nga e motra D.B. në datën 21.4.2009, në llogarinë e të vëllait E.S. pranë N\*\* Bank për të likuiduar vlerën e kredisë së mbetur prej 24,149 euro, që vëllai i saj kishte marrë pranë kësaj banke për blerjen e një pasurie tjetër pranë shoqërisë “\*\*\*”, dhe si garanci/kolateral kishte vendosur pikërisht këtë pasuri, e cila ishte në pronësi 3/5 nga shtetasit A., L. dhe E.S.

**48.3.** Gjithashtu, subjekti ka argumentuar se historiku i familjes nuk mund të shkruhej në deklaratat periodike, por shënohej vetëm veprimi, duke pasqyruar në shpjegimet e saj edhe rrethana të veçanta për situatën në të cilën ndodhej i vëllai në atë kohë, të tilla që mund të rrezikonin raportin me prindërit, nëse ai jetonte në një banesë me ta, dhe për më tepër, në kushtet kur ai kishte vënë në rrezik apartamentin ku jetonin prindërit e saj, për

<sup>83</sup> Pyetja nr. 3 e pyetësorit nr. 4 – përgjigjja e dërguar nga subjekti.

shkak të mosshlyerjes së kësteve të kredisë, pasuri në bashkëpronësi të anëtarëve familjes Sofka.

**48.4.** Në kushtet kur vëllai kishte bërë porosinë për apartamentin me sipërfaqe 160 m<sup>2</sup>, për të cilin u mor edhe kredia, subjekti deklaroi se ishte dëshira e babait të saj që apartamenti të kalojë në emër të dy vajzave – për të gjithë kontributin e dhënë për perkujdesjen e dy prindërve, gjithsesi, duke qenë koshient se 50% të shtëpisë “*de facto*” e kishin dhe dy prindërit.

**48.5.** Në përfundim të shpjegimeve të saj, subjekti ka konkluduar se veprimi juridik i mësipërm është bërë vetëm për t’u evidentuar fakti i shlyerjes së kredisë së vëllait, kjo edhe për faktin se ky i fundit kishte marrëdhënie kontraktore me motrën D.B., si administratore dhe ortakë e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., me seli në adresën e prindërve: Lagjja nr. \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”, p. \*\*\*, Durrës.

**48.6.** Lidhur me kredinë e marrë në vitin 2005 në N\*\*\* Bank, subjekti ka deklaruar se nuk ka qenë bashkëkredimarrëse me vëllain e saj, duke pretenduar se ka qenë dorëzanëse si të gjithë familjarët e tjerë – në kushtet kur si kolateral është vendosur banesa në pronësi të tyre, dhe se gabimisht është shënuar si bashkëkredimarrëse.

**48.7.** Në vijim, subjekti ka sqaruar se e gjitha vlera e kredisë është disbursuar në llogarinë e vëllait të saj dhe se në vijim është transferuar për llogari të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., si pagesë kësti për apartamentin e porositur nga i vëllai (i cili ka ndërruar jetë), apartament i cili aktualisht është i regjistruar në emër të ish-bashkëshortes dhe fëmijëve të tij.

**48.8.** Ndërsa, për transaksionet e evidentuara me motrën e saj, subjekti ka argumentuar se edhe këto lidhen me kredinë e marrë nga vëllai i saj – dhe janë bërë me qëllim evidentimin e shlyerjes së kredisë nga ana e tij. Në historik, ajo referon se pas marrjes së kredisë vëllai i saj nuk ishte korrekt në likuidimin e kësteve dhe se në kushtet kur rrezikohet kolaterali (shtëpia e familjes), motra e saj u ofrua për shlyerjen e kësaj kredie, duke qenë se kishte mundësi financiare.

**48.9.** Në mbështetje të shpjegimeve të bëra nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, subjekti ka depozituar prova të reja që kanë të bëjnë me informacion bankar dhe mbi marrëdhënien kontraktuale të vëllait të saj dhe në vijim të ish-bashkëshortes dhe fëmijëve me shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.

#### **Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave**

**49.** Në analizë të shpjegimeve dhe provave të depozituara nga subjekti i rivlerësimit duket se kredia e marrë në vitin 2005, transaksionet me të motrën dhe shlyerja e kredisë së vëllait prej kësaj të fundit në vitin 2009, si dhe nënshkrimi i kontratës së shitjes në vitin 2009 (sipas të cilës prindërit dhe vëllai i shesin pjesën takuese të pasurisë subjektit dhe motrës së saj) kanë lidhje me njëra-tjetrën dhe nuk mund të trajtohen të shkëputura – për sa kohë barra e provës i është kaluar subjektit për mosdeklarimin e kredisë, transaksionet e kryera dhe pagesën e ½ të çmimit të shitjes së pasurisë.

**49.1.** Komisioni vëren se, lidhur me kredinë e vitit 2005 në N\*\*\* Bank subjekti ka deklaruar se në dijeninë e saj ka qenë dorëzanëse në këtë marrëdhënie kredie, për sa kohë si kolateral për marrjen e saj ka shërbyer apartamenti i familjes së origjinës, me pretendimin se mund të jetë bërë lapsus në përcaktimin e saj në kontratë si bashkëkredimarrëse, duke parashtruar argumentet si vijon:

- i. kjo kredi është marrë për blerje apartamenti nga vëllai i saj te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., qëllim i përcaktuar edhe në kontratën e kredisë;
- ii. si rregull bashkëkredimarrëse duhet të shënohet bashkëshortja e vëllait të saj;

- iii. kjo kredi është disbursuar (vlera 25,485 euro) në llogarinë e vëllait të saj dhe se në datën 18.2.2005 është transferuar në favor të shoqërisë “\*\*\*\* ” sh.p.k., me përshkrimin “E.S. transferim në llogari të shitësit “\*\*\* ’ sh.p.k.”.

**49.2.** Lidhur me transaksionet bankare me të motrën, znj. D.B., subjekti ka deklaruar se ato janë kryer me qëllim evidentimin e shlyerjes së kredisë së vëllait të tyre.

Ndërsa, sa i përket kontratës së shitjes së apartamentit në vitin 2009, subjekti ka deklaruar se nuk ka kryer pagesë për blerjen e kësaj pasurie, duke argumentuar se:

- i. ky veprim juridik është bërë me qëllim për t’u evidentuar shlyerja e kredisë së vëllait E. S. nga ana e motrës D.B.;
- ii. në DPV/2009 ka deklaruar si dhurim pjesën takuese të përfitur nga vëllai dhe prindërit e saj, të formalizuar me kontratë;
- iii. si shkak për kryerjen e këtij veprimi – ka parashtruar disa rrethana familjare (përfshirë dhe faktin se kolaterali po rrezikohej për shkak të mospagimit në kohë të kësteve të kredisë) dhe faktin se motra e saj D.B. shleu gjithë shumën e kredisë së mbetur prej të vëllait.

**49.3.** Në mbështetje të shpjegimeve të dhëna gjatë hetimit administrativ, si dhe me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, subjekti ka depozituar, ndër të tjera, dokumentacion provues, si vijon: (i) kontratë noteriale sipërmarrjeje e lidhur në datën 31.12.2004, mes shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe z. E.S.; (ii) kontratë kredie bankare; (iii) lëvizje të llogarisë së kredisë – llogaria e të vëllait ku është disbursuar kredia; (iv) lëvizje të llogarisë bankare lidhur me transfertën e kryer në datën 21.4.2009, nga shtetasja D.B. në llogarinë e z. E.S., për mbylljen e kredisë; (v) deklaratë noteriale e datës 22.4.2009, e lëshuar nga përfaqësuesit e bankës (N\*\*\*), për zhblokimin e kolateralit; (vi) vërtetim për shlyerjen e kredisë në datën 24.4.2009; (vii) dokumentacion mbi kalimin e pronësisë në emër të ish-bashkëshortes dhe fëmijëve të pasurisë së prenotuar nga z. E.S. te shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k. (përfshirë librezat uji/energji elektrike të vitit 2005 që lidhen me këtë pasuri); (viii) deklaratë noteriale e shtetasës D.H., ish-bashkëshortja e z. E.S.; (ix) deklaratë noteriale e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k.; (x) deklaratë noteriale e znj. D.B.; si dhe (xi) dokumentacion në lidhje regjistrimin dhe aktivitetin tregtar të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. (shoqëri në pronësi të motrës së subjektit dhe bashkëshortit të saj).

**49.4.** Bazuar në dokumentacion provues të depozituar nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionin e administruar nga Komisioni në kuadër të hetimit administrativ, u analizua kronologjia e veprimeve të kryera që lidhen me marrjen e kredisë në vitin 2005 në NBG Bank, të cilat duket se përfundojnë me nënshkrimin e kontratës së shitblerjes për apartamentin në pronësi të familjes Sofka në vitin 2009, të renditura në mënyrë të përmbledhur si më poshtë:

- i. në datën 31.12.2004 është nënshkruar kontrata e sipërmarrjes për prenotim apartamenti mes shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., dhe z. E.S. (vëllai i subjektit).
- ii. në datën 15.2.2005 është nënshkruar kontrata e kredisë me N\*\*\* Bank, për shumën 26,000 euro;
- iii. në datën 17.2.2005 është disbursuar kredia në shumën 26,000 euro në llogarinë e z. E.S.;
- iv. në datën 18.2.2005 nga llogaria e kredisë është transferuar në favor të shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., shuma 25,485 euro;
- v. deri në fillim të vitit 2009 janë kryer disa pagesa këstesh për kredinë në fjalë, por vërehet se ka pasur vonesa në shlyerjen e tyre;
- vi. në datën 21.4.2009 nga llogaria e znj. D.B. është transferuar në llogarinë e z. E.S. shuma 24,149 euro, e cila është përdorur plotësisht për mbylljen e kredisë së marrë në N\*\*\* Bank;

- vii. në datën 22.4.2009 është lëshuar deklarata noteriale nga banka për zhbllokimin e kolateralit të lënë garanci për këtë kredi (apartamentin e familjes Sofka);
- viii. në datën 30.4.2009 është nënshkruar kontrata e shitjes, sipas së cilës vëllai dhe prindërit e subjektit ia shesin pjesën takuese subjektit dhe motrës së saj, për çmimin 2,550,742 lekë.

**49.5.** Si konkluzion, në analizë të shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit dhe vlerësimit të tyre në harmoni me ngjarjet ekonomike/transaksionet e evidentuara nëpërmjet dokumentacionit provues të referuar si më sipër, trupi gjykues krijoi bindjen se:

- i. përfituesi *de facto* i kredisë së marrë në vitin 2005 në N\*\*\* Bank ka qenë vëllai i subjektit të rivlerësimit – me qëllim financimin për blerje apartamenti në emrin e tij, regjistruar aktualisht në emër të ish-bashkëshortes dhe fëmijëve të tij;
- ii. subjekti nuk ka kryer pagesë në funksion të kontratës së shitblerjes së apartamentit të datës 30.4.2009, kjo edhe në këndvështrim të faktit se në DPV/2009 subjekti ka deklaruar si dhurim nga familjarët e saj 50 % të pjesës takuese të kësaj pasurie. Në këtë kuptim, ky deklarim i bërë në referim të pikës 5 të nenit 32 të ligjit 84/2016 merr cilësi provuese i vlerësuar në harmoni me shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ, me dërgimin e prapësimeve, si dhe gjatë seancës dëgjimore të datës 22.4.2021;
- iii. nuk ka dyshime për shumën e transferuar në llogarinë e subjektit në “A\*\*\* Bank” nga motra e saj në vitin 2008, shumë e cila evidentohet se është kthyer nga subjekti brenda 4 ditëve. Duken bindëse shpjegimet e subjektit lidhur me arsyet e këtij transaksioni, në vlerësim edhe të provave të depozituara – nga ku vërehet se shlyerja e kredisë së referuar më sipër është kryer me fonde të transferuara nga znj. D. B. në llogarinë e kredisë së z. E. S..

**49.6.** Si një tjetër *indicie* e rëndësishme e cila mbështet deklaratimet e subjektit për kryerjen e këtyre transaksioneve në kushtet e marrëdhënieve të posaçme familjare, Komisioni vlerëson faktin se në deklaratën “Vetting” subjekti ka pretenduar të ardhura si pjesë takuese nga shitja e kësaj pasurie dhe e shtesës pjesë përbërëse të saj, vlerën 20,000 euro, e cila në fakt nuk i përgjigjen pjesës takuese të saj mbi këto pasuri bazuar në dokumentacion ligjor<sup>84</sup>.

**49.7.** Gjithashtu, konstatohet se në DPV/2009, në rubrikën e të ardhurave, subjekti ka deklaruar se shtetasi T.M., me banim në Irlandë, i ka dhuruar vajzave të saj shumën 1,500 euro (konvertuar në 207,000 lekë). Lidhur me këtë dhurim, Komisioni vëren se subjekti nuk ka paraqitur dokumentacion justifikues ligjor, sipas të cilit shtetasi T.M. të konfirmojë këtë marrëdhënie, dhe as mbi ligjshmërinë e burimit të krijimit të të ardhurave të personit tjetër të lidhur<sup>85</sup>, në kundërshtim me parashikimet e bëra në pikën 4 të nenit 32 të ligjit nr. 84/2016. Si rrjedhim, shuma 1,500 euro nuk është reflektuar si e ardhur në analizën financiare të vitit 2009.

**49.8.** Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe në deklaratimet e bëra nga subjekti i rivlerësimit, Komisioni kreu analizën financiare me qëllim evidentimin e mundësisë financiare për kryerjen e pagesës për likuidimin e çmimit të kështit të tretë për prenotimin e pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit të banimit të blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në \*\*\*, Durrës, të paraqitur në tabelën si më poshtë:

<sup>84</sup> Transaksionet lidhur me këto dy pasuri do të trajtohen më gjerësisht në vijim të këtij vendimi, në analizimin e pasurisë së llojit bono thesari.

<sup>85</sup> Ka depozituar si provë me prapësime të dërguara, kopje të komunikimeve elektronike me *e-mail*, të pretenduar me shtetasin T.M., ku pasqyrohen disa dokumente në gjuhë të huaj me të dhëna financiare të këtij shtetasi.

**Tabela nr. 7.**

<b>Analiza financiare periudha 1.1.2009 – 31.12.2009</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit për subjektin e rivlerësimit	899,021
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit, bashkëshorti	1005571
<b>Total të ardhura/të hyra financiare</b>	<b>1,904,592</b>
Shpenzime shkollimi, vajzat	75,520
Shpenzime udhëtimi, deklaruar/llogaritur	151,756
Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën	546,480
<b>Total shpenzime</b>	<b>773,756</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> , deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	-300,000
Ndryshim mj. monetare banke, dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	36,640
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>867,476</b>
Pagesë e kështit të tretë në vlerën 5,000 euro, te shoqëria “****” sh.p.k.	689,800
Detyrime	0
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>689,800</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>177,676</b>

**49.9.** Sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kështit të tretë – në shumën 5,000 euro, për prenotimin e apartamentit nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.

Siç u evidentua më sipër, referuar deklaramit të bërë në DPV/2010, si dhe në përputhje me shpjegimet e dhëna nga subjekti gjatë hetimit administrativ – të mbështetura nga shkresa e shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k. dhe mandatpagesat përkatëse, kështi i katërt në shumën 4,250 euro, nëpërmjet të cilit është likuiduar çmimi i plotë i përcaktuar në kontratën e sipërmarrjes, është shlyer në datën 20.12.2010 – me burim krijimi të ardhurat e kursyera nga pagat.

**49.10.** Bazuar në dokumentacionin e administruar në dosje, si dhe deklaramit e bëra nga subjekti të rivlerësimit, Komisioni kreu analizën financiare me qëllim evidentimin e mundësisë financiare për kryerjen e pagesave për likuidimin e çmimit të kështit të katërt për prenotimin e pasurisë objekt vlerësimi, apartamentit të banimit të blerë nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., në \*\*\*, Durrës, të paraqitur në tabelën si më poshtë:

**Tabela nr. 8.**

<b>Analiza financiare, periudha 1.1.2010 – 31.12.2010</b>	
<b>Përshkrimi</b>	<b>Vlera në lekë</b>
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit për subjektin e rivlerësimit	990,258
Të ardhurat neto nga marrëdhëniet e punësimit, bashkëshorti	1,063,573
Hua nga vëllai i bashkëshortit, shuma 35,000 euro	4,856,950
<b>Total të ardhura /të hyra financiare</b>	<b>6,910,781</b>
Shpenzime shkollimi, vajzat	176,800
Shpenzime udhëtimi, deklaruar/llogaritur	387,030
Shpenzime blerje parcele ndërtimore	30,000
Shpenzime për punime/arredime (ndarë në vitet 2010 - 2011)	348,483

Shpenzime minimale për konsum sipas INSTAT, ILDKPKI për periudhën	546,480
<b>Total shpenzime</b>	<b>1,488,793</b>
Ndryshim mj. monetare <i>cash</i> , deklaruar gj. fillim - gj. fund periudhe	-200,000
Ndryshim mj. monetare banke, dokumentuar gj. fillim - gj. fund periudhe	39,317
<b>Mjete monetare të disponueshme (1)</b>	<b>5,261,305</b>
Pagesë e pjesës e kështit të katërt në vlerën 4,250 euro në datë 20.12.2010, te “****” sh.p.k.	589,773
Blerje ap. banimi 76 m <sup>2</sup> te shoqëria “****” sh.p.k., datë 23.2.2010 në shumën 40,000 USD	4,072,400
Detyrime	0
<b>Pasuri neto (2)</b>	<b>4,662,173</b>
<b>Balanca e fondeve (1-2)</b>	<b>599,132</b>

**49.11.** Sa më sipër, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit ka pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht pagesën e kështit katërt – në shumën 4,250 euro, për likuidimin e çmimit të shitjes të pasurisë së llojit “apartament”, të ndodhur në \*\*\*, Durrës, porositur nga shoqëria “\*\*\* ” sh.p.k.

### **Konkluzione lidhur me pasurinë objekt vlerësimi**

**50.** Nga analizimi i dokumentacionit të administruar në dosje, shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe analizës financiare të kryer – për pasurinë e llojit “apartament banimi” të porositur nga shoqëria “\*\*\* ” sh.p.k., në vitin 2007, Komisioni arrin në konkluzionin se subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar saktë të dhënat lidhur me këtë pasuri, si dhe kanë pasur aftësi paguese nga burime financiare të ligjshme, për kryerjen e pagesave përgjatë viteve 2007, 2008, 2009 dhe 2010, për likuidimin e çmimit total të blerjes së kësaj pasurie.

**51. Pasuria e llojit “likuiditete”, bono thesari, në shumën 7,000,000 lekë,** me maturim 12-mujor, investuar te Posta Shqiptare në bazë të kërkesës së datës 1.11.2012, të cilat janë përsëritur në vitet 2013, 2014 dhe 2015 dhe në vazhdimësi ka përfituar interesa.

**51.1.** Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar: (i) të ardhurat nga shitja<sup>86</sup> në datën 16.8.2012, e apartamentit me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup> – pasuri e cila është përfituar më parë nga prindërit me ligjin e privatizimit të banesave; (ii) të ardhurat nga shitja<sup>87</sup> në datën 16.8.2012, e një pjesë trualli me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup> në të njëjtën adresë me apartamentin e sipërcituar – pasuri e përfituar më parë me legalizim nga ALUIZNI<sup>88</sup>. Subjekti ka shpjeguar se sipërfaqja e truallit është oborri i apartamentit me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>.

**51.2.** Gjithashtu, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se në bazë të deklaratës noteriale<sup>89</sup> të datës 2.10.2012, vëllai dhe motra kanë deklaruar se përveç shumën takuese, i kanë kaluar shumën 50,000 euro (e barabartë me 7,000,000 lekë) e përfituar nga shitja e këtyre pasurive. Kjo shumë i është lënë subjektit për ta administruar dhe për tu kujdesur për shëndetin e nënës, e cila banonte në banesën e saj. Pjesa takuese e subjektit nga kjo shitje është 20,000 euro, shumë e cila ka qenë e deklaruar *cash* në banesë.

**51.3. Deklarimi i kësaj pasurie në vite:** referuar DPV/2012 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar investimin në bono thesari te “Posta e Shqipërisë”, me burim “të ardhurat nga shitja e apartamentit në Durrës”.

<sup>86</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.8.2012.

<sup>87</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* prot., datë 16.8.2012.

<sup>88</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 10.9.2010.

<sup>89</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.10.2012.

**51.4.** Gjithashtu, në DPV/2012 subjekti, ndër të tjetra, ka deklaruar: (i) shitur apartamentin me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Durrës – i deklaruar më parë nga privatizimi, vlera e shitjes 7,000,000 lekë – pjesa takuese 50%; dhe (ii) shitur truall + ndërtesë me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup>, ndodhur në Durrës – deklaruar më parë, përfituar nga privatizimi dhe legalizimi, vlera e shitjes 5,116,620 lekë – pjesa takuese 33%.

**51.5.** Ndërsa, në deklaratat periodike vjetore të viteve 2012 – 2016 subjekti i rivlerësimit ka deklaruar të ardhura të përfituara nga interesat e bonove të thesarit, përkatësisht: (i) në vitin 2012, shumën 433,377 lekë; (ii) në vitin 2013, shumën 228,703 lekë; (iii) në vitin 2014, shumën 228,703 lekë; (iv) në vitin 2015, shumën 171,743 lekë; dhe (v) në vitin 2016, shumën 174,858 lekë.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni për këtë pasuri**

**52.** Referuar dokumentacionit të depozituar – administruar në dosjen e ILDKPKI-së<sup>90</sup>, rezulton se subjekti ka investuar shumën prej 7,000,000 lekësh në bono thesari (nëpërmjet Postës Shqiptare sh.a.) duke filluar nga data 1.11.2012 dhe duke vazhduar periodikisht me investime.

**52.1.** Posta Shqiptare<sup>91</sup> sh.a. konfirmon se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj, ka investuar në bono thesari për periudhën 2012 e në vijim. Referuar të dhënave dhe dokumentacionit të dërguar nga Posta Shqiptare sh.a., konstatohet se për periudhën 2012 – 2017 subjekti i rivlerësimit ka pasur të investuar shumën prej 7,000,000 lekë – shumë e cila ka qenë me afatat maturimi 1-vjeçar, periodikisht pa ndërprerje dhe janë përfituar interesa në vlerë neto, përkatësisht:

- për periudhën 30.10.2012 – 31.10.2013, interesa neto në vlerën 390,039 lekë;
- për periudhën 31.10.2013 – 30.10.2014, interesa neto në vlerën 227,703 lekë;
- për periudhën 13.11.2014 – 12.11.2015, interesa neto në vlerë 199,451 lekë;
- për periudhën 11.11.2015 – 10.11.2016, interesa neto në vlerën 171,743 lekë dhe;
- për periudhën 1.12.2016 – 23.11.2017, interesa neto në vlerën 140,460 lekë.

### **Analiza e burimit të të ardhurave të cilat kanë shërbyer për krijimin e kësaj pasurie**

**53.** Siç u evidentua më sipër, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar si burim krijimi të bonove të thesarit, shitjen e pasurive në Durrës.

**53.1.** Nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosjen e ILDKPKI<sup>92</sup>, konstatohet se me kontratën e shitjes së datës 16.8.2012, subjekti i rivlerësimit dhe motra e saj, znj. D.B., i kanë shitur<sup>93</sup> shtetases I.H., pasurinë e llojit apartament me sipërfaqe 86.04 m<sup>2</sup>, të ndodhur në lagjen nr. \*\*\*, Durrës, për vlerën prej 7,000,000 lekë. Gjithashtu rezulton se, po në datë 16.8.2012 - nëpërmjet një kontrate tjetër<sup>94</sup>, subjekti i rivlerësimit, motra e saj, znj. D.B. si dhe i vëllai z. E.S. (përfaqësuar me prokurë nga znj. D.B.), i kanë shitur shtetases I.H., pasurinë e llojit truall me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup> dhe shtesë një kat me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup>, për vlerën 5,116,620 lekë. Ndërsa, referuar dokumentit deklaratë noteriale<sup>95</sup> të datës 2.10.2012 – deklaruesit D.B. dhe E.S. (motra dhe vëllai i subjektit) deklarojnë se, nga vlera e përgjithshme e pasurive të shitura në Durrës (apartamentit me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup> dhe apartamentit 53 m<sup>2</sup> dhe truallit me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup>), përveç pjesës së saj takuese, i kanë dhënë motrës së tyre, znj. Enkelejda Metaliaj (Sofka), shumën 50,000 euro (e barabartë me 7,000,000 lekë).

<sup>90</sup> Aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së – dokumentacion i depozituar nga vetë subjekti.

<sup>91</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 10.7.2020.

<sup>92</sup> Aneks nr. 4/4 në dosjen e ILDKPKI-së – dokumentacion i depozituar nga vetë subjekti.

<sup>93</sup> Kontrata shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.8.2012.

<sup>94</sup> Kontrata e shitblerjes nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 16.8.2012.

<sup>95</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.10.2012.

**53.2.** Në DPV/2012, në rubrikën “*pasuri të paluajtshme dhe të luajtshme*” subjekti ndër të tjetra ka deklaruar (i) shitur apartamentin me sipërfaqe 86 m<sup>2</sup>, i ndodhur në Durrës – i deklaruar më parë nga privatizimi, vlera e shitjes 7,000,000 lekë – pjesa takuese 50% dhe; (ii) shitur truall + ndërtesë me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup>, ndodhur në Durrës - deklaruar më parë përfituar nga privatizimi dhe legalizimi, vlera e shitjes 5,116,620 lekë – pjesa takuese 33%. Ndërsa, në rubrikën “*të dhëna konfidenciale*”, subjekti i rivlerësimit ka deklaruar se, *me shitjen e apartamentit në Durrës – së bashku me shtesën, në vlerën afërsisht 90,000 euro (nga konvertimi) në bazë të deklaratës noteriale me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.10.2012, ndarja e kësaj vlere është bërë në këtë mënyrë – Enkelejda Metaliaj (Softa) dhe D.B. (S.) kanë përfituar nga 20,000 euro secila, ndërsa vlera prej 50,000 euro i është lënë Enkelejdës për kujdesin ndaj nënës së tyre L.S. (me të cilën banon) për mjekim dhe çdo nevojë tjetër.*

**53.3.** Komisioni i kërkoi subjektit të deklarojë periudhën (kohën), vlerën dhe mënyrën/formën (nëpërmjet bankës apo *cash*) të marrjes së shumave të mësipërme nga shitja e këtyre pasurive. Subjekti i rivlerësimit ndër të tjera deklaroi se<sup>96</sup>, *...në 16 gusht 2012 është shitur e gjithë pasuria d.m.th. ajo me sipërfaqe 86.04 m<sup>2</sup> + shtesa anësore 53 m<sup>2</sup>. Vlera 90,000 euro është paguar në bankë. Shuma e përfituar nga subjekti është 70,000 euro (20,000 euro i ka përfituar si rrjedhojë e 1/5 pjesë që rrjedh nga kontrata e shitblerjes me Komunale Banesa e vitit 1993) dhe 50,000 euro janë pjesë e nënës së tyre (e konvertuar në vlerën 7,000,000 lekë ) e cila në këtë kohë jetonte me familjen e saj. Në këto kushte, të dy trashëgimtarët e tjerë së të ndjerës (nënës së tyre), motra dhe vëllai saj (i ndjerë) përpiluan dhe deklaruan sipas deklaratës noteriale të datës 2.10.2012.*

#### **Mënyra e përfitimit të këtyre pasurive/pjesëve takuese në to**

**54.** Siç u evidentua më sipër, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje konstatohet se, pasuria e llojit “apartament” me sipërfaqe 86.04 m<sup>2</sup>, ndodhur në lagjen “S\*\*\*\*”, Durrës, në datën 29.12.1993 është blerë nga familja Sofka (pjesë përbërëse e së cilës është dhe subjekti i rivlerësimit) nga Ndërmarrja Komunale Banesa në shumën prej 18,155 lekë. Bashkëpronarët e kësaj pasurie në momentin e blerjes së saj janë, A., L., E., D. dhe Enkelejda Sofka.

**54.1.** Në vijim, rezultoi se referuar kontratës së shitjes<sup>97</sup> së datës 30.4.2009, shtetasit A., L. dhe E.S. i kanë kaluar pjesën e tyre takuese mbi këtë pasuri, subjektit të rivlerësimit dhe motrës së saj. Pra, pas nënshkrimit të kësaj kontrate subjekti i rivlerësimit dhe motra e saj dispononin *de jure*, 50% secila pjesë takuese mbi apartamentin e sipërcituar.

**54.2.** Ndërsa, për shtesën prej 53 m<sup>2</sup> subjekti ka deklaruar se<sup>98</sup>, *...fakti i bashkëpronësisë mbi këtë shtesë së bashku me motrën dhe vëllain (në pjesë të barabarta), rrjedh nga trashëgimia ligjore e babait të saj, fakt që provohet nga Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës<sup>99</sup>, datë 9.6.2010 dhe, deklarimit të nënës për të mos qenë pjesë e bashkëpronësisë për shtesën, - duke evidentuar faktin se vetë subjekti është bërë bashkëpronare mbi këtë pasuri në datë 8.9.2010, sipas kontratës së kalimit të pronësisë së parcelës ndërtimore pas procesit të legalizimit.*

**54.3.** ZVRPP-ja Durrës<sup>100</sup>, ka informuar se subjekti i rivlerësimit ka pasur në bashkëpronësi pasurinë nr. \*\*\*, z.k. \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, të cilën e ka fituar me leje legalizimi. Referuar dokumentacionit të dërguar nga ZVRPP-ja Durrës konfirmohet se leja e legalizimit për këtë pasuri është nxjerrë në datë 15.4.2011 – në emër të subjektit të

<sup>96</sup> Përgjigjja e pyetjes nr. 9, të pyetësorit nr. 2.

<sup>97</sup> Kontrata e shitblerjes me nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 30.4.2009.

<sup>98</sup> Përgjigjet e pyetjes nr. 9 të pyetësorit nr. 2 të dërguar nga KPK.

<sup>99</sup> Vendimi i Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Durrës me nr. \*\*\*, datë 9.6.2010.

<sup>100</sup> Shkresa “kthim përgjigje” për ILDKPKI me nr. \*\*\* prot., datë 27.6.2018 – Aneks nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI-së.



rivlerësimit, motrës dhe vëllait të saj, dhe se kjo pasuri është shitur në datën 16.8.2012 për vlerën 5,116,620 lekë.

**54.4.** Komisioni konstatoi se, në DPV/2011 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar këtë pasuri – pjesën takuese apo të drejtat reale mbi të, pasuri kjo e përfituar nëpërmjet trashëgimisë ligjore.

**54.5.** Në vijim, e pyetur nga Komisioni lidhur me ndërtimin e kësaj shtese subjekti i rivlerësimit deklaroi se<sup>101</sup>, *...shtesa anësore përbëhet nga dy pjesë, një që është ndërtuar në vitin 1991 sipas vërtetimit të komitetit ekzekutiv të lagjes (të realizonte ballkonin në katin përdhe) dhe pjesa tjetër e shtesës afro 40 m<sup>2</sup> është ndërtuar në muajt mars – prill të vitit 1997. Shtesa prej 40 m<sup>2</sup> është ndërtuar nga firma \*\*\* (ku motra dhe bashkëshorti i saj janë ortakët e kësaj shoqërie), duke shpjeguar se në këtë periudhë kjo firmë ishte duke përfunduar karabinanë e pallatit të parë dhe në kushtet e “luftës” së vitit 1997 nuk kishte siguri për lënien e mjeteve të saj (gjenerator, vinç, betoniere) në kantierin e ndërtimit dhe për këtë arsye ndërtoi këtë shtesë – pranë pronës së familjes sonë, siç po ndërtoheshin shumë shtesa në atë kohë në katet e para të pallateve. Pra, kjo shtesë u ndërtua nga shoqëria \*\*\* dhe kosto e ndërtimit - sipas vlerës së preventivit është 316,644 lekë. Dokumentacioni mbështetës për shtesën duke qenë se nuk ekzistonte një mekanizëm për blerjen e tokës shtetërore u kalua nëpërmjet ALUIZNI-t, praktikë e njëjtë për të gjithë që edhe pse ishin pajisur me leje ndërtimi, nuk arritën ta regjistrojnë pronën pa procesin e legalizimit.*

**54.5.** Në bazë të formularit të pagesës së parcelës ndërtimore figuron se, z. A.S. (babai i subjektit) ka aplikuar për legalizimin e shtesës anësore me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup>, me vetëdeklarimin nr. \*\*\*, datë 6.11.2006.

**54.6.** Më 9.6.2010, Gjykata e Rrethit Gjyqësor ka vendosur lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore për të ndjerin, z. A.S., duke përcaktuar si trashëgimtarë ligjorë të radhës së parë të tij, znj. L.S. –bashkëshortja, z. E.S. – i biri, znj. D.S. (B.) – e bija dhe, znj. Enkelejda Sofka (Metaliaj) – e bija.

**54.7.** Nëpërmjet deklaratës së datës 3.8.2010, nëna e subjektit të rivlerësimit<sup>102</sup>, znj. L.S., ka shprehur vullnetin e saj se nuk ka asnjë pretendim për pjesën e saj takuese si trashëgimtare ligjore e të ndjerit A.S., në pasurinë e cila është hedhur për legalizim në zonën kadastrale \*\*\*, parcelë ndërtimore 53 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe trualli 53 m<sup>2</sup> – duke deklaruar se heq dorë nga pjesa e saj takuese në këtë pasuri dhe se nuk ka asnjë pretendim në të ardhmen.

**54.8.** Në datën 8.9.2010, me anë kontratës së kalimit të pronësisë të parcelës ndërtimore<sup>103</sup> (shitje me rezervë e pronës), Drejtoria e Aluzinit Durrës u shet trashëgimtarëve ligjorë të z. A.S., shtetasve D.B., Enkelejda Metaliaj dhe E.S. parcelën ndërtimore me sipërfaqe 53 m<sup>2</sup> – mbi të cilën ishte ndërtuar objekti informal deklaruar për legalizim nga z. A.S. Çmimi i shitjes në vlerën prej 89,600 lekë.

**54.9.** Komisioni konstaton se në DPV/2010 subjekti i rivlerësimit nuk ka deklaruar përfitimin e kësaj parcele ndërtimore/pjesën takuese të saj.

**54.10.** Pra, duket se leja e legalizimit për objektin informal të ndërtuar është nxjerrë në emër të trashëgimtarëve ligjorë të z. A.S., tre fëmijëve të tij – në referim të vendimit gjykatës për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë ligjore dhe deklaratës noteriale të bërë nga nëna e subjektit të rivlerësimit.

<sup>101</sup> Përgjigjet e pyetjes nr. 9, të Pyetësorit nr. 2 të dërguar nga Komisioni.

<sup>102</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 31.8.2010.

<sup>103</sup> Kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 8.9.2010.

**54.11.** Në analizë të dhënave të referuara si më sipër, transaksioneve të kryera lidhur me këto dy pasuri, rezulton se subjekti ka qënë i pasaktë për sa i përket deklaramit të pjesës takuese nga shitja e këtyre dy pasurive, pasi referuar dokumentacionit ligjor - me shitjen e këtyre dy pasurive pjesa takuese e subjektit është 5,205,540 lekë. Në këtë kuptim, duket i pasaktë edhe deklarimi i bërë lidhur me kalimin/dhënien e shumës prej 50,000 euro (rreth 7,000,000 lekë) – nga motra dhe vëllai i saj, duke konsideruar faktin se pjesa takuese e tyre ishte më e vogël.

**54.12.** Pasi Komisioni i kërkoi shpjegime lidhur me këtë deklaram, subjekti i rivlerësimi gjatë hetimit administrativ, por edhe prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimit, ka argumentuar se, *...shuma e përfituar prej saj nga shitja e këtyre pasurive është në vlerën prej 70,000 euro (ku 20,000 euro i ka përfituar si rrjedhojë e 1/5 pjesë që rrjedh nga kontrata e shitblerjes me Komunale Banesa të vitit 1993 (gjendja familjare e 01.12.1992) dhe 50,000 euro janë pjesa e nënës, shumë e cila konvertohet me vlerën 7,000,000 (shtatë milion) lekë, duke theksuar se në atë kohë nëna jetonte me familjen e saj.*

**54.13.** Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se, *...ka qenë e saktë ligjërisht në deklarimin e pjesëve takuese nga shitja e të dy pasurive, për sa kohë që palët janë në kushtet e pranimit me vullnet të të gjitha veprimeve të bëra midis tyre D., E. dhe Enkelejda, pa asnjë detyrim. Në kohën kur vëllai kishte përfituar pasurinë apartament nga kredia prej 160 m2, kur motra D. dhe ajo vetë kishin apartamentet e tyre të banimit, qëllimi final i pjesëve takuese ishte shumë transparent dhe me vullnet të lirë, të pa diktuar nga ekonomia tregut, pasi ajo pronë ishte e prindërve, dhe meqenëse nëna pas vdekjes së babait kishte dëshirë të rrinte me të pas shitjes së shtëpisë së tyre, u gjet kjo mënyrë ligjore e shkrimit dhe pranimit midis bashkëpronarëve E., D., Enkelejda.*

**54.14.** Rezulton se, referuar deklaratës noteriale<sup>104</sup> të datës 2.10.2012, E.S. dhe D.B. kanë deklaruar se, *[...] Nga vlera e përgjithshme e përfituar nga shitja e këtyre ambienteve, përveç pjesës takuese të saj, i kemi dhënë motrës tonë Enkelejda Metaliaj (Sofka) shumë 50,000 euro (e barabartë me 7,000,000 lekë). Meqenëse nëna jonë L. S. aktualisht është e sëmurë dhe jeton me Enkelejda Sofka, shuma e mësipërme i është dhënë kësaj të fundit për ta përdorur për kujdesin dhe shëndetin e nënës tonë [...].*

**54.15.** Komisioni çmon se, bazuar në analizën e kryer si më sipër - sipas së cilës u arrit në përfundimin se subjekti ishte bindës në shpjegimet e tij lidhur me transaksionin e kryer në vitin 2009 për shitblerjen e apartamentit të pronësi të familjes (pra, që nuk ka kryer pagesë për blerjen e kësaj pasurie), edhe në këtë rast është munduar të deklarojë me vërtetësi rrethanat reale/faktike të përfitimit të vlerave monetare nga shitja e këtyre pasurive, sipas dakordësisë mes familjarëve të saj, krahas të dhënave të pasqyruara në dokumentacion ligjor për shitjen e tyre – deklarim i cili vlerësohet se është në harmoni të plotë me deklaramet e mëparshme për kontributin dhe pjesën takuese mbi këto pasuri.

**54.16.** Nga verifikimi i dokumentacionit – pjesë e dosjes së ILDKPKI<sup>105</sup>, rezulton se në llogarinë bankare dyemërore të motrës së subjektit dhe bashkëshortit të saj në datë 16.8.2012 është depozituar cash shuma prej 80,000 euro me përshkrimin “*derdhje nga I.H. blerje apartamenti 2+1 + shtesë anësore rep \*\*\*, kol \*\*\*, rep \*\*\*, kol \*\*\**”, dhe në datë 21.8.2012 është depozituar cash shuma 10,000 euro me përshkrimin “*derdhje nga I.H. blerje apartamenti*”. Në vijim vërehet se, nga kjo llogari, në datë 21.8.2012, z. A.B., ka tërhequr cash shumë prej 40,000 euro dhe, në datën 24.8.2012 ka tërhequr cash shumë prej 50,000 euro.

<sup>104</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 2.10.2012

<sup>105</sup> Dokumenti, lëvizje llogarie bankare – i llogarisë dyemërore në valutën euro në “A\*\*\* Bank”, që i përket A. dhe D.B.

**54.17.** Siç është pasqyruar më sipër, subjekti ka bërë kërkesë në “Postën Shqiptare” sh.a., në datë 1.11.2012, për investimin në bono thesari të shumës prej 7,000,000 lekë. Pra, rezulton e provuar se investimi në bono thesari është kryer nga subjekti mbas tërheqjes së vlerave monetare të përfituara nga shitja e këtyre pasurive, dhe pas nënshkrimit të deklaratës noteriale për dhënien e shumës 50,000 euro, krahas pjesës takuese të saj.

**54.18.** Gjithashtu konstatohet se, në cilësinë e personit deklarues në ILDKPKI, z. A.B., në DPV/2012<sup>106</sup> ka deklaruar si shtesë pasurie shumë prej 20,000 eurosh (pjesë takuese 50%), nga shitja e pasurive në pronësi të bashkëshortes së tij, znj. D.B..

**54.19.** Komisioni vëren se, deklarimi i bërë nga z. A.B. është në përputhje me deklaratën noteriale të datës 2.10.2012, dhe se përbën provë të rëndësishme në mbështetje të deklarimeve të bëra nga subjekti i rivlerësimit.

**54.20.** Sa më sipër, nga analizimi në harmoni i shpjegimeve të dhëna nga subjekti me provat e administruara në dosje lidhur me transaksionet e kryera për këto dy pasuri, trupa gjyquese krijoi bindjen se nga totali i shitjes së tyre, subjekti ka përfituar shumë prej 70,000 euro (shuma 20,000 euro deklaruar si pjesë takuese dhe shuma 50,000 euro e lënë në administrim të subjektit për shkak të përkujdesjes ndaj nënës).

**54.21.** Si konkluzion, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura nga burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht investimin e kryer në bono thesari në vitin 2012, në vlerën 7,000,000 lekë.

**55. Pasuria e llojit “likuiditete”, gjendje *cash* në vlerën 10,000 euro. Pjesa takuese: 50 %.**

**55.1.** Si burim krijimi të kësaj pasurie subjekti ka deklaruar të ardhurat nga shitja e apartamentit dhe truallit në Durrës. Gjithashtu, subjekti ka deklaruar se pjesa e saj takuese nga shitja e këtyre dy pasurive ka qenë në shumë prej 20,000 euro, dhe se në vitin 2015 kjo shumë është pakësuar 3,000 euro, ndërsa në vitin 2016 është pakësuar me 7,000 euro, pasi ka shlyer një pjesë huaje.

**55.2.** Nga verifikimi i deklaratave periodike vjetore të depozituara në ILDKPKI konfirmohet se, (i) në DPV/2012 subjekti ka deklaruar shtimin e gjendjes *cash* në valutë në shumë prej 20,000 euro, me burim krijimi të ardhurat nga shitja e apartamentit në Durrës; (ii) në DPV/2015, ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në shumë prej 3,000 euro – për shpenzime udhëtimi në SHBA; dhe (iii) në DPV/2016 ka deklaruar pakësimin e gjendjes *cash* në shumë prej 7,000 euro.

**55.3.** Në analizën e kryer më sipër, Komisioni arriti në përfundimin se subjekti i rivlerësimit ka përfituar shumë prej 70,000 euro nga shitja e pasurive në Durrës, nga të cilat vlera prej 50,000 euro (rreth 7,000,000 lekë) është investuar në bono thesari.

**55.4.** Si rrjedhim, Komisioni vlerëson se subjekti i rivlerësimit ka pasur të ardhura të ligjshme të mjaftueshme – me burim shitjen e pasurive në Durrës, të cilat kanë mundësuar plotësisht krijimin e likuiditeteve *cash* në vlerën prej 20,000 euro të deklaruara si shtesë pasurie në DPV/2012, nga të cilat ka rrjedhur pasuria e deklaruar në deklaratën “Vetting” si gjendje në formë likuiditetesh *cash*, në vlerën 10,000 euro.

**56. Pasuria e llojit “automjet”, e markës “Volkswagen”, e tipit “Passat”, me targa \*\*\*, - përfituar me kontratën<sup>107</sup> e shitblerjes së datës 26.7.2011.**

<sup>106</sup> Deklaratat periodike vetore të depozituara nga z. A.B. ndër vite në ILDKPKI, janë pjesë përbërëse e dosjes së dërguar nga ILDKPKI për subjektin e rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj.

<sup>107</sup> Kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 26.7.2011.

**56.1.** Si burim krijimi të kësaj pasurie ka deklaruar, të ardhurat e përfituara nga Byroja e Sigurimit – si pasojë e dëmshpërblimit për aksidentimin e makinës së mëparshme (aksidentuar nga nipi), në vlerën 1,241,504 lekë.

**57.2. Deklarimi i kësaj pasurie në vite:** referuar DPV/2011 konstatohet se, subjekti ka deklaruar blerjen nga bashkëshorti të pasurisë së llojit “automjet”, marka “Volkswagen”, tip “Passat”, me vlerë 1,000,000 lekë, - blerë me të ardhurat e përfituara nga sigurimi i aksidentit.

### **Hetimi i kryer nga Komisioni lidhur me këtë pasuri dhe burimin e krijimit të saj**

**58. DPSHTRR-ja<sup>108</sup>,** konfirmon se bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka pasur të regjistruar në pronësi të tij këtë automjet, duke na dërguar dosjen e plotë të këtij mjeti.

**58.1.** Nga verifikimi i dosjes së këtij mjeti (i cili më parë ka mbajtur targën \*\*\*\*) konstatohet se, (i) në datë 26.7.2011 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit ka blerë këtë automjet nga shtetasi P. P. – për vlerën 1,000,000 lekë dhe; (ii) në datën 26.11.2018 ia ka shitur këtë automjet shoqërisë “\*\*\*\*” sh.p.k., për vlerën 6,500 euro.

**58.2.** Rezulton se, në datën 6.2.2008 bashkëshorti i subjekti i rivlerësimit ka blerë<sup>109</sup> nga shtetasi N. S., automjetin e markës “Volkswagen”, tipi “Passat” (me targa të huaja, i pazhdoganuar), për vlerën prej 500,000 lekësh. Por, referuar DPV/2008 subjekti/personi i lidhur ka deklaruar blerjen këtij mjeti për vlerën 800,000 lekë. Ky automjet, pasi është zhdoganuar, ka marrë targën \*\*\*.

**58.3.** Sa më sipër, Komisioni konstatoi mospërputhje mes vlerës së deklaruar të këtij mjeti në DPV/2008 dhe vlerës së përcaktuar në kontratë për blerjen e tij.

**58.4.** Lidhur me këtë konstatim, subjekti i rivlerësimit deklaroi se<sup>110</sup>, *...për sa i përket blerjes –shitjes, regjistrimit apo deklarimit të automjeteve është marrë posaçërisht bashkëshorti, i cili i ka konfirmuar se, për pagimin e doganës e të disa tarifave të tjera, është paguar shuma prej 300,000 lekë, para lidhjes së kontratës së shitjes datë 6.2.2008.*

**58.5.** Në vijim, nga verifikimi i dokumentacionit të administruar në dosje<sup>111</sup> konstatohet se Byroja Shqiptare e Sigurimit ka kryer praktikën e plotë për dëmin e pësuar nga aksidenti i mjedit “Volkswagen Passat”, me targë \*\*\* , me përfitues, z. A.M., bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit<sup>112</sup>. Nga verifikimi i dokumentacionit pjesë e kësaj dosjes së kësaj praktike konstatohet se, në bazë të dokumentit urdhërpagesë dëmsh<sup>113</sup> datë 11.7.2011 (nga fondi i kartonit jeshil) Byroja Shqiptare e Sigurimeve – ka vendosur se shuma e dëmshpërblimit në favor të z. A.M. është 1,241,504 lekë.

**58.6.** Referuar shkresës “kthim përgjigjeje” të DPSHTRR-së<sup>114</sup> dhe dokumentacionit bashkëlidhur saj - të dërguar pranë Komisionit, si edhe shkresës së depozituar si provë nga subjekti i rivlerësimit<sup>115</sup>, konfirmohet se, z. A.M., ka pasur të regjistruar automjetin me targa \*\*\* , i cili është me status “çregjistrim të përhershëm”.

**58.7.** Nga verifikimi të dhënave të dërguara nga “A\*\*\* Bank”<sup>116</sup> konstatohet se, në llogarinë në lekë bashkëshortit të subjektit, në datën 12.7.2011 është transferuar shuma

<sup>108</sup> Shkresat: (i) nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2019 dhe (ii) nr. \*\*\* prot., datë 39.1.2019.

<sup>109</sup> Kontrata nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 6.2.2008.

<sup>110</sup> Përgjigje të pyetësorit nr. 2.

<sup>111</sup> Aneksi nr. \*\*\* në dosjen e ILDKPKI – dokumentacion i dorëzuar nga vetë subjekti.

<sup>112</sup> Kjo praktikë i është dërguar bashkëshortit të subjektit me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 26.1.2015.

<sup>113</sup> Urdhërpagesë dëmsh nr. \*\*\* , datë 11.7.2011.

<sup>114</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 25.1.2019.

<sup>115</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 20.1.2020.

<sup>116</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 27.4.2020.

prej 1,241,504 lekë (si dëm për karton jeshil). Në vijim, nga verifikimi i kësaj llogarie konstatohet se: (i) në datën 12.7.2011 është tërhequr *cash* shuma 600,000 lekë, dhe në datën 13.7.2011 është tërhequr *cash* shuma 640,000 lekë.

**58.8.** Pra, rezulton se rreth 13 ditë para blerjes së pasurisë së llojit “automjet” objekt vlerësimi (tip “Volkswagen Passat” me targa \*\*\*– blerë në vlerën prej 1,000,000 lekë), subjekti ka tërhequr në total shumën prej 1,240,000 lekësh, që ka si burim dëmshpërblimin për aksidentin e automjetit me targë \*\*\*.

**58.9.** Sa më sipër, Komisioni konstaton se në deklaratën “Vetting” subjekti i rivlerësimit dhe personi i lidhur kanë deklaruar saktë të dhënat mbi pasurinë objekt vlerësimi, si dhe kanë pasur burime financiare të ligjshme për të justifikuar plotësisht blerjen e saj.

## ÇËSHTJE TË TJERA

**59.** ALUIZNI, Drejtoria Lezhë<sup>117</sup> informon se, nga verifikimi i dosjes me nr. \*\*\* prot., datë 30.9.2014 bashkëshorti i subjektit të rivlerësimit, z. A.M., ka vetedeklaruar për legalizim objekt informal – kaluar me deklaratë noteriale në emër të z. S.M.

**59.1.** Referuar dokumentit “*Deklaratë për përfshirje në procedurat e legalizimit të ndërtimit pa leje dhe/ose në ndërtim me leje*”, duket se z. A.M. ka deklaruar e një objekt informal në vitin 2012.

**59.2.** Ndërsa, referuar deklaratës noteriale<sup>118</sup> të datës 17.9.2015, me subjekt deklarues R.M., A.M.dhe Enkelejda Metaliaj në përmbajtje të saj përcakton se, *deklaruesi A.M. deklaron nën përgjegjësinë e tij personale e ligjore se në bazë të vetëdeklarimit të dorëzuar pranë Bashkisë M\*\*\* ka deklaruar për legalizim në datën 30.9.2014 me nr. prot. \*\*\*, një objekt të paluajtshëm. Duke qenë se, ky objekt është ndërtuar me investimet e vëllait të tij, z. S.M., heq dorë nga procedurat e legalizimit duke mos pretenduar asnjë pronësi për këtë objekt dhe është dakord që leja e legalizimit të dalë në emër të vëllait të tij, z. S.M., investitorit dhe poseduesit real të këtij objekti. Gjithashtu, deklaruesit R.M. në cilësinë e kryefamiljares së familjes ku bën pjesë A.M. dhe Enkelejda Metaliaj në cilësinë e anëtares së kësaj familjeje deklarojnë se, janë dakord që procedura e legalizimit të kalojë në emër të z. S.M., me çfarë z. A.M. ka pohuar në këtë deklaratë – referuar si më sipër, dhe nuk kanë asnjë pretendim ndaj kësaj pasurie të paluajtshme.*

**59.3.** Në vijim, vërehet se procedurat e legalizimi janë ndjekur nga z. S.M. dhe leja e legalizimit për këtë objekt me nr. \*\*\*, datë 6.8.2015 – është nxjerrë në emër të z. S.M..

**59.4.** Me dërgimin e rezultateve të hetimit, Komisioni i kërkoi informacion shterues lidhur me këtë objekt, ku të përfshihet informacion për periudhën e ndërtimit, vlerën e investimit, si edhe burimin e krijimit të tij.

**59.5.** Në prapësimet e dërguara, lidhur me këtë objekt të legalizuar subjekti ka shpjeguar se, *ndërtimi i tij nuk lidhet me kontribut pas martesë, pasi bëhet fjalë banesën 2-katëshe që bashkëshorti i saj ka marrë pjesën nga pjesëtimi vullnetar në vitin 1997, kontribut që një pjesë të saj shumën 12 000 USD ka shkuar për blerjen e shtëpisë prej 96 m<sup>2</sup> me adresë: rruga “\*\*\*”, Kulla \*\*\* “\*\*\*”, Tiranë. Ka depozituar si provë të re, vërtetimin e ZVRPP-së Kurbin me nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2021.*

### **59.6. Gjithashtu, subjekti ka parashtruar se:**

**a. Së pari,** bashkëshorti i i saj nuk ka bërë kërkesë për legalizim objekti që i përket shtëpisë 2-katëshe + papafingo, ndodhur në M\*\*\*, sikundër e kërkon ligji nr. 9482,

<sup>117</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2019.

<sup>118</sup> Deklarata noteriale nr. \*\*\*rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.9.2015.

datë 03.04.2006 “Për legalizimin, urbanizimin dhe integrimin e ndërtimeve pa leje”, i ndryshuar. Nga marrja e dosjes së aplikimit pranë ALUIZNIT Lezhë (sot ASHK-ja Lezhë) referuar deklaratës për legalizim objekti, vërtet emri i këtij vetëdeklarimi është bërë në emër të bashkëshortit të saj, por deklaron se nuk është nënshkrimi i tij. Kjo pasi dhe numri i kontaktit telefonik të vendosur në vetëdeklarim nuk është i tij, pasi ai asnjëherë nuk ka disponuar numrin e telefonit \*\*\*, dhe se numri i kontaktit personal prej vitesh i bashkëshortit është \*\*\*.

Është depozituar si provë në seancën dëgjimore të datës 25.3.2021 (nga përfaqësuesi i subjektit) shkresa e kompanisë telefonike “\*\*\*\*” sh.a., me nr. \*\*\* prot., datë 18.3.2021.

**b. Së dyti**, me konstatimin e këtij fakti, që deklarimi për legalizim është bërë në emër të bashkëshortit të saj, A.M., pa vetëdijen e tij, ata (bashkëshorti, nëna e tij, dhe subjekti) kanë bërë deklaratën noteriale nr. \*\*\* rep., nr. \*\*\* kol., datë 17.09.2015, si i vetmi mjet procedural për të vijuar procedurat e legalizimit në emër të investitorit të vërtetë që është S.M.

**c. Së treti**, në lidhje me sa sipër, në deklarimin e bërë me dorëzimin e deklaratës “Vetting” subjekti dhe bashkëshorti i saj – si subjekt deklarues, kanë deklaruar si burim krijimi të apartamentit prej 96 m<sup>2</sup>: (i) të ardhurat e siguruara nga paga e bashkëshortit si gjyqtar në Gjykatën e Tiranës, (ii) honorare të marra tek fondacioni “\*\*\*\*” si edhe; (iii) kursimet familjare të shprehura si pjesëtim vullnetar të një pjese banese 2-katëshe në M\*\*\* (si pjesë takuese). Ky fakt i pasqyruar edhe në deklaratën fillestare të pasurisë, në referim të së cilës bashkëshorti i subjektit ka deklaruar si burim krijimi të kësaj pasurie të ardhurat e përfituara nga pjesëtimi vullnetar – pjesa takuese e një banese 2-katëshe me 6 dhoma dhe oborr e ndodhur në lagjen “\*\*\*\*”, M\*\*\* (bëhet fjalë për të njëjtën banesë).

**59.6.1.** Në lidhje me këtë fakt, gjithashtu, subjekti ka vënë në dijeni se, mbi bazën e deklarimit të bashkëshortit të saj në pyetësorin nr.2, me cilësinë e subjektit të rivlerësimit ndër të tjera prej tij është cituar se: *[...] Familja ime është vendosur për banim në qytetin e M\*\*\* rreth muajit Maj të vitit 1964, në një zonë informale apo siç quhej për kohën jashtë vijës së verdhe në periferi të qytetit. Në atë kohë është blerë një ndërtesë e vjetër pothuajse e degraduar dhe me kalimin e kohës është shembur banesa e vjetër dhe ndër vite është ndërtuar një banesë njëkatëshe me tre dhoma ne truallin e ekzistues si dhe më vonë është ndërtuar dhe kati i dytë. Dy katet janë ndërtuar me blloqe betoni të prodhuara nga vet familja. E gjithë është ndërtuar nga vet pjesëtarët e familjes pasi ishin me profesion murator-karpantjerë. Për ndërtimin e saj pushteti lokal nuk jepte leje ndërtimi në formën klasike me shkrim pasi ndodhej jashtë vijës së verdhë, por lejohet për nevoja të domosdoshme dhe jepej një forme aprovimi nga pushteti lokal dhe të lejonin ndërtimin. Kjo banesë është ndërtuar para viteve 1990 dhe në vitin 1997 shkak të amortizimit të çatisë është ndërruar çatia duke e ndërtuar këtë çati të ngritur në formën e papafingos duke krijuar dy dhoma. Papafingo është e ndërtuar komplet me dërrasë dhe është ndërtuar nga vëllezërit, me ndihme si fuqi punëtore pa shpërblim nga të afërmit dhe komshinjtë e tyre. Shpenzimet kanë qenë minimale pasi shpjegova kati i parë është ndërtuar rreth viteve 1970-1975, kati i dytë është ndërtuar rreth viteve 1980-1982 kati i dytë, ndërsa papafingo është ndërtuar rreth viteve 1998-1999[...].*

**59.6.2.** Në vijim, subjekti ka referuar faktin se procedurat e legalizimit për këtë objekt janë ndjekur nga z. S.M., dhe leja e legalizimit për këtë objekt me nr. \*\*\*, datë 6.8.2015 – është nxjerrë në emër të tij.

Gjithashtu, subjekti ka paraqitur një historik të shkurtër të pasurisë së familjes së bashkëshortit – mbi të cilën është ndërtuar ky objekt informal, e konkretisht përfitimin e pasurisë së llojit tokë arë + truall me sipërfaqe 2220 m<sup>2</sup>, nga kjo 200 m<sup>2</sup> truall,

regjistruar në datën 22.5.1996, në emër të Z.M. (babai i bashkëshortit), dhe transaksionet e kryera në vijim mbi këtë pasuri.

### **Analiza e kryer nga Komisioni/vlerësimi përfundimtar i shpjegimeve dhe provave**

**60.** Nga verifikimi i informacionit/dokumentacionit të dërguar nga ASHK (përfshirë dhe dokumentacionin e dërguar nga ASHK-ja – pjesë e dosjes së hetimit për subjektin e rivlerësimit, z. A.M.)<sup>119</sup>, Komisioni vëren se:

**60.1.** Për pasurinë e llojit “truall + arë” me sipërfaqe 2220 m<sup>2</sup>, nga kjo sipërfaqe trualli 200 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtese 120 m<sup>2</sup>, është lëshuar certifikata për vërtetim pronësie me nr. \*\*\*, datë 10.1.2012, në emër të shtetasit Z.M. (regjistruar me nr. \*\*\*);

**60.2.** Në vitin 2014, është lëshuar dëshmia e trashëgimisë ligjore z. Z.M., nga ku për pasurinë e llojit truall + arë me sipërfaqe 2220 m<sup>2</sup>, nga kjo sipërfaqe trualli 200 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtese 120 m<sup>2</sup>, janë njohur si trashëgimtarë ligjorë bashkëshorti i subjektit, nëna, e motra dhe dy vëllezërit e tij.

**60.3.** Me deklaratën noteriale të datës 2.9.2014, nëna dhe e motra e bashkëshortit të subjektit heqin dorë nga pjesa takuese e tyre mbi këtë pasuri;

**60.4.** Me deklaratën noteriale të datës 9.3.2015, bashkëshorti i subjektit dhe vëllai i tij z. M.M. heqin dorë nga pjesa takuese e tyre mbi këtë pasuri, duke hequr dorë nga bashkëpronësia.

**60.5.** Bazuar në veprimet e mësipërme, në datën 11.3.2015, pasuria e llojit “truall + arë” me sipërfaqe 2220 m<sup>2</sup>, nga kjo sipërfaqe trualli 200 m<sup>2</sup> dhe sipërfaqe ndërtese 120 m<sup>2</sup>, është regjistruar në emër të z. S.M.

**60.6.** Gjithashtu, referuar shkresës nr. \*\*\* prot., datë 12.3.2021 – të depozituar nga subjekti si provë e re pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Zyra Vendore e Agjencisë Shtetërore të Kadastrës Kurbin, vërteton se banesa në pronësi të Z. M.M. me nr. pasurie \*\*\*, me indeks harte \*\*\* (\*\*\*), është ndërtuar para vitit 1990, dhe para këtij viti ka qenë dykatëshe.

**60.7.** Nga verifikimi dhe analizimi i dokumentacionit të sipërcituar, duket se ndërtesa prej 120 m<sup>2</sup> (pjesë e pasurisë me nr. \*\*\*) është shtëpia e vjetër e familjes Metaliaj – deklaruar nga bashkëshorti i subjektit si e blerë në vitin 1964 nga babai i tij, ndërtesë e cila në referim të shpjegimeve të dhëna u shemb pasi ishte e vjetër dhe e rënuar. Ndërsa ndërtesa, për të cilën është aplikuar për legalizim duket se është ndërtuar – mbi pasurinë me nr. \*\*\* në pronësi të familjes Metaliaj, dhe sipas shpjegimeve të dhëna nga bashkëshorti i subjektit, është ndërtuar nga gjithë pjesëtarët e familjes prej asaj kohe (para viteve ‘90) e deri në vitin 1998, porse ai ka hequr dorë në vitin 1997.

**60.8.** Rezulton se, pikërisht për këtë godinë (2-katëshe) në deklaratën fillestare të pasurisë bashkëshorti i subjektit ka deklaruar heqjen dorë vullnetarisht për pjesën takuese, duke pretenduar se ka marrë vlerën monetare përkatëse që në vitin 1997 për këtë shkak, deklaruar kjo vlerë si burim për blerjen e pasurisë vetjake të tij, apartamentit prej 96 m<sup>2</sup>, të ndodhur në Tiranë (deklaruar edhe në deklaratën “Vetting”).

**60.9.** Në këtë kuptim, Komisioni konstaton një situatë kontradiktore në kushtet kur vërehet se për të njëjtën pasuri bashkëshorti i subjektit ka deklaruar se ka hequr dorë vullnetarisht në deklaratën fillestare të pasurisë të dorëzuar në ILDKPKI në datën 24.3.2004, por nga ana tjetër duket sikur ka aplikuar për legalizimin e saj në vitin 2014.

---

<sup>119</sup> Me vendimin e datës 2.2.2021, trupi gjykues vendosi të administrojë edhe dokumentacion nga dosja e hetimit të subjektit të rivlerësimit, z. A.M., që lidhet me pasurinë llojit tokë arë + truall me sipërfaqe 2220 m<sup>2</sup>, nga kjo 200 m<sup>2</sup> truall, regjistruar fillimisht në emër të babait të z. Z.M.

**60.10.** Subjekti, në referim të shpjegimeve të dhëna nga bashkëshorti i saj ka pretenduar se ai nuk ka qenë aplikues për legalizimin e kësaj pasurie, nuk ka firmosur në formularin e aplikimit dhe se numri i telefonit i vendosur në formular nuk i përket atij.

**60.11.** Gjithsesi, Komisioni vëren se z. A.M. dhe familjarët e tij (nëna dhe bashkëshortja) kanë hequr dorë nga ky aplikim nëpërmjet deklaratës noteriale të datës 17.9.2015.

**60.12.** Në vijim të verifikimit të dosjes së legalizimit të kësaj pasurie rezulton se, e gjithë procedura e legalizimit është ndjekur dhe është kryer për/nga z. S.M. (vëllai i bashkëshortit të subjektit), e konkretisht:

- i. referuar procesverbalit të mbajtur nga ALUIZNI në datë 3.3.2015 – procesverbal i verifikimit në terren, ndër përcaktohet se, *...ndërtimi informal banesë 2kat+papafingo në posedim të S.M., i përfshirë në procedurat e legalizimit me vetëdeklairimin/kërkesën/deklaratën nr. \*\*\*, datë 30.9.2014;*
- ii. referuar dokumentit “aktkualifikimi”, nr. \*\*\*, datë 9.3.2015 – të Drejtorisë Rajonale të ALUIZNI-t, Qarku Lezhë, ndër të tjera përcaktohet se, *për objektin informal që posedohet nga S.M., të deklaruar me vetëdeklarimin nr. \*\*\*, datë 30.9.2014... - ...gjithashtu rezulton se objekti informal ka 342 m<sup>2</sup> parcelë ndërtimore, sipërfaqe të bazës së objektit 114,33 m<sup>2</sup>, numër katesh 2(dy) + papafingo, është identifikuar në ortofoton dixhitale, fotografuar në datë 14.4.2007;*
- iii. z. S. M. ka nënshkruar dy deklarata në datën 3.3.2015 për efekt të procesit të legalizimit – lidhur me këtë objekt, përkatësisht për zbatimin e planit rregullues dhe për dëmet e pasurisë;
- iv. ALUIZNI Drejtoria Lezhë, me vendimin nr. \*\*\*, datën 9.3.2015, - ka vendosur për kualifikimin për legalizim të objektit informal në posedim të z. S.M., “objektin godinë banimi 2 kat + papafingo”;
- v. Në vijim të procesit të legalizimit rezulton se, në datën 6.8.2015 është lëshuar leja e legalizimit dhe kjo pasuri është regjistruar në ASHK në emër të z. S.M..

**60.13.** Sa më sipër rezulton e provuar se, pavarësisht se në formularin e aplikimit për legalizimin e këtij objekti referohet emri bashkëshortit të subjektit, gjatë gjithë procesit organet kompetente kanë njohur si aplikues dhe posedues të këtij objekti, z. S.M., kjo edhe para nënshkrimit të deklaratës noteriale për heqjen dorë nga z. A.M. dhe familjarët e tij. Madje, edhe vetë leja e legalizimit është nxjerrë në emër të z. S.M.- përpara deklaratës për heqje dorë nga aplikimi.

**60.14.** Gjithashtu nga analiza e provave dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, duket se kemi të bëjmë me një objekt – i cili të paktën sipas vetëdeklarimit të bërë në deklaratën fillestare të pasurisë – rezulton i ndërtuar në 2 kate, për të cilin bashkëshorti i subjektit ka deklaruar kontribut në ndërtimin e tij deri në vitin 1997, dhe se ka marrë pjesën takuese nga heqja dorë vullnetarisht prej tij po në këtë vit.

**60.15.** Si konkluzion, nga analizimi në tërësi i dokumentacionit ligjor provues të referuar si më sipër, Komisioni vlerëson se janë bindëse shpjegimet e dhëna, dhe se nuk ka dyshime se subjekti të ketë kontribut në krijimin e kësaj pasurie, e cila i është nënshtruar procedurës së legalizimit.

### **Konkluzioni i Komisionit mbi vlerësimin e pasurisë**

**61.** Në përfundim, Komisioni vlerëson se subjekti nuk ka në pronësi ose në përdorim pasuri më të mëdha nga sa mund të justifikojë ligjërisht. Nga hetimi administrativ dhe shqyrtimi i dokumentacionit rezulton se subjekti i rivlerësimit në deklaratën “Vetting”



ka deklaruar saktësisht dhe plotësisht pasuritë e saj dhe të personave të lidhur me të, ashtu siç parashikohet në pikën 1, të nenit D, të Aneksit të Kushtetutës.

**66.1.** Subjekti i rivlerësimit ka arritur të shpjegojë bindshëm burimin e ligjshëm të pasurisë, ka dorëzuar në kohë deklaratën e pasurisë dhe nuk është përpjekur të fshehtë apo të paraqesë në mënyrë të pasaktë pasuritë në pronësi, zotërim ose në përdorim të saj. Kjo do të thotë që në rastin e subjektit të rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj, nuk vërtetohen shkaqe që Kushtetuta i ka parashikuar të tilla që, nëse vërtetohen, do të zbatohet parimi i prezumimit në favor të masës disiplinore të shkarkimit.

**66.2.** Siç u pasqyrua edhe më sipër, Komisioni analizoi, vlerësoi dhe mori në konsideratë qëndrimin e subjektit në harmoni me provat e administruara në dosje, duke pranuar dhe reflektuar të gjitha efektet e shpjegimeve bindëse dhe të bazuara në dokumentacion justifikues ligjor.

**66.3.** Në lidhje me problematikat e konstatuara në vlerësimin e kriterit të pasurisë, trupi gjykues çmon se pasaktësitë në deklaram, nuk janë të mjaftueshme që të sjellin aplikimin e pikës 3 të nenit 61 të ligjit nr. 84/2016. Për më tepër, Komisioni, gjatë hetimit administrativ, konstatoi se në asnjë rast pasaktësitë e konstatuara nuk kanë ndikuar në cenimin e burimit të krijimit të pasurive të subjektit të rivlerësimit.

**66.4.** Duke gjykuar mbi bazën e parimit të proporcionalitetit, deklaramet e pasakta të konstatuara si më sipër nuk ndikojnë në vlerësimin tërësor të pasurisë së subjektit. Komisioni çmon se për shkak të peshës specifike të vogël të tyre dhe të mungesës së pasojave, pasaktësitë e konstatuara nuk cenojnë figurën e gjyqtarit dhe as besimin e publikut të drejtësia.

**66.5.** Për sa më sipër, trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj, ka arritur një nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë, sipas parashikimit të germës “a” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **B. KONTROLLI I FIGURËS**

**67.** Drejtoria e Sigurisë së Informacionit të Klasifikuar (referuar si “DSIK”) ka kryer kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, me anë të verifikimit të deklarameve dhe të të dhënave të tjera, me qëllim që të identifikonte nëse subjekti i rivlerësimit ka kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës dhe ligjit nr. 84/2016.

**67.1.** Për këtë qëllim, DSIK-ja, në përputhje me nenin 39 të ligjit nr. 84/2016, ka dërguar në Komision raportin<sup>120</sup> mbi kontrollin e figurës së subjektit të rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj, ku ka konstatuar se: (i) formulari i deklaramit është i plotë dhe i plotësuar në mënyrë të saktë dhe në përputhje me përcaktimet ligjore të ligjit nr. 84/2016; (ii) subjekti i rivlerësimit ka pasur dhe ka të njëjtat gjeneralitete si ato të deklaramura prej saj në deklaramtën për kontrollin e figurës; dhe (iii) për subjektin e rivlerësimit, nuk administrohen prova, informacione konfidenciale apo informacione të tjera, nga të cilat mund të ngrihen dyshime të arsyeshme për kontakte të papërshtatshme me persona të përfshirë në krimin e organizuar ose me persona të dyshuar të krimin të organizuar.

<sup>120</sup> Raportin nr. \*\*\* prot., datë 30.10.2017.

**67.2.** Në përfundim të veprimeve verifikuese të kryera, në përputhje me pikën 2, të nenit 39, të ligjit nr. 84/2016, DSIK-ja ka konstatuar përshtatshmërinë për vazhdimin e detyrës së subjektit të rivlerësimit, znj. Enkelejda A. Metaliaj<sup>121</sup>.

**67.3.** Komisioni kreu një hetim të pavarur për kontrollin e figurës dhe integritetit të subjektit të rivlerësimit, përfshirë këtu edhe verifikimin e informacioneve të dërguara nga agjencitë ligjzbatuese. Nga hetimi administrativ i kryer, nuk u gjetën elemente që të vërtetojnë ekzistencën e kontakteve të papërshtatshme me personat e përfshirë në krimin e organizuar apo përfshirjen e subjektit në veprimtari të kundërligjshme, sipas parimeve dhe kushteve të parashikuara në nenin DH të Aneksit të Kushtetutës.

### **Konkluzioni i Komisionit për vlerësimin e kontrollit të figurës**

**67.4.** Trupi gjykues vlerëson se subjekti i rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj, ka arritur një nivel të besueshëm në kontrollin e figurës, sipas parashikimit të germës “b” të nenit 59/1 të ligjit nr. 84/2016.

## **C. VLERËSIMI PROFESIONAL**

### **Raporti i mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor<sup>122</sup>**

**68.** Raporti për analizimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit është përgatitur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, si organi ndihmës për vlerësimin profesional, bazuar në ligjin nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” dhe në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”.

**68.1.** Hartimi i këtij raporti është bazuar në përshkrimin dhe analizimin e: 1) formularit të vetëdeklarimit, të tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, si dhe nga të dhënat dhe dokumentet e tjera që shoqërojnë formularin e vetëdeklarimit; 2) pesë dosjeve gjyqësore, të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor; dhe 3) të dhënat nga burimet arkivore të Prokurorisë së Përgjithshme.

**68.2.** Raporti ka analizuar të dhënat nga dokumentet, duke iu referuar kritereve të vlerësimit sipas ligjit nr. 96/2016, në përfundim të të cilit, ka rezultuar se subjekti:

a) për aftësinë profesionale: janë listuar disa gjetje, kryesisht që kanë të bëjnë me konstatime të natyrës procedurale, lidhur me aspekte të veçanta të gjykimit, për dosje të ndryshme të vëzhguara, megjithatë konkludohet se subjekti ka aftësi në arsyetimin ligjor dhe respekton standardin për një proces të rregullt;

b) për aftësitë organizative: ka përballuar ngarkesë mbi standardin minimal dhe i kushton rëndësi arsyetimit në kohën e duhur të vendimeve gjyqësore, duke respektuar afatet ligjore;

c) për etikën dhe angazhimin ndaj vlerave profesionale: nuk ka të dhëna negative për etikën dhe nuk ka pasur raste të konfliktit të interesit;

ç) për aftësitë personale dhe angazhimin profesional: shfaq sjellje etike, duke ruajtur paanësinë në gjykim dhe respektuar barazinë e palëve.

**68.3. Të dhëna nga burimet arkivore:** sipas të dhënave nga regjistri i ankesave, rezultojnë se gjatë periudhës trivjeçare të rivlerësimit “8 tetor 2013- 8 tetor 2016”, për gjyqtaren Enkelejda Metaliaj janë paraqitur gjithsej 13 ankesa në Inspektoratin e KLD-së (1 ankesë në vitin 2013, 2 ankesa në vitin 2014, 2 ankesa në vitin 2015 dhe 8 ankesa

<sup>121</sup> Ky raport është deklasifikuar plotësisht me vendimin e KDZH-së nr. \*\*\*, datë 12.12.2019.

<sup>122</sup> Raporti nr. \*\*\* prot., datë 13.5.2019.

për vitin 2016). 6 ankesa (1 e viti 2013 dhe 5 të vitit 2016) janë arkivuar me arsyetimin se pretendimet zgjidhen përmes apelimit gjyqësor. 2 ankesa (1 e vitit 2015 dhe 1 e vitit 2016) janë arkivuar pas shqyrtimit fillestar pasi janë ankesa të përsëritura, 2 ankesa të vitit 2016 janë arkivuar pasi janë jashtë kompetencave të KLD-së, 3 ankesa janë verifikuar dhe rezultatet janë si vijon: (a) 2 ankesa të vitit 2014 janë verifikuar bazuar në informacionin e kryetarit të gjykatës si vendime të cenuara dhe i janë regjistruar gjyqtarës për efekte të vlerësimit profesional dhe etik; (b) 1 ankesë e vitit 2015 është verifikuar për zvarritje gjykimi dhe i është regjistruar gjyqtarës për efekte të vlerësimit profesional dhe etik.

**68.4.** Sipas të dhënave të regjistrimit të procedimeve disiplinore, për gjyqtaren Enkelejda Metaliaj përgjatë periudhës së rivlerësimit nuk është regjistruar asnjë kërkesë për procedim dhe nuk është dhënë asnjë masë disiplinore.

### **Rivlerësimi i aftësive profesionale i kryer nga Komisioni**

**69.** Hetimi i Komisionit, lidhur me këtë kriter, është bazuar në verifikimin dhe analizimin e: (i) raportit për analizimin e aftësisë profesionale të mbajtur nga Këshilli i Lartë Gjyqësor; (ii) vlerësimit të denoncimeve të paraqitura dhe shqyrtimit të dokumentacionit të dërguar në ankesat e denoncuesve; (iii) kriterëve të vlerësimit të parashikuara në ligjin nr. 96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” (neni 71 e vijues i tij).

**69.1.** Komisioni, me qëllim të vlerësimit të veprimtarisë etike dhe profesionale, verifikoi dhe analizoi në mënyrë të pavarur tri dokumentet ligjore të paraqitura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjet e përzgjedhura me short, si dhe të dhënat nga burimet arkivore të ish-KLD-së.

**69.2.** Pas verifikimit të raportit për analizën e aftësive profesionale të kryer nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, tri dokumenteve ligjore të përzgjedhura nga subjekti i rivlerësimit, pesë dosjeve të përzgjedhura sipas një sistemi objektiv dhe rastësor, si dhe të dhënave nga burimet arkivore mbi të cilën është hartuar ky raport, Komisioni nuk konstatoi problematika thelbësore lidhur me vlerësimin profesional.

### **Denoncimet e publikut të depozituara në Komision**

**70.** Komisioni, administroi dhe mori në shqyrtim 27 denoncime të depozituara nga publiku, ndaj subjektit të rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj. Denoncimet ngrenë pretendime mbi procedurat e ndjekura nga subjekti gjatë proceseve gjyqësore, vendimmarrjen, korrupsionin e mundshëm etj. Pas analizimit të secilit prej tyre, dhe pas shpjegimeve të dhënave nga subjekti i rivlerësimit në lidhje me këto denoncime, pas dërgimit të rezultateve të hetimit, Komisioni arrin në përfundimin se: **a) në 6<sup>123</sup> prej tyre**, pretendimet e denoncuesve kanë të bëjnë me themelin e çështjes, që do të gjykohen nga Gjykata e Lartë dhe nuk është në kompetencë të Komisionit të shprehet në

---

<sup>123</sup> Denoncimet e paraqitura nga: A.H., ankesa nr. \*\*\* prot., datë 14.11.2017; denoncimi i shtetasit të huaj T.D., në cilësinë e përfaqësuesit ligjor i bashkimit të operatorëve ekonomik “\*\*\*\*” sh.a dhe “\*\*\*\*” sh.p.k, ankesa nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2018; denoncimet i shtetasit S.B., ankesa nr. \*\*\* prot., datë 12.6.2018; denocimi i shtetasit A.B., ankesa nr. \*\*\* prot., datë 14.5.2009; denoncimi i Drejtorisë së Përgjithshme të Parandalimit të Pastrimit të Parave, akesa e përcjellë nga DPPP-ja nr. \*\*\* prot., datë 27.12.2019; denoncimi i shtetasit A.P., dërguar Komisionit në rrugë elektronike me e-mail - në datë 1.4.2021, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 2.4.2021. dërguar 2 vendimet gjyqësore (vendimi i Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë dhe vendimi i Gjykatës Administrative të Apelit) me e-mailin e datës 6.4.2021. Dërguar të pretendime dhe të dhëna shtesë me e-mailin e datës 9.4.2021, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 12.4.2021

lidhje me në to; **b) në 13<sup>124</sup> prej tyre**, nga shqyrtimi në tërësi provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, nuk u vërejtën problematika për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit; **c) në 3<sup>125</sup> prej tyre**, lidhur me pretendimet për verifikimin e dyshimeve të ngritura për vendimmarrjen e gjyqtares bazuar në dokumente të falsifikuara apo përfshirjen e saj në korrupsion, Komisioni vlerëson se kompetencën për vërtetimin e këtyre pretendimeve e ka prokuroria si organi i vetëm që ushtron ndjekjen penale.

#### **70.1. Denoncimi i shtetasës Zh.L.<sup>126</sup>**

**70.1.1.** Denoncuesja në ankimin e saj, ndër të tjera, ka parashtruar situatën pronësore të pretenduar, si dhe hapat e ndjekur pranë Agjencisë së Trajtimit të Pronave e më tej vendimmarrjen gjyqësore të Apelit Administrativ ku dhe është drejtuar. Denoncuesja ankohet për: (i) tejkalim të kohëzgjatjes së gjykimit; (ii) zhvillim të seancës së fundit gjyqësore pa audio; dhe (iii) vendimmarrje të dhënë në shkelje të ligjit, duke qartësuar se nuk ka hequr dorë nga gjykimi sikurse është cituar në akt se *”kam dhënë pëlqimin”*.

**70.1.2.** Ajo ka depozituar fletëthirrjen gjyqësore, *CD-në* në funksion të provueshmërisë së zhvillimit të seancave me audio, si dhe vendimin gjyqësor nr. \*\*\*, datë 3.4.2018 të Gjykatës së Apelit Administrativ, Tiranë.

**70.1.3.** Nga aktet e administruara rezulton se Gjykata e Apelit Administrativ Tiranë për çështjen administrative me palë ndërgjyqëse, paditëse/denoncuesja, të paditur ATP-ja dhe Avokatura e Shtetit, me objekt: *“Ndryshim i vendimit të ATP-së”*, me vendimin nr. \*\*\*, datë 3.4.2018 ka vendosur: *“pushimin e gjykimit të çështjes me nr. \*\*\* akti, datë 9.6.2017”*.

**70.1.4.** Nga vendimi gjyqësor rezulton se çështja është mbajtur nën gjykim për rreth 10 muaj. Pra, duket se kohëzgjatja e afatit të gjykimit është përtej afatit 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, germa *“e”* të Aneksit \*\*\* të Sistemit të Vlerësimit<sup>127</sup>. Gjithashtu, në vendim përshkruhet edhe veçimi i kërkit të tretë të përcaktuar në padi, ndërkohë, referuar po vendimmarrjes, nuk rezulton të jetë cituar trajtimi i një pasurie të ndodhur jashtë kompetencës tokësore. Megjithatë, ky veçim konfirmohet me vendimin e datës 16.10.2017 (cituar po në vendimin nr. \*\*\*, datë 3.4.2018).

---

<sup>124</sup> Denoncimet e paraqitur nga: E.M., ankesat me nr. \*\*\* prot., datë 8.2.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 22.1.2019; denoncimi i shtetasit Sh.H., ankesa nr. \*\*\* prot., datë 30.7.2018; denoncimet e shtetasit S.T., ankesa nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2019; ankesa nr. \*\*\* prot., datë 22.5.2019 dhe; 2 ankesa të depozituara në KPA dhe të përcjella në Komisionin, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 6.12.2019 dhe nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2020; denocimi i shtetasit J.I., ankesa nr. \*\*\* prot., datë 31.10.2019; denocimi i shtetasës S.T., ankesa nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2019; denoncimi i A.K.U. (AKUSH), ankesa e përcjellë nga KPA, protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 28.10.2019; denoncimi i shtetasit V.L., ankesa e përcjellë nga Institucioni i Komisionerëve Publikë, protokolluar në Komisionin, me nr. \*\*\* prot., datë 26.12.2019; denoncim i shtetasit Z.J. dhe denoncimi i shtetasit I.S., ankesa nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2020; ankesa nr. \*\*\* prot., datë 13.1.2020; denoncimi i shtetasit G.S., ankesa nr. 2556 prot., datë 8.4.2020; denoncimi i paraqitur nga Manushaqe Hysenaj, ankesa nr. 2487 prot., datë 29.12.2017; denoncimi i bërë nga Drejtoria - Kantieri i Ndërtimit dhe Riparimit të Anijeve, përfaqësuar nga drejtori z. A.G., ankesa nr. \*\*\* prot., datë 15.1.2018; denoncimi i shtetasit A.J., ankesa nr. \*\*\* prot., datë 16.1.2018; denoncimi i shtetasit K.D./M.T. (D.), ankesa nr. \*\*\* prot., datë 18.1.2018

<sup>125</sup> Denoncimi i shtetasit M.P., si përfaqësues me prokurë i shtetasës O.P., ankesa nr. \*\*\* prot., datë 19.4.2018; denoncimet e shtetasit V.V. si përfaqësues i shoqërisë *“\*\*\*\*”* sh.p.k, ankesa nr. \*\*\* prot., datë 20.11.2017; nr. \*\*\* prot., datë 6.3.2018 dhe; nr. \*\*\* prot., datë 28.2.2019; denoncimet e shtetasve I.Sh., L.F. dhe A.P., ankesa nr. \*\*\* prot., datë 4.5.2018 dhe nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2019.

<sup>126</sup> Ankesa nr. \*\*\* prot., datë 2.11.2018.

<sup>127</sup> Sistemi i Vlerësimit përmbledh vendimin nr. \*\*\*, datë 14.4.2010 të KLD-së *“Sistemi i Vlerësimit të Gjyqtarëve”*, së bashku me Aneksin i *“Kriteret matëse të veprimtarisë gjyqësore”*.

**70.1.5.** Për sa më sipër, me dërgimin e rezultateve të hetimit, subjektit iu kërkuan shpjegime dhe të provonte me dokumente justifikuese veprimet e kryera në procesin gjyqësor, objekt denoncimi, për sa vijon:

- i. duke qenë se çështja gjyqësore ka zgjatur për rreth 10 muaj, iu kërkua subjektit të japi shpjegimet e saj, duke u përqendruar te provueshmëria e kohëzgjatjes së zhvillimit të procesit gjyqësor, pasi shihet se në vendimin nr. \*\*\*, datë 3.4.2018, pasqyrohen disa veprime procedurale, të cilat nuk qartësohen plotësisht, pra, nuk kuptohet kronologjia e veprimeve procedurale të kryera në kohë, p.sh., lidhur me kthimin për marrjen e masave për plotësimin e të metave, kohën që ka zgjatur përmbushja e këtij detyrimi, etj;
- ii. të qartësojë lidhur me arsyetimin e bërë për veçimin e njëjës prej kërkesave që sipas arsyesimit në vendim, ai i përket pikës së tretë të objektit të kërkimit gjyqësor, krahasuar me paqyrimin e objektit në vendimin nr. \*\*\*, duke mbajtur në vëmendje që vendimmarrja e kompetencës nga pikëpamja lëndore dhe tokësore rakordon pikërisht me datën e caktimit të seancës përgatitore, e cila sipas arsyesimit të vendimit nuk është zhvilluar, për shkak të mospagimit të taksës gjyqësore;
- iii. të qartësojë lidhur me zhvillimin e seancave gjyqësore me audio, duke mbajtur në vëmendje arsyet në rastet e mosezaurimit me audio (nëse ka pasur të tilla);
- iv. të depozitojë dokumentacion mbështetës lidhur me ezaurimin e kërkesës së palës paditëse për heqje dorë nga gjykimi i çështjes, si edhe të qartësojë se cili është statusi aktual i çështjes gjyqësore, të përfunduar prej saj me vendimmarrjen e pushimit të gjykimit.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit mbi këtë denoncim**

**70.1.6.** Me dërgimin e prapësimeve pas rezultateve të hetimit, lidhur me pretendimet e ngritura në këtë denoncim, gjetjet dhe kërkesat e bëra nga Komisioni, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar sa vijon:

- i. Nga investigimi i dosjes gjyqësore që ndodhet pranë Gjykatës së Lartë ka rezultuar se, shtetasja Zh.L. i është drejtuar Gjykatës Administrative të Apelit me ankim protokolluar në sekretarinë e gjykatës me nr. \*\*\* prot., datë 8.6.2017<sup>128</sup>.
- ii. Më **19.6.2017**, gjykata i është drejtuar palës ankuese Zh.L. me vendimin e ndërmjetëm për plotësimin e të metave të padisë, për pagimin e taksës, si dhe paraqitjen e padisë në kushtet formale të asaj, pasi është në formën e ankesës dhe jo kërkesëpadisë.
- iii. Sipas dëftesës së komunikimit, paditësja ka marrë dijeni më **29.6.2017**, komunikuar nëpërmjet shërbimit postar. Duhet sqaruar se, procesverbali administrativ për njoftimin nëpërmjet telefonit, i ndodhur në njoftimet e dosjes është një gabim material, pasi ka të dhëna të një pale tjetër ndërgjyqëse, e cila nuk ka lidhje me çështjen objekt gjykimi.
- iv. Paditësja ka plotësuar të metat e padisë më **5.7.2017**, duke depozituar në sekretarinë e gjykatës kërkesë padinë në kushtet formale të saj.
- v. Më **13.7.2017** me vendimin për njoftimin e kërkesë padisë i janë komunikuar aktet palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit. Dëftesat e komunikimit vërtetojnë komunikimin e akteve, sipas vulës së protokollit të institucioneve më datë 14.7.2017.

<sup>128</sup> Ka depozituar si prova: (i) kopje të vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë Tiranë nr. \*\*\*, datë 27.9.2005 për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të nënës Sh.L.; (ii) kopje të vendimit të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Tiranë nr. \*\*\*, datë 14.9.2007, për lëshimin e dëshmisë së trashëgimisë të babait M.L.

- vi. I është lënë koha e nevojshme palës së paditur dhe Avokaturës së Shtetit të paraqesin provat e tyre shkresore dhe prapësimet e tyre në lidhje me padinë, duke mbajtur në konsideratë dhe pushimet vjetore të cilat bëhen në muajin gusht.
- vii. Më **7.9.2017**, janë verifikuar aktet dhe ka rezultuar se mungonte akti në lidhje me vlerësimin e pronës së palës paditëse (vendimi datë 10.5.2017 i ATP-së) dhe është marrë vendimi i ndërmjetëm për plotësimin e të metave të padisë. Pala paditëse ka marrë dijeni për këtë vendim më **19.9.2017** dhe ka depozituar një kërkesë më **20.9.2017**, duke deklaruar se nuk e dispononte këtë vendim, dhe se i ishte drejtuar ATP-së për vënien në dispozicion të dokumentacionit të nevojshëm.
- viii. Më **2.10.2017** është caktuar seanca e parë e veprimit përgatitor. Provat e kërkuara me vendimin e ndërmjetëm 19.9.2017 i ka paraqitur në seancë pala e paditur. Është shtyrë për t'u paguar taksa gjyqësore, dhe t'i jepej mundësia të mbrohet pala paditëse me avokat.
- ix. Më **16.10.2017** seanca e radhës së veprimit përgatitor është mbajtur **pa audio**, kjo për shkak të problemeve me sistemin e regjistrimit audio në sallën nr. 3 të gjykatës, që në mëngjesin e datës 16.10.2017<sup>129</sup>. Sallat e tjera nr. \*\*\* dhe nr. \*\*\* kanë qenë të zëna në orarin e planifikuar për t'u zhvilluar seanca e veprimit përgatitor. Por, procesverbali i kësaj date është mbajtur në sistemin I\*\*\* (sistemin e brendshëm).
- x. Në këtë seancë, sipas deklaratës së paditëses, pasi janë plotësuar të gjitha të metat e padisë, gjyqtarja ka marrë vendimin e ndërmjetëm për veçimin e pikës së tretë të padisë dhe dërgimin e akteve në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Pogradec.
- xi. Vendimi i ndërmjetëm është marrë në prani të palës paditëse (ankuese), fakt që vëretohet me firmosjen e marrjes dijeni për seancën e radhës nga vetë Zh.L., akt i bashkëlidhur procesverbalit të datës 16.10.2017. Vendimi është arsyetuar më 18.10.2017. Vendimi i ka kaluar sekretares gjyqësore dhe është sekretaria që vijon me komunikimin e akteve të dosjes sipas përcaktimeve në vendim<sup>130</sup>.
- xii. Më pas, dy seancat e radhës përgatitore, datë 30.10.2017 (nuk është paraqitur në detyrë për arsye shëndetësore), dhe datë 20.11.2017 (ka patur rast vdekjeje), janë shtyrë për shkak të mosformimit të trupit gjykues.
- xiii. Në seancën e radhës përgatitore, më 19.12.2017, pasi janë ezauruar të gjitha veprimet që kryhen, gjykata ka marrë vendimin për kalimin e çështjes në seancë gjyqësore.
- xiv. Seanca gjyqësore e datës 23.1.2018 është shtyrë, sepse paditësja ka kërkuar që të jetë prezent ATP-ja në gjykim.
- xv. Në seancën gjyqësore të datës 13.2.2018, janë marrë për shqyrtim provat dhe është shtyrë seanca për t'u thirrur në gjykim ATP-ja, konform nenit 182 të K.Pr.Civile<sup>131</sup>.
- xvi. Në seancën gjyqësore të datës 13.3.2018, ATP-ja nuk paraqitet, edhe pas shkresës për paraqitje në gjykim konform nenit 182 të K.Pr.Civile, gjykata urdhëron përsëritjen e njoftimit<sup>132</sup>.

<sup>129</sup> Ka depozituar si provë kalendarin për datën 03.04.2018 të çështjeve të planifikuara si relatores dhe si anëtare, për veprime përgatitore të planifikuara që prej orës 10:30 të asaj dite.

<sup>130</sup> Bashkëlidhur, ka paraqitur si provë (i) komunikimin e bërë me e-mail me ndihmësen ligjore M.N., ku duket se është dërguar prej saj vendimi i ndërmjetëm në lidhje me veçimin e pikës 3, të objektit të padisë, dhe (ii) vendimin e datës 16.10.2017.

<sup>131</sup> Ka depozituar si provë shkresën e njoftim për paraqitje në gjykim – bashkëlidhur saj dëftesën e komunikimit.

xvii. Seanca gjyqësore më 3.4.2018, është zhvilluar, pala e paditur është paraqitur pas zvarritjes së procesit në 3 seanca. Përfaqësuesi i palës së paditur ka pohuar gjatë gjykimit se nuk ka një vlerësim financiar për pronën e paditëses, nuk i është trajtuar prona. Po kështu nga shpjegimet e mëtejshme të palës së paditur ndër të tjera, citohet se ... “ *palës paditëse i është njohur e drejta e parablerjes. Nëse pala nuk heq dorë nga kjo e drejtë nuk mund t’i njihet e drejtë kompesimi. Në rastin konkret ATP-ja pretendon se ka bërë publikim vendimesh ku kolona e fundit është bosh, nuk është as ezauruar dhe as kompesuar, pra kishim një padi pa objekt. Është një rast, e para s’ka konflikt. E dyta, nëse nuk heq dorë dhe rrezohet padia. I bie se nesër nëse do të ketë një vlerë mos të ketë të drejtë më ta hapi.* ”

**70.1.7.** Si rrjedhojë - sqaron subjekti, është pyetur paditësja e cila sipas procesverbalit të kësaj date ka deklaruar: “*Si të jetë më e mira. Unë nuk kam dëshirë. Në qoftë se është me ligj jam dakort të heqë dorë*”. Referuar edhe regjistrimit audio, vetë paditësja ka deklaruar në seancë se është dakord të heqi dorë nga padia e ngritur.

Në këto kushte, Kolegji i Gjykatës Administrative të Apelit ka disponuar sipas nenit 39/3 të ligjit nr. 49/2012, me pushimin e gjykimit të kësaj çështjeje.

**70.1.8.** Subjekti ka sqaruar se, gjatë seancës së fundit në audio është bërë lapsus, gjykata është shprehur në mënyrë të gabuar kur ka thënë se ka shpallur moskompetencën për pikën 2 dhe 3 të padisë, kjo për shkak të ngarkesës që ka pasur<sup>133</sup>, e për këtë vendim, vendimin e datës 16.10.2017 të gjyqtarit të vetëm, paditësja ka qenë prezent në sallë, gjykimi për këtë datë është zhvilluar me audio, e që në datën 18.10.2017 (maksimumi në datën 19.10.2017) ajo si gjytare ka arsyetuar këtë vendim, i cili ka qenë në formën e kërkuar nga ligji, kjo për faktin se në po në atë seancë gjyqësore paditësja ka kërkuar që të njihet me vendimin e veçimit, e më pas të vijojë më tej gjykimin<sup>134</sup>.

**70.1.9.** Në vijim subjekti shpjegon se, gjykata ka shpallur moskompetencën për pikën 3 të padisë - fakt i vërtetuar me vendimin e arsyetuar të datës 16.10.2017. Po kështu, në dijeninë e saj paditësja është pajisur dhe me një kopje të CD-së së zhvillimit të të gjitha seancave gjyqësore, sipas nenit 118/1 të K.Pr.Civile dhe nenit 1/2 të ligjit 49/2012, i ndryshuar. Po kështu, në arsyetimin e vendimit jo përfundimtar “Për pushimin e gjykimit”, Gjykata Administrative e Apelit, dhe ajo si relatore, e cila në bazë të ligjit ka detyrën e arsyetimit të vendimit, ndër të tjera, ka cituar se është pushuar gjykimi për pikën 1, dhe 2 të objektit të saj, sikundër është disponuar dhe në dispozitivin e vendimit<sup>135</sup>.

**70.1.10.** Në lidhje me kohëzgjatjen e afatit të gjykimit përtej përtej afatit 6-mujor të përcaktuar nga pika 5, germa “e” të Aneksit 1 të Sistemit të Vlerësimit, subjekti argumenton se vjen si rezultat i zbatimit me përpikmëri të ligjit nr. 49/2012, i ndryshuar, duke i dhënë mundësinë palës paditëse të ndjekë të gjithë hapat proceduralë në respektim të nenit 6 të KEDNJ, sikundër pasqyrohet në kronologjinë e fakteve, si edhe duke i dhënë mundësi paditëses të përfaqësohet me të gjitha mjetet procedurale.

**70.1.11.** 2 seanca gjyqësore janë jo produktive në lidhje me mungesën e saj si relatore e çështjes por duhet të mbahet parasysh ngarkesa e Gjykatës Administrative të Apelit, konkretisht ngarkesa e saj si gjyqtare relatore, por dhe si pjesëmarrëse në trupa gjykues,

<sup>132</sup> depozituar si provë shkresën e njoftim për paraqitje në gjykim – bashkëlidhur saj dëftesën e komunikimit.

<sup>133</sup> Ka depozituar si provë kalendarin për datën 3.4.2018, të çështjeve të planifikuara si relatore dhe si anëtare.

<sup>134</sup> Ka depozituar kopje të procesverbalit gjyqësor.

<sup>135</sup> Subjekti ka depozituar si provë CD-audio, për senacat e zhvilluara që i përkasin çështjes objekt ankimi.

që sipas shkresës<sup>136</sup> së datës 5.8.2021, me nr. \*\*\* prot., lëshuar nga Gjykata Administrative e Apelit - për vitin 2017 ka përfunduar 676 çështje, ndërsa nga data 9.6.2017 kur është regjistruar çështja e denoncueses në fjalë, e deri datë 3.4.2018 kur është shpallur vendimi, ka gjykuar si relatores 540 çështje themeli.

**70.1.12.** Subjekti ka sqaruar se, statusi aktual i çështjes gjyqësore të përfunduar me vendimmarrjen e pushimit të gjykimit është mbyllur, bashkëlidhur faqja e printuar e sistemit *ICMIS*, që tregon statusin e çështjes “*mbyllur*”. Pala paditëse (ankuese) ka ushtruar të drejtën e rekursit sikundër provohet dhe me vendimin e pranimit të rekursit datë 9.5.2018, të marrë prej saj si subjekt rivlerësimi<sup>137</sup>, dhe se çështja aktualisht çështja ndodhet në Gjykatën e Lartë<sup>138</sup>.

**70.1.13.** Si përfundim, subjekti argumenton se pretendimet e palës paditëse (denoncueses) kanë lidhje me themelin e çështjes, për të cilat do të shprehet një gjykatë më e lartë.

### **Vlerësimi përfundimtar i Komisionit lidhur me këtë denoncim**

**70.1.14.** Komisioni, pasi vlerësoi me objektivitet shpjegimet dhe provat e depozituara lidhur me çështjen objekt denoncimi, çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në nivel ligjor dhe në mënyrë bindëse mbi gjetjet e evidentuara dhe pretendimet e ngritura në këtë denoncim, dhe se nuk konstatohen problematika thelbësore, të cilat do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale.

### **70.2. Denoncimi i shtetasit B.Xh.<sup>139</sup>**

**70.2.1.** Denoncohet trupi gjykues i Gjykatës Administrative e Apelit (pjesë e së cilës është dhe gjyqtarja Metaliaj) për tjetërsim të objektit të padisë. Denoncuesi pretendon se, ai nuk i është drejtuar gjykatës me objekt: “Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ «Urdhër nr. \*\*\*, datë 2.9.2015, nr. \*\*\* prot.,»”, por ka kërkuar “Pavlefshmërinë absolute...etj”. Gjithashtu, ai pretendon se trupi gjykues nuk i është referuar ankimit të depozituar prej tij në gjykatë, pra, nuk janë shprehur për asnjë pikë të ankimit të bërë prej tij.

**70.2.2.** Bashkëlidhur denoncimit denoncuesi ka depozituar: (i) kopje të kërkesëpadisë drejtuar Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë; (ii) vendimin e Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, i cili duket se është printuar nga faqja zyrtare e kësaj gjykate si edhe; (iii) vendimin e Gjykatës Administrative të Apelit.

**50.2.3.** Nga verifikimi i dokumentacionit bashkëlidhur denoncimit rezulton se:

- i. referuar kërkesëpadisë objekti i saj është: (1) pavlefshmëria absolute e aktit administrativ “Urdhër nr. \*\*\*, datë 2.9.2015, nr. \*\*\* prot.,” lëshuar nga Bashkia Fier dhe veprimeve të mëtejshme të Bashkisë Fier dhe Inspektoratit të Mbrojtjes së Territorit Bashkia Fier; (2) dëmshpërblimin për dëmin e shkaktuar si rezultat i ekzekutimit të “Urdhrit nr. \*\*\*, datë 2.9.2015, nr. \*\*\* prot.,” për ndërtesën e banimit me sipërfaqe 100 m<sup>2</sup>; (3) dëmshpërblimin për qiranë e paguar për shkak të prishjes së shtëpisë; (4) dëmshpërblim për prishjen e murit rrethues të pronës së paditësit; (5) pavlefshmërinë e pjesshme të aktit administrativ “Vendim nr. \*\*\*, datë 16.9.2015 të Këshillit Bashkiak Fier;
- ii. referuar vendimit të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë objekti i padisë është: “Pavlefshmëria absolute e aktit administrativ, urdhrin nr. \*\*\*, datë 2.9.2015, nr. \*\*\* prot.,” lëshuar nga Bashkia Fier;

<sup>136</sup> Depozituar si provë me dërgimin e prapësimeve.

<sup>137</sup> Bashkëlidhur ka depozituar si provë kopje të rekursit.

<sup>138</sup> Ka depozituar si provë fletën e printuar nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, ku pasqyrohen të dhënat lidhur me çështjen objek denoncimi dhe statusi i saj.

<sup>139</sup> Ankesa nr. \*\*\* prot., datë 17.12.2018.



iii. referuar vendimit të Gjykatës së Apelit Administrativ objekti padisë është: shfuqizimi tërësisht i aktit administrativ, urdhrit nr. \*\*\*, datë 2.9.2015, nr. \*\*\* prot.,” lëshuar nga Bashkia Fier.

**70.2.4.** Për sa më sipër, Komisioni i kërkoi subjektit shpjegime, duke u përqendruar tek argumentet që kanë sjellë si pasojë ndryshimin e objektit të padisë nga: i) ai i përcaktuar në vendimin gjyqësor të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, “*Pavlefshmëri absolute e aktit administrativ të urdhrit nr. \*\*\*, datë 2.9.2015*, (për të cilin ka arsyetuar, madje edhe për dëmin e shkaktuar) dhe ii) objekti i përcaktuar në vendimmarrjen e Apelit Administrativ me nr. \*\*\*, datë 15.11.2018, “*Shfuqizim tërësisht i këtij akti administrativ*”, si dhe objekti i përcaktuar në kërkesë padinë e paditësit.

**70.2.5.** Nëpërmjet prapësimeve të dërguara pas rezultateve të hetimit, lidhur me çështjen objekt denoncimi dhe shpjegimet e kërkuara nga Komisioni pas trajtimit të saj, subjekti i rivlerësimit ka parashtruar se në Gjykatën e Apelit regjistrohet çështja administrative mbi bazën e ankimit ndaj vendimit të shkallës së parë, dhe referuar vendimit nr. \*\*\*, datë 6.4.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë objekti është: “*Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ “Urdhër nr. \*\*\*, datë 02.09.2015 nr.\*\*\* prot.” lëshuar nga Bashkia Fier*”<sup>140</sup>.

**70.2.6.** Subjekti parashtron se, nëse pala konstatonte gabim, duhet t’i drejtohej gjykatës së shkallës së parë me një kërkesë për ndreqje gabimi material.

**70.2.7.** Sipas praktikës RIV objekti i padisë së regjistruar në sistem është: “*Shfuqizimin tërësisht të aktit administrative “Urdhër nr. \*\*\*, datë 02.09.2015 nr.\*\*\* prot.” lëshuar nga Bashkia Fier*”<sup>141</sup>.

**70.2.8.** Në këtë kuptim, subjekti argumenton se pala ka kërkuar pavlefshmërinë relative, e konform nenit 18 të ligjit 49/2012, i ndryshuar, Kolegji me të drejtë i ka hyrë afatit të parashkrimit të padisë. Kjo për shkak se, siç arsyetohet në vendim: “rezulton se pala e paditur Bashkia Fier ka disponuar me urdhrin objekt gjykimi nr. \*\*\*, datë 2.9.2015, ndërkohë që padia është paraqitur në Gjykatën Administrative të Shkallës së Parë Vlorë më 24.12.2015, pra, dukshëm jashtë afatit 45-ditor të përcaktuar në nenin 18 të ligjit nr. 49/2012. Sa më sipër, në këto kushte kur kërkesëpadia rezulton të jetë paraqitur në gjykatë jashtë afatit, Gjykata e Shkallës së Parë Vlorë duhet të kishte disponuar me mospranimin e padisë. Kjo në referim të asaj sa parashikuar në nenin 18 dhe 39 të ligjit nr. 49/2012. Ligji nr. 49/2012 komplementohet për aq sa nuk gjen rregull në të me dispozita të Kodit të Procedurës Civile, i cili në nenin 468 të tij përcakton se *Gjykata e Apelit kur konstaton se çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si dhe kur padia nuk mund të ngrihej ose gjykimi nuk mund të vazhdonte, prish vendimin dhe vendos vetë pushimin e gjykimit të çështjes.*

**70.2.9.** Pra, rasti konkret objekt gjykimi ka të bëjë me situatën kur gjykimi nuk mund të vazhdojë dhe çështja duhet të pushohet, pasi kërkimet e parashtruara në objektin e padisë janë paraqitur jashtë afatit 45-ditor, të parashikuar në ligjin nr. 49/2012. Neni 50/d i ligjit nr. 49/2012 ka përcaktuar se Gjykata Administrative e Apelit në dhomën e këshillimit vendos d) prishjen e vendimit dhe pushimin e gjykimit të çështjes, kur çështja nuk hyn në juridiksionin gjyqësor, si dhe kur padia nuk mund të ngrihej ose gjykimi nuk mund të vazhdonte<sup>142</sup>.

<sup>140</sup> Ka depozituar si provë kopje të vendimit nr. \*\*\*, datë 6.4.2016, të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë.

<sup>141</sup> Ka depozituar si dokumentacion provues – bashkëlidhur prapësimeve, praktikën RIV të çështjes.

<sup>142</sup> Ka depozituar si provë, kopje të vendimit nr. \*\*\* datë 15.11.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**70.2.10.** Gjithashtu, subjekti ka informuar se pala ka ushtruar të drejtën e rekursit dhe çështja ndodhet në Gjykatën e Lartë, në këto kushte do të shprehet një gjykatë më e lartë në lidhje me themelin e kësaj çështjeje<sup>143</sup>.

### **Vlerësimi/Analiza e fakteve i/e kryer nga Komisionit lidhur me këtë denoncim**

**70.2.11.** Komisioni vëren se vendimi i datës 6.4.2016 dërguar si provë nga denoncuesi lidhur me gjykimin në shkallë të parë, në të cilin referohet se objekti i padisë është: *“Pavlefshmëri absolute e aktit administrativ të Urdhrit nr. \*\*\*, datë 2.9.2015, lëshuar nga Bashkia Fier”*, përfaqëson ekstrakt të vendimit printuar nga sistemi, i cili nuk ka vlerë ligjore.

**70.2.12.** Ndërkohë, referuar kopjes së vendimit (të njësuar me origjinalin) nr. \*\*\*, datë 6.4.2016 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Vlorë, që lidhet me çështjen objekt denoncimi (depozituar si provë nga subjekti), konstatohet se objekti i padisë është: *“Shfuqizimin tërësisht të aktit administrativ të Urdhrit nr. \*\*\*, datë 2.9.2015, lëshuar nga Bashkia Fier”*.

**70.2.13.** Sa më sipër, Komisioni çmon se subjekti ka argumentuar dhe arsyetuar në nivel ligjor dhe në mënyrë bindëse mbi faktet e pretenduara në këtë denoncim. Gjithsesi, Komisioni vlerëson se pretendimet e denoncuesit, të cilat në dukje janë të natyrës procedurale, që lidhen me ndryshimin e objektit të padisë, do të gjejnë zgjidhje së bashku me shqyrimin e çështjes në themel nga Gjykata e Lartë.

### **70.3. Denoncimi i avokatit, z. P.P.<sup>144</sup>**

**70.3.1.** Denoncuesi ankohet ndaj trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit (pjesë e të cilit është edhe gjyqtarja Metaliaj) duke pretenduar se nga ana e kësaj trupe gjyquese ka pasur shkelje procedurale në dhënien e vendimit.

**70.3.2.** Nga analizimi i vendimit nr. \*\*\*, datë 14.02.2018 rezulton se, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë ka pranuar padinë e znj. A.P., e cila përfaqësohej nga av. P.P. Ndërsa, Gjykata Administrative Apelit ka rrëzuar padinë, ndër të tjera, duke argumentuar se: *“Në interpretim të praktikës gjyqësore të unifikuar në vendimin nr.3, datë 30.1.2003 të Kolegjeve të Bashkuara, i cili ka përcaktuar se nuk mund të jetë objekt shqyrtimi gjyqësor ligjshmëria e dekretit të Presidentit...në aspektin procedural nuk legjitimohet si i paditur Presidenti i Republikës që ka nxjerrë dekretin, por Prokurori i Përgjithshëm...Gjykata administrative e Apelit çmon se dekretet e Presidentit janë akte të natyrës juridiko- kushtetuese.”*

**70.3.3.** Ky vendimi unifikues rezulton të jetë shfuqizuar me vendimin nr. 23.12.2003 të Gjykatës Kushtetuese, e cila arsyeton si më poshtë në lidhje me këtë vendim: *“Kolegjet e Bashkurara kanë vendosur pushimin e gjykimit duke arsyetuar se dekretet e Presidentit të Republikës, duke përfshirë edhe ato të largimit apo transferimit nga detyra të prokurorëve, nuk mund të kundërshtohen në gjykatë pasi ato janë të natyrës juridiko-kushtetuese dhe jo akte administrative.*

**70.3.4.** Gjykata Kushtetuese konstaton se, vendimi i Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë është rrjedhojë e një procesi jo të rregullt ligjor në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës, sepse i ka mohuar prokurorëve të drejtën e ankimit në gjykatë ndaj dekretëve të Presidentit. Kolegjet e Bashkuara i konsiderojnë aktet e Presidentit për largime nga puna, si akte me karakter juridiko-kushtetues e jo administrativ. Ky arsyetim është në kundërshtim me frymën e përmbajtjen e legjislacionit, me jurisprudencën kushtetuese e doktrinën e së drejtës administrative... Nga përmbajtja

<sup>143</sup> Ka depozituar si provë fletën e printuar nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, ku pasqyrohen të dhënat lidhur me çështjen objekt denoncimi dhe statusi i saj.

<sup>144</sup> Ankesa nr. \*\*\* prot., datë 8.4.2019.

*dhe fryma e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, del se veprimtaria e Presidentit të Republikës si kryetar shteti, ka elemente të të tri pushteteve; legjislativ, ekzekutiv e gjyqësor. Për këtë arsye ai ka kompetencë të nxjerrë si akte që janë shprehje e drejtimit politik, ashtu edhe akte (dekrete) individuale që për nga natyra e tyre, afrojnë më shumë me veprimtarinë ekzekutive urdhërdhënëse të administratës shtetërore. Në aktet me karakter administrativ përfshihen edhe dekretet për emërimin dhe shkarkimin nga detyra të prokurorëve, që mund të cenojnë të drejtat juridiko-civile të prokurorit. Duke pasur të tilla cilësi dekreti, ashtu siç është shprehur Gjykata Kushtetuese në vendimin nr. 25, datë 13.02.2002, duhet të jetë objekt i ankimit dhe i shqyrtimit gjyqësor.”*

**70.3.5.** Për sa më sipër, rezulton se Gjykata Administrative e Apelit (në përbërje të së cilës është edhe gjyqtarja Metaliaj – në cilësinë e anëtares) në vendimin e dhënë për çështjen objekt ankimi është bazuar në një vendim të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, i cili rezulton të jetë i shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese.

**70.3.6.** Për sa më sipër, subjekti pretendon se nuk mund të mbajë përgjegjësi për mënyrën e parashtrimit të fakteve dhe arsyetimin e kryetarit të seancës, duke sqaruar se sigurisht që do të ishte ideale që të lexoheshin edhe arsyetimet e kolegëve para se të firmosen, por kjo është e pamundur efektivisht, duke ditur botërisht ngarkesën e madhe të punës që ka Gjykata Administrative e Apelit.

**70.3.7.** Komisioni, pasi analizoi shpjegimet e subjektit, konstaton se nuk justifikojnë faktin se gjykata është mbështetur në një vendim të Kolegjeve të Bashkuara, i cili rezulton të jetë i shfuqizuar nga Gjykata Kushtetuese. Por, në vlerësim të gjithë rrethanave, Komisioni mban në vëmendje pozitën e subjektit si anëtare e trupit gjykues, si dhe ngarkesën e lartë në këtë gjykatë, dhe në këtë kuptim, ky rast, i cili duket se përbën rast të veçuar dhe jo rregull në standardin e gjykimit të subjektit të rivlerësimit, nuk do merret në konsideratë gjatë vlerësimit përfundimtar.

#### **70.4. Denoncimi i shtetasit F.B.<sup>145</sup>**

**70.4.1.** Denoncohet gjyqtarja Metaliaj për paaftësi profesionale lidhur me vendimin e dhënë prej saj në cilësinë e kryesueses së trupit gjykues të Gjykatës Administrative të Apelit (vendimi nr. \*\*\*, datë 5.9.2017).

**70.4.2.** Denoncuesi pretendon se ky vendim është pasojë e cenimit të ligjit procedural, pasi gjykata në kundërshtim me nenin 310, pika 6, të K.Pr.Civile ka ndryshuar objektin e padisë si edhe, në kundërshtim me nenin 310, pika 4, të K.Pr.Civile, ka ndryshuar palët ndërgjyqëse.

**70.4.3.** Denoncuesi pretendon vendimi nr. \*\*\*, datë 5.9.2017 është vendim jo i drejtë dhe i marrë në zbatim të gabuar të ligjit material dhe procedural, pasi sipas tij vendimi ka qenë i njëanshëm dhe nuk bazohet në faktet dhe provat e pasqyruara gjatë procesit gjyqësor, provat nuk janë analizuar me objektivitet dhe nuk janë vlerësuar me paanshmëri, gjykata nuk ka bërë një cilësim të drejtë të fakteve të provuara gjatë procesit gjyqësor dhe se, nuk ka pasqyruar saktë objektin e padisë si dhe palët ndërgjyqëse (evidentuar si më sipër).

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit mbi këtë denoncim**

**70.4.4.** Në lidhje me pretendimet e ngritura në këtë denoncim, me prapësimet e dërguara pas rezultateve të hetimiti, subjekti i rivlerësimit ka shpjeguar se:

- i. **Së pari**, në lidhje me pretendimin se Gjykata ka ndryshuar objektin e padisë, subjekti argumenton se ky fakt nuk është aspak i vërtetë, pasi gjykata mbi bazën e ankimit dhe të palës paditëse ka shqyrtuar ligjshmërinë e vendimit të Gjykatës

<sup>145</sup> Ankesa nr. \*\*\* prot., datë 28.8.2019.

Administrative të Shkallës së Parë Tiranë me nr. \*\*\*, datë 18.12.2014, ku ka disponuar me “Rrëzimin e padisë së paditësit”;

- ii. Referuar akteve të kësaj dosje objekti i shqyrtimit të saj është: “Shpërblim i dëmit të shkaktuar për sipërfaqe prej 5,600 m<sup>2</sup>, si dhe humbjet e fituara dhe fitimi i munguar”. Nga procesverbali gjyqësor, rezulton se në asnjë rresht të tij nuk është ndryshuar objekti i padisë, sikundër pretendon ankuesi, por është shqyrtuar ligjshmëria e vendimit të gjykatës së shkallës së parë duke u riçelur shqyrtimi gjyqësor pjesërisht dhe është thirrur edhe ekspertja e marrë gjatë gjykimit në shkallë të parë. Po kështu, sqaron se ndryshimi i objektit të padisë sipas nenit 185 të K.Pr.Civile, bëhet vetëm gjatë gjykimit në shkallë të parë dhe jo në shkallë të dytë (përveç rasteve kur gjykata e apelit ka juridiksion fillestar).
- iii. **Së dyti**, në lidhje me pretendimin për ndryshimin e palëve ndërgjyqëse, sqaron se në kokën e vendimit gjyqësor është bërë një lapsus (gabim njerësor), në lidhje me palën e paditur që është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, e cila nuk është vënë në vendim gjyqësor, gabim për të cilin deklaroi se në momentin që u evidentua nga ana e saj, do të ndreqej kryesisht nga trupi gjykues, sipas kushteve të parashikuara nga neni 312 i Kodit të Procedurës Civile.
- iv. Por, pavarësisht këtij gabimi njërësor në vendim, referuar procesverbalit gjyqësor është respektuar neni 6 i KEDNJ-së në lidhje me këtë palë, duke e njoftuar për seancën gjyqësore në Gjykatën e Apelit, duke u marrë dhe vendimi i gjykimit në mungesë, sipas nenit 34/2 të ligjit 49/2012, i ndryshuar, në kushtet që kishte dijeni për gjykimit dhe pa ndonjë shkak të arsyeshëm nuk ishte paraqitur në gjykatë për ditën dhe orën e gjykimit<sup>146</sup>. Gjithashtu, subjekti informon se kjo palë është e pasqyruar në RIV, në dosjen kur është regjistruar dosja në Gjykatën e Apelit.
- v. **Së treti**, në lidhje me pretendimet e tjera të denoncuesit, subjekti argumenton se ato kanë lidhje me themelin e çështjes, dhe në kushtet kur denoncuesi ka ushtruar rekurs, ato janë objekt shqyrtimi në Gjykatën e Lartë<sup>147</sup>.

### Vlerësimi i Komisionit

**70.4.5.** Nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimi, provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, Komisioni nuk vërejtí problematika thelbësore për gjetje që do të ndikonin në vlerësimin e aftësive profesionale të subjektit të rivlerësimit. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit lidhur me këtë denoncim janë bindëse dhe të mbështetura në dokumentacion provues.

### 70.5. Denoncimi i shtetases E.N.<sup>148</sup>

**70.5.1. Rrethanat e denoncimit:** Në ankesën e paraqitur, ndër të tjera denoncuesja ka sqaruar se është përfaqësuese e familjes N., pronare e një trualli në Tiranë, e cila ndër vite ka patur konflikte pronësie me familjen B., të përfunduar në favorin e saj në të tri shkallët e brendshme të gjyqësorit si dhe në Gjykatën e Strasburgut.

**70.5.2.** Gjithashtu ka sqaruar se, pas zgjidhjes së konfliktit të pronësisë, pronën - truallin prej 494 m<sup>2</sup>, ia ka dhënë për ndërtim shoqërisë së ndërtimit “\*\*\*” sh.p.k., me të cilën ka lidhur kontrata para noterit. Por pas ngritjes së pallatit, familja e saj ka konstatuar se shoqëria e ndërtimit i ka shitur çdo njësi të tretëve. Për këtë arsye duke mos rënë në dakordësi, i është drejtuar gjykatës për zgjidhjen civilisht të çështjes, por nga ana tjetër

<sup>146</sup> Ka depozituar si provë kopje të procesverbalit gjyqësor.

<sup>147</sup> Ka depozituar si provë fletën e printuar nga faqja zyrtare e Gjykatës së Lartë, ku pasqyrohen të dhënat lidhur me çështjen objek denoncimi dhe statusi i saj, si edhe kopje të dosjes gjyqësore – marrë nga Gjykata Administrative e Apelit.

<sup>148</sup> Denoncimi i protokolluar në Komision me nr. \*\*\* prot., datë 26.3.2021.

është përballur me disa procese gjyqësore administrative të inicuar nga shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., me objekt “Fshirjen nga regjistri hipotekor të pronës së tyre sipas certifikatës së pronësisë”.

**70.5.3.** Sipas denoncueses, Gjykata Administrative e Shkallës së Parë Tiranë vendosi mospranimin e padisë e shoqërisë. Në vijim, vendimi është ankimuar nga shoqëria në Gjykatën Administrative të Apelit, ku subjekti i rivlerësimit bashkë me një gjyqtar tjetër vendosi në kundërshtim me kryesuesen e trupës, që të hiqej sipërfaqja prej 140 m<sup>2</sup> pa ia kërkuar paditësi në objekt padie.

**70.5.4.** Sipas denoncueses, vendimi është marrë nga subjekti pa caktuar një ekspert që të argumentonte pse po hiqej kjo sipërfaqe nga prona e fituar në Strasburg, si dhe gjithashtu subjekti nuk përcaktoi se kujt i takonte, se ku do të transferohej sipërfaqja që hoqi. Denoncuesja, gjithashtu referon se subjekti i rivlerësimit nuk zhvilloi gjykim por mori vendimin në dhomë këshillimi.

### **Verifikimi i kryer nga Komisioni**

**70.5.5.** Komisioni, pas administrimit të denoncimit dhe dokumentacionit mbështetës<sup>149</sup> kreu verifikime në faqen zyrtare të Gjykatës së Lartë, nga ku konstatoi se ndaj vendimit të dhënë nga Gjykata Administrative e Apelit (Vendimi nr. \*\*\*, datë 4.4.2018 – objekt denoncimi) është ushtruar rekurs në datën 6.6.2018.

**70.5.6.** Në vijim, me shkresën nr. \*\*\* prot., datë 1.4.2021, Komisioni i kërkoi Gjykatës së Lartë të vejë në dispozicion dosjen e plotë gjyqësore, që i përket rekursit të bërë kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit – Tiranë, me nr. \*\*\*, datë 4.4.2018.

**70.5.7.** Gjykata e Lartë<sup>150</sup>, na dërgoi dosjen e plotë, aktet që i përkasin çështjes administrative me palë ndërgjygjëse shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k., E.N. etj., me objekt *“Njohjen e pavërtetësisë ë dokumentit, “Certifikatë Pronësie” datë 7.1.2014, “kartelë pasurie të paluajtshme” dhe “hartës treguese të regjistrimit” datë 7.1.2014, për pasurinë nr. \*\*\*, trualli me sipërfaqe 494 m<sup>2</sup>, z.k \*\*\*\*, vol. \*\*\*, faqe \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”, lëshuar nga ZVRPP Tiranë në emër të B.N. e E.N., e cila sjell pasoja juridike për palën paditëse, shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.*

**70.5.8.** Në lidhje me faktin e referuar nga denoncuesi se subjekti ka tejkalluar kërkimet e padisë, nga verifikimet e kryera konstatohet se pala paditëse, (shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.) ka kërkuar para Gjykatës, ndaj të paditurve (ZVRPP-ja Tiranë, B.N. dhe E.N.):

- i. njohjen e pavërtetësisë së dokumentit “certifikatë pronësie datë 7.1.2014”, “kartelë pasurie” dhe hartës treguese të regjistrimit, për pasurinë \*\*\*, nga truall 494 m<sup>2</sup>, zona kadastrale \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, lëshuar nga ZVRPP-ja në emër të B. e E.N., i cili sjell pasoja për palën paditëse shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k;
- ii. fshirjen në ZVRPP-në Tiranë të pasurisë me nr. \*\*\* truall, me sip. 494 m<sup>2</sup>, zona kadastrale \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”, Tiranë, për shkak të pavlefshmërisë absolute të kontratës me të cilën është regjistruar pasuria. Kthimin e kësaj pasurie në gjendjen e mëparshme, me pronar “shtet”.

**70.5.9.** Rezulton se, me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.4.2018 Gjykata Administrative e Apelit, ka vendosur me shumicë votash: ndryshimin e vendimit nr. \*\*\* datë 6.7.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë; (i) pranimin pjesërisht të

<sup>149</sup> Vendim nr. \*\*\*, datë 4.4.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit, dhe vendimi i datës 22.8.2006 i Gjykatës Evropiane e të Drejtave të Njeriut.

<sup>150</sup> Shkresa nr. \*\*\* prot., datë 9.4.2021.

kërkesëpadi së, njohjen e pavërtësisë së dokumentit “certifikatë pronësie” datë 7.1.2014 për pasurinë \*\*\*, nga truall 494 m<sup>2</sup> në 371 m<sup>2</sup>, ndodhur ne zonën kadastrale \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”, Tiranë; (ii) fshirjen e sipërfaqes truall prej 123 m<sup>2</sup> nga regjistri hipotekor i familjes N. (sip. e dalë 494 m<sup>2</sup> - 371 m<sup>2</sup>=123 m<sup>2</sup>). Rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj.

**70.5.10.** Konfirmohet se, denoncuesi ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë kundër vendimit të Gjykatës Administrative të Apelit. Gjithashtu, nga verifikimi i dosjes rezulton se, Kolegji Administrativ i Gjykatës së Lartë bazuar në kërkesën e B.N. dhe E.N. ka vendosur<sup>151</sup> pezullimin e ekzekutimit të vendimit nr. \*\*\*, datë 6.7.3017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë, ndryshuar me vendimin nr. \*\*\*, datë 4.4.2018 të Gjykatës Administrative të Apelit Tiranë.

**70.5.11.** Me dërgimin e rezultateve shtesë të hetimit<sup>152</sup>, Komisioni i kërkoi subjektit të parasqesi shpjegimet/argumentat e saj lidhur me pretendimin e ngritur në këtë denoncim se Gjykata Administrative e Apelit është investuar të disponojë përtej objektit të mosmarrëveshjes së përcaktuar nga pala paditëse.

**70.5.12.** Në lidhje me faktin pretenduar se, gykimi është zhvilluar në dhomë këshillimi, Komisioni pas verifikimit të dosjes, nuk e gjeti me vend, pasi rezulton se ccështja është shqyrtuar në seancë gjyqësore me praninë e palëve, me qëllim realizimin e debatit gjyqësor midis tyre.

Lidhur me pretendimet e tjera të ngritura nga denoncuesja, duket se ato i përkasin shqyrtimit të themelit të çështjes, garant i së cilës është gjykata e shkallës më të lartë.

#### **Qëndrimi i subjektit të rivlerësimit**

**70.5.13.** Me dërgimin e prapësimeve lidhur me këtë denoncim, subjekti ka argumentuar se nuk kemi asnjë lloj tejkalimi të objektit të padisë, dhe se nga investigimi i dosjes së themelit, dhe nga vetë Komisioni në rezultatet e shtesë të hetimit, në lidhje me faktin e referuar nga denoncuesi se subjekti ka tejkaluar kërkimet e padisë, nga verifikimet e kryera konstatohet se pala paditëse, (shoqëria “\*\*\*\*” sh.p.k.), ka kërkuar para Gjykatës, ndaj të paditurve (ZVRPP Tiranë, B.N. dhe E.N.):

- i. njohjen e pavërtësisë së dokumentit “certifikatë pronësie datë 7.1.2014”, “kartelë pasurie” dhe hartës treguese të regjistrimit, për pasurinë \*\*\*, nga truall 494 m<sup>2</sup>, zona kadastrale \*\*\*, vol. \*\*\*, fq.\*\*\*, rr: “\*\*\*\*”, Tiranë, lëshuar nga ZVRPP në emër të B. e E. N., i cili sjell pasoja për palën paditëse shoqërinë “\*\*\*\*” sh.p.k.
- iii. Fshirjen në ZVRPP-në Tiranë të pasurisë me nr. \*\*\*, truall me sip. 494 m<sup>2</sup>, zona kadastrale \*\*\*, vol. \*\*\*, fq. \*\*\*, rr: “\*\*\*\*”, Tiranë, për shkak të pavlefshmërisë absolute të kontratës me të cilën është regjistruar pasuria. Kthimin e kësaj pasurie në gjendjen e mëparshme, me pronar “shtet”.

**70.5.14.** Pikërisht, referuar objektit të sipërcituar, Gjykata Administrative e Apelit, ka vendosur: ndryshimin e vendimit nr. \*\*\*, datë 6.7.2017 të Gjykatës Administrative të Shkallës së Parë Tiranë: (i) pranimin pjesërisht të kërkesëpadi së, njohjen e pavërtësisë së dokumentit “certifikatë pronësie”, datë 7.1.2014 për pasurinë \*\*\*, nga truall 494 m<sup>2</sup> në 371 m<sup>2</sup>, ndodhur në zonën kadastrale \*\*\*, vol.\*\*\*, fq. \*\*\*, rr. “\*\*\*\*”, Tiranë; (ii) fshirjen e sipërfaqes truall prej 123 m<sup>2</sup> nga regjistri hipotekor i familjes N. (sipërfaqe e dalë 494 m<sup>2</sup> – 371 m<sup>2</sup> = 123 m<sup>2</sup>); (iii) rrëzimin e padisë për pjesën tjetër të saj, çka do të thotë që ka disponuar për të gjitha kërkimet e palës paditëse edhe me një vështrim të lirë, pa i hyrë arsytimit ligjor të Gjykatës Administrative të Apelit.

<sup>151</sup> Vendimi nr. \*\*\*, datë 30.7.2018.

<sup>152</sup> Denoncimi i shtetases E.N. është bërë shkak për riçeljen e hetimit administrativ.

**70.5.15.** Në vijim, subjekti ka parashtruar se pretendimet e denoncueses janë të atilla që do i shqyrtojë gjykata më e lartë. Po kështu, pretendimeve të ngritura nga kjo denoncuese, i janë dhënë përgjigje dhe nga organi i Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, i cili me vendimin e datës 3.12.2018 ka vendosur: “*Mosfillimin e procedimit penal, të materialit kallzues me nr. \*\*\*, viti 2018*”, vendim për të cilin informon nuk është ushtruar e drejta e ankimit<sup>153</sup>.

#### **Vlerësimi përfundimtar i Komisionit lidhur me këtë denoncim**

**70.5.16.** Nga shqyrtimi në tërësi i këtij denoncimeve, provave dhe shpjegimeve të depozituara nga subjekti, Komisioni arrin në përfundimin se nuk vërehen fakte apo rrethana, të cilat mund të përbëjnë prova në lidhje me kriterin e rivlerësimit në aspektin profesional dhe për figurën e subjektin e rivlerësimit znj. Enkelejda Metaliaj. Komisioni vlerëson se shpjegimet e subjektit lidhur me këtë denoncim janë bindëse dhe të mbështetura në dokumentacion provues.

#### **Konkluzione për kriterin e vlerësimit profesional**

**71.** Në analizë të raportit të hartuar nga Këshilli i Lartë Gjyqësor, denoncimeve të depozituara nga publiku dhe shpjegimeve të dhëna nga subjekti i rivlerësimit, si dhe dokumentacionit të administruar në këtë kuadër, Komisioni çmon se në vlerësimin e përgjithshëm nuk janë konstatuar shkelje procedurale, gabime thelbësore dhe serioze apo një seri e qartë dhe e vazhdueshme e gjykimeve të gabuara prej subjektit të rivlerësimit, gjë që mund të çonte në konstatimin e mungesës së aftësive profesionale.

**71.1** Trupi gjykues vlerëson se në bazë të të gjitha rrethanave dhe kushteve të mësipërme, subjekti i rivlerësimit ka nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale të kërkuar nga ligji nr. 84/2016.

### **IV. KONKLUSIONE PËRFUNDIMTARE**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, pasi u njoh me rrethanat e çështjes, bazuar në provat e administruara, në raportin dhe në rekomandimet e relatorit të çështjes, dëgjoi subjektin e rivlerësimit në seancë dëgjimore publike, si dhe mori në shqyrtim të gjitha shpjegimet dhe provat e parashtruara nga subjekti i rivlerësimit, konkludon se:

- a. subjekti arrin nivel të besueshëm në vlerësimin e pasurisë;
- b. subjekti arrin nivel të besueshëm në kontrollin e figurës;
- c. subjekti arrin nivelin kualifikues në vlerësimin e aftësive profesionale.

#### **PËR KËTO ARSYE,**

Trupi gjykues i Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, bazuar në pikën 5, të nenit 55, të ligjit nr. 84/2016, pasi u mblodh në dhomë këshillimi, në prani edhe të vëzhguesit ndërkombëtar, referuar në nenin 4, pika 2, nenin 58, pika 1, germa “a”, si dhe në nenin 59, pika 1 të ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”,

#### **V E N D O S I:**

1. Konfirmimin në detyrë të subjektit të rivlerësimit, znj. Enkelejda Metaliaj, me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Administrative të Apelit, Tiranë.

---

<sup>153</sup> Ka depozituar si dokumentacion provues: (i) vendimin e mosfillimit të çështjes penale; dhe (ii) vërtetimin e lëshuar nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë.

2. Vendimi, i arsyetuar me shkrim, u njoftohet subjektit të rivlerësimit, Komisionerëve Publikë dhe vëzhguesve ndërkombëtarë, si dhe publikohet në faqen zyrtare të Komisionit, në përputhje me pikën 7 të nenit 55 të ligjit nr. 84/2016.
3. Ky vendim mund të ankimohet në Kolegjin e Posaçëm të Apelit, nga Komisioneri Publik dhe/ose nga subjekti i rivlerësimit, brenda 15 ditëve nga data e njoftimit të vendimit.
4. Ankimi depozitohet në Komisionin e Pavarur të Kualifikimit.

U shpall në Tiranë, në datën 26.4.2021

## **ANËTARËT E TRUPIT GJYKUES**

**Etleda ÇIFTJA**  
Kryesuese

**Pamela QIRKO**  
Relatore

**Roland ILIA**  
Anëtar

*Ertugena Sokoli*  
Sekretare gjyqësore



## ANEKS 1 - ANALIZA FINANCIARE PËRMBLEDHËSE

Nr	Pershkrimi	Viti 2003	Viti 2004	Viti 2005	Viti 2006	Viti 2007	Viti 2008	Viti 2009	Viti 2010	Viti 2011	Viti 2012	Viti 2013	Viti 2014	Viti 2015	Viti 2016	
ASETE	<b>Pasuri të Paluajtshme</b>															
	Aparatament 1+1 me sip. 58 m2 ne *** Durres blere nga shoqeria *** shpk. me kontrate date 12.12.2001															
	Aparatament banimi 96 m2 në rrugen *** Tirane shoq. *** viti 2002															
	Aparatament banimi 76 m2 në rrugen *** Tirane shoq.*** blere viti 2010									4 072 400						
	Aparatament banimi 86.04 m2 në L.*** Durres, pjesa takuese 50% e 3/5 shtur nga familjarët															
	Truall-shtesë apartamenti banimi në Durres pjesa takuese 33%															
	Aparatament banimi me sip.96 m2 në *** Durres ,vlera 48.250 eu shoq. Ndertuese *** shpk						5 875 885									
	Autoveture Golf *** marre ne vitin 2002															
	Autoveture Ford Focus blere ne 2004 bashkeshorti		700 000													
	Autoveture Passat blere dt.06.02.2008 me targe ***							500 000								
	Autoveture Passat viti 2006 blere ne 26.07.2011										1 000 000					
	Likuiditete (ndryshim gjendesh)		602 884	282 891	387 570	3 003 356	-	4 155 819	263 359	160 683	422 293	9 731 398	65 937	-	68 180	-
	<b>TOTALI</b>		-	1 302 884	282 891	387 570	8 879 241	-	3 655 819	263 359	4 233 083	1 422 293	9 731 398	65 937	-	68 180
DETYRIME	Huamarije velkai i bashkeshortit S.M.								4 856 950	-						
	Detyrime shoq. Ndertimi ***					4 779 865	-	3 653 400	-	689 800	-	589 773				
	<b>TOTALI</b>		-	-	-	-	4 779 865	-	3 653 400	-	689 800	-	4 267 178	-	-	-
TE ARDHURA	Paga nga funksioni	455 344	760 831	770 422	801 853	797 091	818 713	899 021	990 258	1 010 246	1 042 949	1 069 839	1 271 024	1 339 300	1 327 593	
	Te ardhura bashkeshorti	101 968	1 319 323	1 238 890	1 167 317	1 213 957	1 110 106	1 005 571	1 063 573	1 100 760	1 121 335	1 162 885	1 148 176	997 813	886 014	
	Dhurata të tjera (shitje toke M*** nga nëna)												500 000			
	Te ardhura te tjera sigurime shoq. Perfitime te ndryshme									1 241 504				321 523	226 957	
	Te ardhura nga interesat B.Thesari										390 039	228 703	199 451	171 625	140 487	
	Te ardhura nga shitja e pasurive te paluajtshme						3 500 000				2 791 800					
	Te ardhura nga shitja e pasurive te paluajtshme truall-shtese ap. ne Durres dhuruar nga bashkepronaret e tjere										7 000 000					
	Te ardhura nga shitja e pasurive te luajtshme		300 000													
	<b>TOTALI</b>	557 312	2 380 154	2 009 312	1 969 170	5 511 048	1 928 819	1 904 592	2 053 831	3 352 510	12 346 123	2 461 427	3 118 651	2 830 261	2 581 051	
	SHPENZIME	Shpenzime shkolli, trajnime eksp.profesionale							75 520	176 800	191 880	282 000	528 672	420 420	451 736	432 736
Shpenzime bileta , udhetime, pushime				147 048	374 535	299 147	61 900	151 756	387 030	649 200	462 741	182 273	496 376	1 034 898	367 264	
Shpenzime te tjera						35 000	300 000									
Shpenzime per mimbajtje ,punime, investime dhe legalizime pasuri te,paluajtshme									30 000	120 000						
Shpenzim për kthim huaje ndaj shtetasit S.M.											697 950	701 050	700 700		946 610	
Shpenzim rivleresimi, aredime, bl pajisje etj									348 483	348 483						
Shpenzime minimale per konsum sipas INSTAT, ILDKPKI		344 535	375 856	438 228	438 228	492 352	546 480	546 480	546 480	546 480	697 740	564 096	879 992	897 104	940 368	
<b>TOTALI</b>		344 535	375 856	585 276	812 763	826 499	908 380	773 756	1 488 793	1 856 043	2 140 431	1 976 091	2 497 488	2 383 738	2 686 978	
<b>ANALIZA FINANCIARE</b>		<b>Viti 2003</b>	<b>Viti 2004</b>	<b>Viti 2005</b>	<b>Viti 2006</b>	<b>Viti 2007</b>	<b>Viti 2008</b>	<b>Viti 2009</b>	<b>Viti 2010</b>	<b>Viti 2011</b>	<b>Viti 2012</b>	<b>Viti 2013</b>	<b>Viti 2014</b>	<b>Viti 2015</b>	<b>Viti 2016</b>	
1	Te ardhura	557 312	2 380 154	2 009 312	1 969 170	5 511 048	1 928 819	1 904 592	2 053 831	3 352 510	12 346 123	2 461 427	3 118 651	2 830 261	2 581 051	
2	Asete	-	1 302 884	282 891	387 570	8 879 241	-	3 655 819	263 359	4 233 083	1 422 293	9 731 398	65 937	-	68 180	
3	Detyrime	-	-	-	-	4 779 865	-	3 653 400	-	689 800	-	4 267 178	-	-	-	
4	Shpenzime	344 535	375 856	585 276	812 763	826 499	908 380	773 756	1 488 793	1 856 043	2 140 431	1 976 091	2 497 488	2 383 738	2 686 978	
<b>Balanca e fondeve (1-2+3-4)</b>		<b>212 777</b>	<b>701 414</b>	<b>1 141 145</b>	<b>768 837</b>	<b>585 172</b>	<b>1 022 858</b>	<b>177 677</b>	<b>599 133</b>	<b>74 175</b>	<b>474 295</b>	<b>419 399</b>	<b>689 343</b>	<b>755 573</b>	<b>1 831 324</b>	